



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

01 Nr. 12/20
Rahovec, 21.12.2020

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më
29 dhjetor 2020 (e martë) me fillim në orën 10:00, në sallën e Shtëpisë së Kulturës
“Mensur Zybarej”.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe provimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen “Qytetar Nderi” Gjeneralin **Ton van Loon**;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për miratimin e planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS), për vitin 2021;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës rreth shërbimeve të varrimit për vitin 2021;
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve lagjeve urbane rreth emërtimeve e reja;
7. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronë private;
8. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për dalje në debat publik të Draft rregullores komunale për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Rahovecit;
9. Shqyrtimi i Planit vjetor të prokurimit për vitin 2021;
10. Shqyrtimi i realizimit të planit të punës për vitin 2020 të Auditorit të Brendshëm, si dhe shqyrtimi i planti të punës për vitin 2021;
11. Shqyrtimi i Raportit të punës të Kuvendit Komunal për vitin 2020;
12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punë së Kryetarit të Komunës për vitin 2021;
13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punë së Kuvendit të Komunës për vitin 2021;
14. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për shfuqizimin e Vendimit 01 Nr.131/20, të datës: 30.11.2020, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër;
15. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër;
16. Informatë rreth konkursit ndërkombëtar për dizajnimin e Sheshit Qendror të Qytetit të Rahovecit;



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT • OPŠTINA ORAHOVAC • MUNICIPALITY OF RAHOVEC



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT • OPŠTINA ORAHOVAC • MUNICIPALITY OF RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 155 / Nr. i faq./Br.str./No pg 155
Data/Datum/Date 30.11.2020
RAHOVEC / ORAHOVAC

PLANI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS 2021



Rr. Dëshmorët e Pashtrikut p.n - 21000 Rahovec, Kosovë
EMAIL: komuna.rahovec@rks.gov.net
TEL: 03820015340
<https://www.rks.gov.net/rks-net>

PËRMBAJTJA

PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS	2
PARATHËNIE	3
VIZIONI	3
PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2021.....	4
SYNIME PËR VITIN 2021	5
SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 2021	6
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS- PLANET E PUNËS 2021	7
DREJTORIA PËR ADMINISTRATË.....	12
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE	14
DREJTORIA PËR ARSIM	17
DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA	19
DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM	21
DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT.....	23
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE	24
DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL	26
DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË.....	29
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	31
DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE.....	34
DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM.....	36
PËRFUNDIM	39

ZOTIMI IM NË FILLIM TË MANDATIT

"Unë jam zotuar para qytetarëve të komunës së Rahovecit që me programin tim do të punojë për të gjithë. Unë kam platformën time qeverisëse dhe kjo platformë do të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve"- **SMAIL LATIFI**

PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS

Shtatë prioritetet e para strategjike janë të përqendruara nga jashtë dhe janë:

- **EKONOMI MË E FORTË KONKURRUESE, QË JU JEP MUNDËSINË TË GJITHËVE**
- **NJË MJEDIS MË I PASTËR, I GJELBËR DHE MË I SIGËRT, DUKE KRIJUAR NJË KOMUNË TË QENDRUESHME PËR GJENERATAT E ARDHSHME**
- **BUIQËSI TË AVANGUAR DHE TË ZHVILLUAR,**
- **EDUKIM, ARSIMIM DHE SHËRBIME TË CILËSISË SË LARTË PËR QYTETARËT TANË,**
- **PËRMIRËSIMI I SHËNDETIT DHE MIRËQENIES, DUKE JU MUNDËSUAR BANORËVE QASIE NË NJË NUMËR MË TË MADH TË OBJEKTEVE SHËNDETËSORE DHE SHËRBIME NËPËR QENDRA, DUKE U SIGURUAR QË QYTETARËT TANË TË JENË TË MBROJTUR,**
- **PËRMIRËSIMI I AFËTËSIVE JETËSORE TË TË RINJVE DHE TË RRITURVE,**
- **ADMINISTRATË LOCALE E FETIVE, QË OFRON SHËRBIME PUBLIKE PROFESIONALE TË LIDHURA ME NJË PROGRAM TË INVESTIMIT I BAZUAR NË NEVOJAT E QYTETARËVE.**

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

PARATHËNIE

Plani që po paraqesim është sfidues dhe është pjesë e procesit të përmirësimit të kushteve të punës e të jetës për qytetarët e Rahovecit, plan që duhet të zbatohet në praktikë. Megjithatë, për zbatimin e këtij plani, kërkohet ndërmarrja e një seri masash dhe veprimesh konkrete në terren, duke u konsultuar vazhdimisht me ekspertë të fushave të ndryshme dhe profesionistë të dëshmuar. Bazuar në përvojën tonë pozitive për qytetarët e komunës së Rahovecit, mund të konstatojmë se ekzistojnë parakushtet për zbatim efikas të këtij plani.

Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore e mbitokësore, ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore, ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore, hartimi dhe zbatimi i planeve rregulluese urbane, si dhe aktivitete të tjera për përmirësimin e jetës së qytetarëve, do të vazhdojnë të jenë preokupimi ynë. Krejt kjo do të jetë një mundësi më e madhe për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe krijimin e mundësive për vende të punës.

Ekonomia dhe Bujqësia do të vazhdojë të jetë në krye të agjendës tonë zhvillimore. Mbështetur në kushtet klimatike e tokësore, mbështetur në traditën e pasur të qytetarëve tanë, jemi të bindur se kemi bazën e fuqishme të besimit për rritjen e mirëqenies dhe përmirësimin e kushteve ekonomike të qytetarëve të komunës së Rahovecit. Krahas kësaj do të ushtrojmë kujdes të shtuar ndaj ambientit jetësor, si në aspektin e mbrojtjes së mjedisit, ashtu edhe në rregullimin e rrjedhave ujore dhe rregullimin e hapësirave të gjelbëruara në tërë territorin e komunës.

Qytetari është dhe do të mbetet preokupimi ynë kryesor. Ngritja e cilësisë së shërbimeve dhe krijimi i kushteve për funksionim të një administrate efikase, do të jenë vëmendja jonë e përditshme.

VIZIONI

"Bujqësi e zhvilluar, infrastrukturë të rregulluar, përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies sociale, edukim, arsimim dhe shërbime të cilësisë së lartë për qytetarët tanë, krijimi i kushteve më të mira për investime në ekonomi, kthimi i hapësirave nga menaxhimi i APK (Agjencioni Pyjor i Kosovës) në menaxhim nga Komuna"

VLERAT TONA:

Kemi një grup të përbashkët të vlerave thelbësore që formësojnë mënyrën se si do të merremi me klientët, partnerët dhe kolegët. Duam të sigurohemi që çdo gjë që bëjmë dhe shërbimet që ne ofrojmë do të jenë të duhura për njerëzit që kanë nevojë për to dhe ne do të përpiqemi ta bëjmë me:

- Transparencë: të qenit të hapur dhe të ndershëm;
- Përgjegjshmëri: duke marrë përgjegjësi me vullnet të lirë dhe dëshirë;
- Drejtësi: ne çmojmë diversitetin dhe promovojmë barazinë;
- Partneritet: puna me komunitete, biznese dhe partnerë të tjerë.

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

Në vazhden e zbatimit të vizionit për Rahovecin që është bazament i qeverisjes së tanishme lokale, prioritetet kryesore për vitin 2021 janë këto:

PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2021

- RAHOVECINJË VEND I DËSHIRUESHËM PËR TË JETUAR, PËR TË PUNUAR DHE PËR TË MBAJTUR FAMILJEN,
- TË PËRGJEGJSHËM NDAJ NEVOJAVE TË QYTETARËVE, NË RRIJTJEN E NIVELIT TË KËNAQSHMËRISË SË QYTETARËVE ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE DHE INFORMIM PUBLIK CILËSOR,
- KOMUNË ME PERFORMANCË TË MIRË DHE QEVERISJE DEMOKRATIKE,
- ADMINISTRATË EFIKASE, E PËRGJEGJSHME DHE ME SHËRBIME MODERNE,
- QEVERISJE ENERGJIKE, VEPRUESE DHE VENDIMMARRJE PA VONESË,
- REALIZIM I SUKSESSHËM I PROJEKTEVE DHE I BUXHETIT,
- REALIZIM I PLANIT TË TË HYRAVE KOMUNALE,
- PROMOVIMI DHE PËRMIRËSIMI I MJEDISIT TË RAHOVECIT SI QYTET LIDER PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE TË BIZNESEVE EKZISTUESE, ZGJERIMIN E TYRE SI DHE PËR ATO TË REJAT,
- NDËRTIM I RRUGËVE TË REJA DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE EKZISTUESE,
- RRIJTJA E ROLIT DHE SHTIMI I AKTIVITETEVE TË INSPEKTORATIT,
- EDUKIM TË DINJITIZ TË BREZAVE TË RINJË DUKE IU OFRUAR MËSIMDHËNIE DHE MËSIMNXËNIE CILËSORE BASHKËKOHORE, MJEDIS TË PËRSHTATSHËM MËSIMOR ME INFRASTRUKTURË ADEKUATE DHE GJITHËPËRFSHIRËSE,
- OFRIMI I MJEDISEVE PËR REKREACION, NGJARJEVE KULTURORE DHE PROGRAME PËR T'Ë PËRMBUSHUR NEVOJAT E QYTETARËVE TË TË GJITHA MOSHAVE, ME THEKS TË VEÇANTË NË MIRËQENIEN E RINISË,
- KRIJIMI DHE MIRËMBAJTJA E SISTEMIT TË SIGURTË DHE EFIKAS TË QARKULLIMIT NË TRAFIK,
- SHTIMI DHE MIRËMBAJTJA E PARQEVE, HAPËSIRAVE PUBLIKE, OBJEKTEVE REKREATIVE, RRUGËVE, NDËRTESAVE DHE INFRASTRUKTURËS TJETËR ME QËLLIM TË ARRITJES SË STANDARDEVE TË LARTË TË DUKJES DHE GJENDJES SË TYRE,
- VIZITA SISTEMATIKE SHËNDETËSORE NËPËR TË GJITHA SHKOLLAT,
- NXITJE TË INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE NË TURIZËM,
- TROTUARE DHE SHTIGJE TË ECJES PËR KËMBËSORË E BICIKLISTË,
- RRIJTJE E PËRKRAHJES PËR BUIQËSINË DHE RRIJTJE E PËRKRAHJES DIREKTE PËR FERMERËT,
- PROJEKTE PËR KULLIMIN E TOKAVE BUIQËSORE,
- RRIJTJE E CILËSISË DHE INVESTIME NË ARSIM,
- BURSA PËR STUDENT,
- BASHKËPUNIM I MIRË ME DONATORËT E JASHTËM,
- KOMUNIKIM DHE BASHKËPUNIM ME OJQ-TË.

SYNIME PËR VITIN 2021

- RIPARIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE FUSHORE;
- INTERVENIMI NË NDËRTIMIN E KANALEVE TË KULLIMIT DHE DRENAZHIMIT TË TOKAVE BUJQËSORE;
- ZGJERIMI I SISTEMIT TË UJITJES NË PJESËT KU MUNGON;
- PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA E PËRROSKAVE, SI DHE KRIJIMI I EKIPEVE MOBILE TË PRANIMIT TË APLIKACIONEVE PËR PAGESA DIREKTE NË DY QENDRA TË MËDHA TË KOMUNËS SONË;
- FUNKSIONALIZIMI I PLOTË EKIPEVE PËR PARANDALIMIN DHE REAGIMIN KUNDËR BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT TË NXËNËSVE (EPRBM) NËPËR SHKOLLË;
- FUNKSIONALIZIMI I PLOTË I AKTIVAVE PROFESIONALE (AP) NË SECILËN SHKOLLË;
- RIPARIMET DHE INVESTIMET NË EFIÇIENCË TË ENERGJISË NË OBJEKTET SHKOLLORE;
- PËRFUNDIMI I INVESTIMEVE TË PLANIFIKUARA NË NDËRTIMIN E ÇERDHEVE PËR FËMIJË;
- PËRFUNDIMI I PROJEKTEVE PËR NDËRTIMIN E SHKOLLAVE TË REJA TË FILLUARA NGA VITI 2018 DHE 2019;
- HARTIMIN E PROJEKTIT KRYESOR TË SHESHIT QENDROR TË RAHOVECIT DHE NISJEN E PUNIMEVE NË KËTË PROJEKT. RITJEN E TË HYRAVE VETANAKE PËRMES LËSHIMIT TË LEJEVE NDËRTIMORE, PROCESIT TË LEGALIZIMIT DHE LEJEVE MJEDISORE KOMUNALE, NË BASHKËPUNIM ME DREJTORINË PËR PUNË INSPEKTUESE. LEGALIZIMIN E OBJEKTEVE PA LEJE DHE RESPEKTIMIN E LIGJIT TË RI PËR TRAJTIMIN E OBJEKTEVE PA LEJE
- VAZHDIMIN E TRAJTIMIT TË SHTRËTËRVE TË LUMENJVE DHE PËRRENJVE, PËRMES INVESTIMEVE KAPITALE NGA KOMUNA E RAHOVECIT DHE MBËSHETJES NGA QEVERIA E KOSOVËS, ME QËLLIM MBROJTJEN NGA VËRSHIMET DHE RUAJTJEN E MJEDISIT, KRIJIMI I HAPËSIRAVE TË REJA TË GJELBËRUARA, RREGULLIMIN E PARQEVE DHE MBJELLJEN E DRUNJVE
- TRAJTIMI I UJËRAVE ATMOSFERIK NË QYTET,
- INFRASTRUKTURA PUBLIKE NË RRJETIN E KANALIZIMEVE FEKALE DHE GROPAVE SEPTIKE, ZGJERIMET;
- NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE, NDRIÇIMI PUBLIK, TROTUAJET DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE PUBLIKE;
- FUNKSIONALITET ME I MADH I RRJETIT TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE DHE KOHËZGJATJE E SHËRBIMEVE;
- VAZHDIMI I TRAJTIMIT TË SHTRËTËRVE TË LUMENJVE DHE PËRRENJVE, PËRMES INVESTIMEVE KAPITALE NGA
- INVESTIME NË TRASHËGIMI KULTURORE DHE HISTORIKE, RESTAURIME, NDËRTIMI I MUZEVE ETJ;
- PLANI I VEPRIMIT PËR RITJEN E TË HYRAVE KOMUNALE;
- PLANI I VEPRIMIT PËR INKASIMIN E TATIMIT NË TOKË;
- SUBVENCIONIM ME I MADH I OJQ-VE, KATEGORIVE TË CAKTUARA TË SHOQËRISË DHE I VEPRIMTARIVE TË NDRYSHME KOMUNALE
- MBIKËQYRJE AKTIVE DHE RITJE E CILËSISË NË INVESTIMET PUBLIKE;
- VAZHDIMI I EVIDENTIMIT DHE LIRIMIT TË PRONAVE TË UZURPUARA NË NIVEL TË KOMUNËS;
- DYFISHIM I PËRPJEKJEVE PËR MBROJTJE TË MJEDISIT, MBROJTJEN E TOKAVE BUJQËSORE, MBROJTJEN E PRONËS PUBLIKE, PARANDALIMI I NDËRTIMEVE PA LEJE;
- PLANIFIKIMI I MASAVE PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE NDIHMË NË RAST TË FATKEQËSIVE NATYRORE DHE FATKEQËSIVE TË TJERA;
- PROJEKTE ME PARTNERITET PUBLIKO-PRIVAT;
- HARTIMI I PLANEVE, NXJERRJA E AKTEVE DHE RREGULLOREVE TË TJERA TË PUNËS;
- ZHVILLIMI I RAHOVECIT NË PËRPUTHJE ME PLANET ZHVILLIMORE KOMUNALE DHE MENAXHIMI I BURIMEVE FIZIKE BAZUAR MBI PARIMET E SHËNDOSHA MJEDISORE SI DHE MBI PARIMET E PARTNERITETIT ME MEKANIZMA VENDOR E NDËRKOMBËTAR, TË CILËT NDIHMOJNË NË ARRITJEN E VIZIONIT PËR KOMUNË MODEL ME NJË QEVERISJE KUALITATIVE, EFIKASE DHE LLOGARIDHËNËSE;

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

SHIDAT KRYESORE PËR VITIN 2021

- BUXHETI I ULËT I QEVERISË SË KOSOVËS, MUNGESA E MJETEVE TË MJAFTUESHME FINANCIARE NGA QEVERIA QENDRORE SI TREND I VAZHDUESHËM NË KOSOVË, QË I BËN INVESTIMET EDHE MË TË VËSHTIRA (ANGAZHIME TË SHTUARA NË KËRKESA NGA QEVERIA QENDRORE).
- INTEGRIMI I SA MË SHUMË QYTETARËVE DHE THELLIMI I BASHKËPUNIMIT TË NGUSHTË ME ORGANIZATAT JOQEVERITARE (OJQ-TË), BIZNESET, ZANATLINJË, TREGTARËT, BUIQIT, SHOQËRINË CIVILE ETJ.
- MUNGESA E HAPËSIRAVE PUBLIKE NË GJITHË TERRITORIN E KOMUNËS SË RAHOVECIT
- MUNGESA E BURIMEVE TË MJAFTUESHME NJERËZORE DHE PROFESIONALE
- PËRFSHIRJA MË E MADHE E QYTETARËVE TANË NË AKTIVITETET TONA DHE DUKE I MBAJTUR ATA TË INFORMUAR PËR TË GJITHA KËTO ZHVILLIME

Plani Vjetor i Punës, siç është paraqitur më poshtë, përkufizon synimin me qëllim të realizimit të objektivave të përcaktuara, si dhe njëkohësisht lliston të gjithë zyrtarët përgjegjës për mbarrëvajtjen e punëve për secilën pikë. Personat përgjegjës obligohen që për çfarëdo shtyrje eventuale të afatit kohor të përfundimit të punëve, apo mospërmbytje ndaj të njëjtës, të raportojnë me shkrim te Kryetari i komunës. Ndryshimet eventuale, për arsye kuptimplote, apo faktorëve të jashtëm, do të harmonizohen me Kryetarin e Komunës si dhe ekipin përgjegjës për realizimin e tërësishëm të këtij plani.

Pjesë përbërëse e planit të punës së ekzekutivit komunal për vitin 2021 do të jenë planet e punës të të gjitha drejtorive komunale në komunën e Rahovecit si dhe njësive të cilat veprojnë në kuadër të zyrës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit.

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS- PLANET E PUNËS 2021

Zyra Ligjore

Zyra Ligjore në komunën e Rahovecit me këtë plan synon arritjen e objektivave për vitin 2021:

- Ofrimin e këshillave juridike të rregullta për organet komunale dhe trupave të formuara nga organet komunale, Kryetarin e Komunës, Kuvendin Komunal, drejtorët e drejtorive, komiteteve të përhershme dhe konsultative, Zyrës së Prokurimit, komisioneve etj.)
- Harton (përpilon) vendime, aktvendime, pëlqime, urdhëresa, memorandume mirëkuptimi, kontrata, marrëveshje, leje pune, leje ndërtimi dhe shkresa të tjera për organet komunale dhe trupat e formuar nga organet komunale;
- Pjesëmarrjen në komisionet e ndryshme të formuara nga Kryetari i Komunës për çështjet e caktuara;
- Hartimin e rregulloreve sipas kërkesës së drejtorive ;
- Pjesëmarrje të rregullt në seancat e Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit

Njësia e Personelit në kuadër të kompetencave të saj, për periudhën deri në fund të vitit 2020, ka për synim të arrij këto objektiva:

- Mbajtjen e nivelit të efektivitetit të shërbimeve të Njesisë së Personelit;
- Zbatimin e ndryshimeve të reja ligjore në fushën e resurseve njerëzore ;
- Zbatimin dhe familjarizimin e punëtorëve dhe menaxhmentit me programin SIMBNJ;
- Mbikëqyrjen e pranisë së punëtorëve në punë;
- Përkujdesjen për pajisjen e punëtorëve me kartela identifikimi ;
- Menaxhimin efikas me arkivin e njesisë së personelit;
- Shkarkimi nga programi PYROLL i listës së pagave dhe pagesave në formë elektronike dhe dërgimi i tyre te zyrtarët përgjegjës;
- Krijimi i dosjeve pasive, sistemimi i dosjeve si dhe ruajtja e tyre.

Zyra e Prokurimit

Plani i punës së Zyrës së Prokurimit është i ndikuar nga planet e punës së drejtorive komunale. Përmes këtij plani synim i zyrës së prokurimit është që të kryejë të gjitha veprimet me kohë, pa vonesa duke u bazuar në planifikimet e drejtorive komunale për projektet kapitale dhe në pajtim me ligjin e prokurimit publik.

Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura

Zyra për Përfaqësim Ligjor (ZPL) e komunës së Rahovecit kryen detyrat dhe punët në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, në bazë të praktikës së Avokaturës Publike Komunale dhe Ligjit për Avokaturën Shtetërore.

Ndër aktivitetet kryesore parashihen të jenë: përfaqësimi i komunës në seanca gjyqësore, ushtrimi i padive për palët, prapësimet e rasteve duke respektuar afatet ligjore, mendime juridike për zyrat e kryetarit dhe të drejtorive komunale, takime konsultuese dhe informuese me Kryetarin e komunës, ushtrimi i mjeteve të rregullta në procedurë përmbartimore, mbajtja e regjistrave të lëndëve, pranimit/dorëzimit i shkresave dhe klasifikimi, pranimit i ftesave për seanca gjyqësore.

Nr.	Përshkrimi i objektiveve të punës	Plani i veprimit	Bartësit e aktivitetit	Afati
1	Seancat gjyqësore	Mirëmbajtja e regjistrit elektronik të seancave të caktuara; Pjesëmarrja në seancat gjyqësore sipas ftesave të pranuar nga gjykata; Përgatitja e lëndës për të marrë pjesë në seancë gjyqësore; Përgatitja paraprake e materialit për mbrojtje dhe përpunimi i provave materiale për dorëzim.	Avokati Komunal	Janar-Dhjetor
2	Përgatitja për seancat gjyqësore	Analizimi i lëndës, konsultimi i bazës ligjore; Sigurimi i të dhënave dhe dokumentacionit nga drejtoritë përkatëse; Përgatitja e materialit provues për mbrojtje; Përgatitja e mbrojtjes me shkrim.	Avokati Komunal	Janar-Dhjetor
3	Ushtrimi i mjeteve të rregullta juridike	Kujdesi ndaj afateve ligjore dhe gjyqësore; Sigurimi i mbështetjes dhe informacioneve të bazuara; Fotokopjimi, përpunimi dhe bashkëngjitja e provave materiale; Ushtrimi i mjeteve të rregullta juridike të bazuara në prova dhe gjendjen faktike.	Avokati Komunal	Janar-Dhjetor
4	Ushtrimi i mjeteve të jashtëzakonshme juridike	Kujdesi ndaj afateve ligjore dhe gjyqësore; Sigurimi i mbështetjes dhe informacioneve të bazuara; Fotokopjimi, përpunimi dhe bashkëngjitja e provave materiale; Ushtrimi i mjeteve të rregullta juridike të bazuara në prova dhe gjendjen faktike.	Avokati Komunal	Janar-Dhjetor
5	Ushtrimi i mjeteve të rregullta në procedurë përmbartimore	Kujdesi ndaj afateve ligjore dhe gjyqësore; Sigurimi i mbështetjes dhe informacioneve të bazuara; Fotokopjimi, përpunimi dhe bashkëngjitja e provave materiale; Ushtrimi i mjeteve të rregullta juridike të bazuara në prova dhe gjendjen faktike.	Avokati Komunal	Janar-Dhjetor
6	Takime konsultuese dhe informuese me Kryetarin e Komunës	Konsultimet të rregullta mbi bazën e përgjegjësisë së deleguar; Takime informuese për lëndë dhe procedurën e caktuar;	Avokati Komunal	Janar-Dhjetor
7	Këshillimi	Përgatitja e këshillave ligjore, rekomandimeve, udhëzimeve dhe opinionëve brenda fushëveprimit të Komunës dhe me kërkesë të drejtorive apo organeve të Komunës	Avokati Komunal	Janar-Dhjetor

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

8	Mbajtja e regjistrave të lëndëve	Regjistrimi i lëndëve të reja; Barta e evidencave dhe shënimeve për lëndë të caktuara; Çregjistrimi i lëndëve, etj.	Zëvendësi-zyrtari profesional	Janar-Dhjetor
9	Pranim/dorëzim i shkresave dhe klasifikimi	Pranimi i shkresave gjyqësore, etj.; Regjistrimi i shkresave; Vendorsja e shkresave në lëndë të referuara.	Zëvendësi-zyrtari profesional	Janar-Dhjetor
10	Pranimi i ftesave për seanca gjyqësore	Pranimi dhe regjistrimi i ftesave për seanca; Përgatitja e lëndës për seancë;	Zëvendësi-zyrtari profesional	Janar-Dhjetor
11	Punë të daktilografimit	Përgatit parashtrës të ndryshme; Shkruan sipas diktimit të Avokatit; Përgatit shkresat bashkëngjitur provave.	Zëvendësi-zyrtari profesional	Janar-Dhjetor
12	Evidenca për punë lëndë në procedurë dhe të kryera	Mbajtja e evidencave të lëndëve në punë; Mbajtja e evidencave për lëndë të kryera.	Zëvendësi-zyrtari profesional	Janar-Dhjetor
13	Shënime dhe të dhënat statistikore	Mbajtja e shënimeve statistikore për të gjitha lëndë; Nxjerrja e të dhënave statistikore të përgjithshme për punën e zyrës së përfaqësimeve.	Zëvendësi-zyrtari profesional	Janar-Dhjetor
14	Parashtrimi i kërkesave për furnizim	Planifikimi i furnizimit të zyrës me material administrativ; Parashtrimi i kërkesave	Zëvendësi-zyrtari profesional	Janar-Dhjetor

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Plani i punës së Zyrës për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun për vitin 2020, bazohet në Statutin e Komunës, Rregulloren Komunale për Transparencë 03/2019 dhe Planin e Veprimit për Transparencë Komunale për vitet 2019-2023.

Ndër aktivitetet kryesore parashihen të jenë:

Publikimi i vendimeve të nënshkruara nga kryetari, përgatitja e lajmeve dhe njoftimeve për aktivitetet e kryetarit dhe drejtorive komunale, dërgimi i vendimeve të nënshkruara nga Kryetari në MAPL, publikimi i raportit të qeverisë komunale për vitin 2020, publikimi i planit të punës së qeverisë komunale për vitin 2021, pranimi i kërkesave për qasje në dokumente publike dhe kthimi i përgjigjes bazuar në ligjin për qasje në dokumente publike, publikimi i njoftimeve për mbledhjet e kuvendit komunal-KPF-së dhe Komitetit për Komunitete, përgatitja e njoftimeve për aktivitete përkujtimore, ngjarje e përvjetorë e për data të rëndësishme, publikimi i dokumenteve-rezultateve të përgatitura nga OJQ-të për transparencë dhe llogaridhënie për komunën e Rahovecit, publikimi i konkurseve, publikimi i thirrjeve për aplikim, publikimi i ankandeve, publikime të tjera, sipas nevojës, kërkesave dhe interesave të komunës, fillimi i procedurave për përgatitjen e Strategjisë Komunale për Komunikim.

Dokumentet si: Raporte, rregullore, plane të ndryshme, plane financiare, njoftime, lajme, ftesa ankande publike, thirrje dhe publikimi i vendimeve të nënshkruara nga ana e kryetarit, ndikojnë direkt në rritjen e performancës, transparencës dhe llogaridhënies në komunën e Rahovecit.

-Vendimet (publikimi i tyre është rregulluar edhe me ligj) e nënshkruara nga kryetari i komunës, dërgohen në MAPL dhe publikohen në uebfaqe zyrtare të komunës në vegëzën: <https://kk.rks->

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

gov.net/rahovec/staff/smajl-latifi/#vendimet_main , janë lehtë të qasshme nga ana e qytetarëve, mediat dhe OJQ-të por që nuk dërgohen për publikim tek mediat lokale dhe ato qendrore.

Planet, rregulloret dhe dokumente tjera që duhet të kalojnë në debat publik, publikohen edhe në platformën e konsultimeve publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Zyra e Auditimit të Brendshëm

Gjatë vitit 2021 Njësia e Auditimit të Brendshëm planifikon të auditojë këto drejtori:

- Drejtorja për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Drejtorja për Arsim;
- Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;
- Drejtorja për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë;
- Drejtorja për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm;
- Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ;
- Drejtorja për Shërbime Publike;
- Drejtorja për Administratë të Përgjithshme;
- Drejtorja për Financa dhe Buxhet dhe
- Zyra e Prokurimit.

Nga koha për zbatimin e detyrave të auditimit sipas planifikimit strategjik 2021-2023, për vitin 2021 të cilat janë 251 ditë, për auditime sipas kërkesës së menaxhmentit, njësia e auditimit të brendshëm planifikon 60% të kohës efektive të punës. Në rast të kërkesës për ndonjë auditim nga Zyrtari Kryesor Administrativ, Njësia e auditimit të brendshëm do të bëjë ndryshim/plotësimin e planit vjetor varësisht se në cilën periudhë kohore bëhet kërkesa.

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

- Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit për përfshirjen e komunitetit Rom dhe Ashkali 2019-2021
- Zbatimi i Planit Lokal për personat e riatdhesuar dhe kthim të qëndrueshëm 2019-2022
- Takimet me Komisionin për Kthim të Komuniteteve
- Monitorimi dhe realizimi i projekteve për të kthyerit
- Bashkëpunim me Ministrinë për Kthim dhe Komunitete dhe Ministrinë e tjera të linjës
- Krijimi i data bazës mbi gjendjen në bujqësi, shëndetësi, arsim dhe gjendjes sociale të komuniteteve
- Promovimi i aktiviteteve që kanë të bëjnë me fëmijët dhe barazinë gjinore te pjesëtarët e komuniteteve.

Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut

Në planin e punës për periudhën janar – dhjetor 2021 përfshihen aktivitetet që do të realizohen në fushën e të drejtave të njeriut.

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

- Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut (organizimi i fushatave sensibilizuese për të drejtat e njeriut, publikimi i doracakëve dhe broshurave informative, organizimi i tryezave, debateve të ndryshme për gjendjen aktuale të të drejtave të njeriut),
- Ngritja e vetëdijes së qytetarëve në proceset që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut (Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve për shkelje eventuale të të drejtave të njeriut nga institucionet komunale në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit),
- Përmirësimi i situatës së të drejtave të fëmijëve në komunën e Rahovecit (Lansimi i Strategjisë Nacionale për parandalimin e punës së rëndë të fëmijëve),
- Ofrimi i mundësive të barabarta për punësim dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarë, krijimi i kushteve të përshtatshme për punë për të gjithë (në sektorin publik), në kontekst të zbatimit të të drejtave të njeriut,
- Integrimi i komuniteteve në të gjitha fushat e jetës dhe të punës në komunën e Rahovecit,
- Integrimi i personave me aftësi të kufizuara në jetën shoqërore.

Zyra për Integritime Evropiane

Zyra për Integritime Evropiane do të kryej funksionin dhe detyrat e veta, duke u bazuar në rregulloren nr. 08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për integrim evropian në monitorimin, bashkëpunimin dhe raportimin e rregullt për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamentin për Integritime Evropiane.

Bashkërendimi i aktiviteteve me Asociacionin e Komunave me ministritë e linjës (MAPL/ MIE), avancimi i sistemit të riintegritimit të qëndrueshëm për personat e riatdhesuar, përmirësimi i bashkëpunimit dhe dialogut civil me shoqërinë civile lokale dhe palët e tjera të interesuara, organizimi i këshillimit të përbashkët me ZKIE-të për finalizimin e planeve individuale nga obligimet e agjendës evropiane 2020, raportet periodike (raporti vjetor janar-dhjetor 2021 për përmbushjen e obligimeve nga Agjenda Evropiane për komuna, raportimet 6 mujore për raportin e vendit dhe (MSA), raportimet vjetorë për Planin Komunal të Veprimit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit -MSA 2021- janë disa nga aktivitetet kyçe të planifikuara për vitin 2021 në kuadër të ZIE-së.

Zyra për Barazi Gjinore

Punët dhe detyrat e parapara me plan vjetor do të kryhen me efikasitet, përgjegjësi dhe profesionalizëm në harmoni me përcaktimin e detyrave të punës.

Vetëdijesimi në çështjen e barazisë gjinore, mbajtja e ligjëratave, fushatave sensibilizuese në vise rurale dhe në qytet, zbatimi i rregullores për barazi gjinore, takime përgatitore me gratë e viseve rurale dhe kryesuesit e fshatrave për identifikimin e prioriteteve të grave me qëllim të përfshirjes së perspektivës gjinore në rishikimin dhe planifikimin e buxhetit të komunës, përkrahja dhe zbatueshmëria e ligjeve në lidhje me barazinë gjinore, zbatimi, monitorimi i tyre dhe raportimi mbi zbatueshmërinë e tyre - janë disa nga aktivitetet kyçe të planifikuara për vitin 2021 në kuadër të ZBGJ-së.

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

Në kuadër të këtij dokumenti të qeverisjes së Rahovecit, këtu po paraqesim edhe objektivat kryesore të drejtorive komunale.

Secila drejtori është përgjegjëse që në harmoni me objektivat strategjike të qeverisjes së komunës së Rahovecit të përcaktojë planin e vet të punës dhe ta realizojë të njëjtin, gjithherë duke qenë në shërbim të qytetarëve.

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË

Drejtorja e Administratës në kuadër të fushëveprimtarisë së saj, në bazë të kompetencave dhe autorizimeve ligjore, me qëllim që të ngritet niveli i performancës së kësaj drejtorie harton planin e punës për vitin 2021.

DA këtë plan do të mundohet ta arrijë përmes:

- Bashkëpunimit me MAPL, MPB, MAP dhe ministritë e tjera të rëndësishme si dhe me institucionet vendore dhe ndërkombëtare,
- Bashkëpunimi me organizatat qeveritare dhe joqeveritare me qëllim të funksionalizimit të shërbimeve dhe realizimit të planit të punës për vitin 2021.

Për të promovuar performancë më të avancuar të shërbimeve cilësore për qytetarët e komunës së Rahovecit, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, paraqet planin vjetor të punës për vitin 2021 të kategorizuar në periudha tremujore.

Tremujori i parë i vitit 2021: janar, shkurt, mars

- Përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, synohet ngritja e bashkëpunimit me të gjitha drejtoritë e administratës komunale, organet e komunës dhe njësitë e tjera për shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave/lëndëve brenda afateve ligjore,
- Qysh në fillim vit do të kujdesemi që të pajisemi me numër të mjaftueshëm të certifikatave në mënyrë që të përballojmë fluksin e qytetarëve e në veçanti edhe të mërgimtarëve tanë të cilët pajisen me dokumente,
- Mbikëqyrja e rrjetit, serverëve, kompjuterëve, pajisje të tjera të teknologjisë informative
- Përgatitja dhe organizimi i seancave të rregullta, seancat e jashtëzakonshme dhe seancat emergjente (gjatë tërë vitit),
- Përgatitja e materialit për mbledhjet e Kuvendit, dërgimi i materialit dhe ftesës MAPL-së dhe kuvendarëve me anë të e-mailit (gjatë tërë vitit),
- Shpalljen e procedurave për E-Kiosqet e reja,
- Parapërgatitjen e procedurave për riparimin e objekteve të gjendjes civile,
- Përgatitjen e procedurave për inventar dhe nevoja të tjera për administratën komunale,
- Të gjitha vendimet e nxjerra nga Kuvendi do të procedohen më tutje sipas rregulloreve dhe ligjeve në fuqi, të njëjtat do të kujdesemi që të arkivohen në mënyrën më të mirë të mundshme.

Tremujori i dytë i vitit 2021: prill, maj, qershor

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

- Planifikojmë që të përgatisim trajnime në lidhje me përdorimin e sistemeve elektronike për stafin e komunës,
- Mirëmbajtja e serverëve,
- Përgatitja profesionale dhe teknike e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komiteteve tjera të parapara me Statutin e Komunës, bazuar në kalendarin vjetor për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve (gjatë tërë vitit),
- Përgatitja e procedurave për ndërtimin e ashensorit të ri në objektin e ri të komunës së Rahovecit,
- Përkthimi i të gjitha materialeve të Kuvendit, Komiteteve, Bordit të Drejtorëve dhe organeve tjera komunale, si dhe përkthimi stimulant i seancave të rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit, Komiteteve dhe takimeve tjera të institucioneve komunale (gjatë tërë vitit).

Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2021 synimi ynë kryesor është ofrimi i shërbimeve të modernizuara. Do të kujdesemi që stafi të jetë i përgatitur me njohuri, gjithmonë duke u bazuar në ligjet aplikative, menaxhimi dhe kontrollimi i punës së përditshme të shërbimit të stafit dhe në terren, efikasiteti dhe efektiviteti i shërbimit, azhurnimi i punëve sektoriale, trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve, respektimi i akteve ligjore.

Tremujori i tretë i vitit 2021: korrik, qusht, shtator

- Muajt korrik dhe qusht do të shpallen si muajt e mërgimtarëve, ku përveç aktiviteteve kulturore artistike, në Administratë do të rriten shërbimet për qytetarë dhe zyrtarët komunalë të Administratës do të punojnë me orar të zgjatur. Në kuadër të "Muajit të Mërgimtarëve", do të hapet edhe një sportel i veçantë për mërgimtarë, gjithashtu do të kujdesemi për parking të veturave që të ketë vend të mjaftueshëm për mërgimtarët tanë,
- Lidhja e ndërtesës së Bibliotekës dhe muzeut me rrjetin Qeveritar,
- Në sektorin e arkivit do të bëhet pranimi dhe arkivimi i lëndëve të përfunduara nga ana e drejtorisë, të gjitha lëndët do të arkivohen në depo të komunës në pajtim me ligjin (gjatë tërë vitit),
- Organizimi i punëve të arkivit komunal përmes një protokollit hyrës, si dhe shpërndarja e lëndëve nëpër organet e komunës, drejtoritë e Administratës si dhe njësitë e tjera.

Tremujori i katërt i vitit 2021: tetor, nëntor, dhjetor

- Do të vizitohen të gjitha zyrat e gjendjeve civile në bashkësi lokale, në mënyrë që të evidentohet çdo nevojë ose kërkesë e zyrave të vendit për shërbime sa më cilësore për qytetarët tanë,
- Kontrollimi i kablllove dhe pajisjeve të rrjetit, pastrimi i rregullt i serverëve, bartja e incizimeve të mbledhjeve, koordinimi me ASHI për licenca, instalimi i printerëve, instalimi i pajisjeve transmetuese,
- Servisimi i radiatorëve me rreze infra të kuqe,
- Mirëmbajtja e objekteve të komunës,
- Servisimi i automjeteve zyrtare,
- Sigurimi i automjeteve zyrtare.

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021 synimi ynë kryesor është rritja e përkushtimit dhe disiplinës në respektim të procedurave dhe ligjit, digjitalizim i avancuar i shërbimeve administrative, transparencë në vendimarrje dhe procedura ekzekutive, bashkëpunim në diversitet mendimesh.

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Drejtorja për DSHPS, për vitin 2021 planifikon rritjen e kapaciteteve të kuadrove mjekësor, modernizimin e shërbimeve shëndetësore, zbatimin e projekteve të hartuara gjatë planifikimit, me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve të komunës së Rahovecit.

DSHPS këtë plan do të mundohet ta arrijë përmes:

- Implementimit të projekteve kapitale në shëndetësi;
- Përkrahjes së mjekëve dhe personelit shëndetësor;
- Shërbimeve këshillimore për pacientë dhe
- Bashkëpunimit me Ministrinë e Shëndetësisë dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në fushën e shëndetësisë.

Plani për shëndetësi ka tri qëllime kryesore:

- T'ju ofrojë qasje të shërbimeve shëndetësore të gjithë qytetarëve;
- Sistemi i përmirësimit të cilësisë, ju garantojmë që shërbimet e ofruara shëndetësore do të jenë të cilësisë së lartë, duke e ngritur kështu kënaqësinë e qytetarëve me shërbimet e ofruara;
- Resurset humane, përmes zhvillimit të burimeve njerëzore, të përmirësojë mirëqenien materiale dhe profesionale të punëtorëve shëndetësorë.

Përmirësimi i qasjes në shërbimet shëndetësore

- Do të vazhdojmë me konsolidimin e rrjetit ekzistues të institucioneve shëndetësore dhe riorganizimin e tyre për t'i plotësuar nevojat e qytetarëve,
- Do të vazhdojmë me krijimin e reparteve të reja shëndetësore në QKMF
- Ngritja e përgjegjësisë individuale dhe stimuluese për punëtorë të institucioneve shëndetësore,
- Sistemi i Komunikimit-SISH-i, komunikimi me institucionet shëndetësore, komunitetin, pacientin dhe personelin mjekësor.

Mjekësia familjare

Zbatimi i konceptit të mjekësisë familjare

Zbatimi i konceptit të mjekësisë familjare në praktikën e përditshme nuk është në nivelin e dëshiruar. Këtu ka mungesë të zoonimit të popullatës, mungesa e SISH, koncentrimi *numrit* të madh të shërbimeve në QKMF, mungesa e informatave kthyes nga niveli sekondar për vazhdimësinë e shërbimeve shëndetësore. Prandaj, ne do të vazhdojmë të bëjmë shpërndarje racionale të punkteve të AMF-ve nëpër hapësirat që janë më larg QMF-ve, ku një mjek dhe dy infermierë do të mbulonin 2000-2500 banorë të komunitetit. Me zoonimin e popullatës, kjo do t'ju mundësojë qasje më të lehtë qytetarëve (pacientëve), si dhe do të rritë mundësitë e punës aktive të punëtorëve shëndetësorë.

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

SISH-i parasheh që secili pacient ta ketë dosjen, që do të krijojë mundësi për informata kthyesë nga niveli sekondar dhe terciar.

Ofrimi i përkujdesjes shëndetësore shtëpiake do të jetë vazhdimësi për të moshuarit, të vetmuarit dhe personat me regjim shtrati. Kjo do të realizohet përmes -(Caritas Kosova).

Mjekësia parashkollore dhe shkollore

Gjatë kësaj periudhe do të aktivizohen vizita shëndetësore sistematike, në të ardhmen rregullisht do të kryhen vizita sistematike për fëmijët parashkollor dhe nxënësit e shkollave të mesme të ulëta e të larta në të gjitha shkollat e komunës së Rahovecit.

Shërbimi stomatologjik

- Çdo QMF do të ketë karrige stomatologjike dhe stomatolog;
- Sigurimi i materialit për punë dhe punësimi i stomatologëve;
- Në QKMF-ë do të rrisim numrin e stomatologëve;
- Mbikëqyrja e plotë e stomatologjike e qytetarëve, me evidentimin e Sistemit informativ shëndetësor, do të ketë edukim permanent të qytetarëve për shëndetin oral.

Shërbimi farmaceutik

Komuna do të garantojë qasje nga lista esenciale që do të ri-vlerësohet çdo vit. Këto barna do të merren pa pagesë. Do të sigurohen barna edhe nga të hyrat vetjake të komunës dhe nga donacionet.

Rritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore

- Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve shëndetësore,
- Sigurimi i pajisjeve moderne mjekësore për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ekzistuese dhe zhvillimi i shërbimeve të reja për qytetarët (diagnostike)
- Ngritja e shërbimit të tillë të informatave në shëndetësi që do të sigurojnë shërbime të plota dhe në vazhdimësi për të gjithë qytetarët, SISH,
- Planifikim i mirë për nevojat e punëtorëve shëndetësor,
- Ngritja e protokolleve dhe planeve të menaxhimit të të sëmurëve për të gjitha patologjitë që trajtohen në nivel primar,
- Sigurimi i barërave dhe produkteve medicinale nga lista esenciale dhe propozim për zgjerimin e vazhdueshëm të kësaj liste,
- Sistemi i planifikimit të edukimit të vazhdueshëm medicinal për personelin mjekësor për ta përditësuar dhe mbajtur në nivel të lartë cilësinë e shërbimeve shëndetësore që i ofrohen qytetarit,
- Shërbimet e edukimit shëndetësor për popullatën,
- Themelimi dhe mbështetja e grupeve për mbështetje për të sëmurit kronik dhe të sëmurit në stadin terminal,
- Sigurimi i mbrojtjes shëndetësore të plotë dhe cilësore për grupet vulnerable dhe personat me nevoja të veçanta.

Përmirësimi i mirëqenies së punëtorëve shëndetësorë (resurset humane)

- Sigurimi i kushteve dinjitoze për punë dhe rritja e sigurisë për punë;

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

- Rritja e numrit të mjekëve të rinj, do të motivohen mjekët e rinj për specializim në mjekësinë familjare.

Sektori i shëndetit publik

- Imunizimi-parandalimi i sëmundjeve ngjitëse, do të vazhdojë të kryhet vaksinimi në mënyrë të rregullt kundër sëmundjeve ngjitëse;
- DDD;
- Kontrolli i ujit të pijshëm, analizat bakteriologjike, kimike, përmes IKSHPK-së.

Financimi i shërbimeve shëndetësore

- Buxheti i Kosovës;
- Të hyrat vetjake të Komunës;
- Bashkëpagesat (participimi);
- Kërkim aktiv i donacioneve.

Sektori për mirëqenie sociale

- Përkujdesje ndaj kategorive të dala nga lufta,
- Përkujdesje ndaj personave me nevoja të veçanta,
- Përkujdesje pensionistëve, në forma të ndryshme qoftë shëndetësore apo sociale,
- Përkrahje OJQ-ve që ndërlidhen me mirëqenien sociale,
- Përkujdesje ndaj personave të pastrehë,
- Ofrimi i shërbimeve sociale në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët në nevojë, përmes organit të kujdestarisë, Qendrës për Punë Sociale, gjetja e familjeve strehuese, caktimi i kujdestarëve, ndihmë momentale për familjet dhe personat në nevojë.
- Duke ju mundësuar të gjithëve qasje në objektet shëndetësore dhe duke u siguruar që qytetarët tanë të jenë të mbrojtur.

Duke u bazuar në planifikimin e buxhetit, përcjelljen e thirrjeve të MSH-së për aplikim të fondeve dhe të granteve, si dhe detyrave të tjera, prioritetet e drejtorisë do të kategorizohen në periudha tremujore.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

DSHPS do të vazhdojë me respektim të masave dhe rekomandimeve të dala nga IKSHPK, dhe MSH, kundër pandemisë Covid-19.

DSHPS, qysh në janar do të kujdeset që të hapet reparti i hemodializës, në bashkëpunim edhe me Transfuzionin Kombëtar të Gjakut do të hapim një njësi të transfuzionit të gjakut e cila do të shërbejë për nevojat e pacientëve në dializë.

Poashtu, DSHPS-ja do të përgatitet që të jetë e gatshme të përballojë fluksin e pacientëve në raste të gripave virusale, dhe në funksion të mbrojtjes nga pandemia COVID-19, njëashtu në dy QMF-të, në dy lokalitete të mëdha, si në: Krushë të Madhe dhe Ratkoc do të vazhdojmë të ofrojmë shërbime mjekësore për qytetarët tanë me dy ndërtime .

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

Duke u bazuar në planin e prokurimit, do të iniciohen edhe procedurat e shpalljes së tenderëve për zbatimin e projekteve kapitale si dhe përcjellja e realizimit të projekteve që janë në vazhdim, me theks të veçantë:

- Meremetimi i Repartit të Pediatriisë dhe Stomatologjisë;
- Ndërtimi i AMF-së në Lagjen e Epërme;
- Shpalljen e procedurave të prokurimit për furnizime në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve;
- Furnizimi me pajisje mjekësore për nevojat e QKMF-së.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

Gjatë kësaj periudhe planifikohet të bëhet përgatitja e stafit për njësinë e emergjencës, ku do të trajnohen ekipet e veçanta për këtë njësi.

Prioritet kyç në tremujorin e dytë është përfundimi i plotë i objektit të ri të QMF-së, në Optrushë në të cilën qytetarët e kësaj zone do të marrin shërbime mjekësore më cilësore.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

Periudhën e tretë të vitit 2021 do ta karakterizojë furnizimi me vaksinat kundër gripit sezonal për të moshuarit, përcjellja e projekteve të investimeve kapitale në këtë tremujor, si dhe shpërndarja në mënyrë të drejtë e subvencioneve për ndihma momentale.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

Fokus i periudhës së fundit të vitit do të jetë përcjellja e punimeve në investime kapitale, sigurisht se prioritet kryesor do të jetë realizimi i buxhetit, do të kujdesemi që punët e kryera të mbikëqyren dhe të shpenzohet buxheti në përpikmëri, si dhe planifikimi i buxhetit për vitin e ardhshëm.

DREJTORIA PËR ARSIM

Përmes këtij plani, Drejtoria për Arsim për vitin 2021 do të realizojë aktivitetet e shumta me qëllime, synime dhe prioritetet e qarta.

Qëllimet kryesore të DKA-së janë:

- Përmirësimi i kushteve për mësimdhënie frytdhënëse;
- Mbarëvajtja e procesit edukativo arsimor, dhe
- Arritja e sukseseve më të mëdha të nxënësve të të gjitha niveleve.

Synimet kryesore të DKA-së për vitin 2020 janë:

- Funksionalizimi i plotë Ekipeve për Parandalimin dhe Reagimin kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të nxënësve (EPRBM) nëpër shkollë;
- Funksionalizimi i plotë i aktivave profesionale (AP) në secilën shkollë;
- Riparimet dhe investimet në efikasitet të energjisë në objektet shkollore;
- Përfundimi i investimeve të planifikuara në ndërtimin e çerdheve për fëmijë;
- Përfundimi i projekteve për ndërtimin e shkollave të reja të filluara nga viti 2018 dhe 2019;

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

- Furnizimi i shkollave me libra, pajisja me mjete konkretizimi e laboratorike, me pako pedagogjike dhe teknologji informative.

Prioritetet themelore të DKA-së për vitin 2020 janë:

- Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve shkollore;
- Mbarëvajtja e procesit edukativo arsimor;
- Nxitja e nxënësve për të mësuar përmes organizimit periodik të garave të diturisë në secilin nivel arsimor;
- Ngritja e cilësisë në arsim.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

Në tremujorin e parë, përveç që do të analizohet vijueshmëria dhe suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të parë, do të bëhen përgatitjet e nevojshme për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë. Do të mbajmë aktive aktivet profesionale në secilën shkollë, të cilat do të jenë në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me Ekipin Profesional Monitorues dhe Vlerësues (EPMV) të DKA-së. Nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë, presim të fillojë implementimi i projekteve të fituara nga Komuna jonë për zbatimin e Masave të Eficiencës së Energjisë në 5 shkolla dhe do të zhvillojmë aktivitete kulturore dhe garuese me nxënës për nder të festive të 17 shkurtit dhe 7 Marsit. Në muajin janar do të nisim procedurën e prokurimit për kontratën e furnizimit të çerdhes për fëmijë me ushqim e pije, ndërsa në muajin mars do të nisim procedurën për realizimin e kontratës për furnizimin e bibliotekave të shkollave me libra.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

Në tremujorin e dytë, Ekipi Profesional Vlerësues dhe Monitorues i DKA-së do të angazhohet në të gjitha shkollat dhe do të koordinojë veprimet me aktivet profesionale të shkollave, për t'u siguruar që ecuria e procesit të realizimit të planprogrameve mësimore dhe pakos pedagogjike po ecën mirë. Do të mbajmë gara të diturisë me nxënësit e të gjitha niveleve dhe të shumicës së lëndëve mësimore. Poashtu, do të bëhen përgatitje dhe do të organizohet testi i maturës për nxënësit e klasave të 12-ta dhe testi i arritshmërisë për nxënësit e klasave të 9-ta. Do të zhvillojmë takimet e rregullta me drejtorët e shkollave, me ç'rast do të bëhet një analizë e përgjithshme e procesit mësimor gjatë vitit mësimor. Në këtë periudhë do të nisen procedurat e prokurimit për lidhjen e kontratave për projektin e ndërtimit të rrethojës së shkollës "Rilindja" në Çifllak, për projektin e instalimit të ngrohjes qendrore në SHML "Xhelal Hajda-Toni" dhe për projektin e pajisjes së shkollave me mjete konkretizimi dhe laboratorike. Poashtu, në këtë periudhë, DKA do të pranojë dhe analizojë raportet e punës së dy ekipeve, EPRMB-së dhe EPMV-së dhe do të përcjellë hap pas hapi ecurinë e ndërtimit të shkollave dhe çerdheve.

Në gjashtëmujorin e parë synimi ynë kryesor do të jetë përmbyllja e vitit mësimor me një zvogëlim të ndjeshëm të mungesave të nxënësve, sidomos në Shkollat e Mesme të Larta dhe ngritja e nivelit të cilësisë në Arsim, në të gjitha nivelet. Poashtu, në kuadër të DKA-së në këtë periudhë do të nisin procedurat për shumicën e projekteve të parashikuara.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

Në tremujorin e tretë, do të bëhet planifikimi i kuadrit mësimor për vitin shkollor 2021/2022 si dhe do të fokusohemi edhe në riparimin e objekteve shkollore përmes zbatimit të kontratës për Riparime në

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

Shkolla Lot1 dhe Lot2. Do të analizohen sukseset dhe mangësitë e vitit shkollor 2020/2021 dhe do të bëhen përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022. Do të nisim procedurat e prokurimit për projektin "Mirëmbajtja e ngrohjeve qendrore në shkollat e komunës së Rahovecit". Të gjitha SHFMU-të do të furnizohen me tekste mësimore dhe do të marrim të gjitha masat e nevojshme që viti i ri shkollor të fillojë mbarë në të gjitha shkollat. Në këtë periudhë, do të bëhet gati edhe planifikimi i projekteve kapitale për arsim për vitin pasues 2022, dhe përmes kontratave të lidhura do të bëhet furnizimi i bibliotekave të shkollave me libra, mjete konkretizimi, pajisje laboratorike dhe të teknologjisë informative. Do të bëhet furnizimi me lëndë djegëse për ngrohje për të gjitha shkollat dhe institucionet edukativo arsimore para muajit Nëntor dhe do të përcillet vazhdimisht realizimi i projekteve kapitale në fushën e arsimit.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

Në tremujorin e katërt, do të mbahen takime me drejtorët e shkollave dhe me koordinatorët e cilësisë për mbarëvajtjen e procesit edukativo arsimor për periudhën e parë vlerësuese të vitit të ri shkollor dhe për ecurinë e zbatimit të planprogrameve mësimore. Gjithashtu, EPMV do të vizitojë të gjitha shkollat, me ç'rast do të koordinojë veprimet me aktivet profesionale të shkollave. Drejtori i DKA-së do të realizojë takime të njëpasnjëshme me këshillat e arsimtarëve të çdo shkollë.

Në gjatëmujorin e dytë, synojmë t'i arrijmë qëllimet tona për t'i realizuar dhe përfunduar të gjitha projektet kapitale dhe projektet që kanë të bëjnë me mallra e shërbime për furnizimin e shkollave. Të gjitha këto në funksion të ngritjes së cilësisë në Arsim.

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Buxheti publik efikas

- Planifikimi i buxhetit hartohet nëpërmjet debateve me qytetarë;
- Projekte për thithjen e fondeve qeveritare –Investime kapitale;
- Zgjerimi i bazës së të hyrave vetanake.

Politikat e taksave dhe e të hyrave komunale

- Me programin zhvillimor politika e taksave komunale do të pësojë ndryshime pozitive në bashkëpunim me ligjet e financave publike, por edhe ndërmarrjes së hapave ambicioz dhe lehtësues për qytetarët;
- Politika gjithëpërfshirëse, reale dhe optimale;
- Zgjerimi i bazës dhe gjetja e burimeve të reja të taksave komunale.
- Tatimi në pronë, taksa urbanistike.

Politika buxhetore e të hyrave

- Të hyra për shërbimet komunale –shërbimet ndaj qytetarëve dhe
- Të hyra për përmirësimin e jetës së qytetarëve (investimet kapitale)

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

Rezultatet kryesore	Masat mbështetëse:
➤ Maksimizimi i të hyrave; ➤ Përmirësimi i kënaqshmërisë qytetare për të gjitha shërbimet.	➤ Ngritja e kompetencave për taksat lokale ; ➤ Ueb faqja dhe përfshirja e përmirësuar ➤

Në bazë të detyrave dhe obligimeve të cilat dalin nga fushëveprimtaria e saj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa me Planin e Punës për Vitin 2021 parasheh realizimin e këtyre objektivave:

AKTIVITETET PËRSHKRIMI	PERIUDHA E KRYERJES	EKZEKUTUESI
Pasqyrat vjetore financiare 2020	Janar 2021	Drejtori i drejtorisë dhe ZKF
Përgatitja e raportit financiar për kuvend 2020	Janar 2021	Drejtori i drejtorisë dhe ZKF
Rrjedha e Parasë (Plani CASH)	Janar 2021	Drejtori i Drejtorisë dhe ZKF
Përgatitja dhe shpërndarja e faturave të tatimit në pronë	Shkurt 2021	Sektori i Tatimit në Pronë
Përgatitja për fillimin e implementimit të tatimit në tokë (nëse implementohet)	Janar 2021	Sektori i Tatimit në Pronë
Regjistrimi dhe verifikimi i objekteve rezidenciale, biznesore, industriale etj	Permanente	Sektori i Tatimit në Pronë
Plan strategjia e realizimit të të hyrave komunale (tatimi në pronë, toka) në raport me planifikimin (I përfunduar)	Permanente	Sektori i Tatimit në Pronë
Planstrategjia e zgjerimit-rritjes të inkasimit hyrave nga: tatimi në Tokë, legalizimi i objekteve, participimet nga bujqësia etj.	Permanente	Drejtori i drejtorisë në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë
Përgatitja e raportit tre mujor financiar 2021	Prill 2021	ZKF
Përgatitja e KAB-it komunal 2021-2023, sipas qarkoreve buxhetore I dhe II	Qershor 2021	Drejtori i drejtorisë në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë
Dërgimi i raportit të auditimit për vitin 2020 në kuvend, i audituar nga ana e Zyrës së Auditimit Kombëtar	Qershor 2021	Drejtori i drejtorisë
Raporti Financiar 6 (gjashtë) mujor, janar-qershor 2021	Korrik -2021	Drejtori i drejtorisë dhe ZKF
Mbajtja e dëgjimeve buxhetore me qytetarë nga ekzekutivi dhe KPF	Qershor- Gusht 2021	Drejtori i drejtorisë
Dorëzimi i KAB-it komunal 2022- 2024, për votim në kuvendin komunal	Shtator 2021	Drejtori i drejtorisë
Futja e të dhënave në sistemin PIP dhe BDMS	Korrik- Shtator 2021	Zyrtarët e certifikuar për sistem
Përgatitja e raportit nëntë mujor financiar 2021	Tetor 2021	Drejtori i drejtorisë dhe ZKF
Mbyllja e vitit fiskal 2021 me një përqindje të lartë të shpenzimit të buxhetit dhe me një përqindje të lartë të realizimit të të hyrave komunale	Dhjetor 2021	Drejtori i drejtorisë

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

Synim kryesor i DPF-së për vitin 2021 do të jetë, zvogëlimi i obligimeve financiare dhe kontraktuale në fund të vitit 2021 si dhe mbyllja e vitit fiskal 2021, me përqindje të lartë të shpenzimit të buxhetit, dhe me një përqindje të lartë të realizimit të të hyrave.

DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, në kuadër të Komunës së Rahovecit ka një rol kyç në planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë së zhvillimit, siguron koordinim vertikal dhe horizontal dhe komunikim me të gjithë aktoret relevantë në proces, si brenda administratës komunale ashtu edhe me nivelin qendror, komunitetin dhe më gjerë.

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm do të punojë sipas planit të punës të përgatitur në mënyrë profesionale dhe do të ndërmarrë veprime të përcaktuara qartë dhe harmonizuara me objektivat strategjike të Strategjisë Zhvillimore Komunale si dhe dokumente tjera programore që kanë për qëllim ndikimin në përmirësimin dhe avansimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik lokal. Ky plan është një përpjekje për të ndikuar në uljen e papunësisë përmes krijimit të një klime të favorshme të të bërit biznes, veprim ky i cili do të ndikojë në ngritjen e standardit të jetesës të të gjithë qytetarëve të Komunës së Gjilanit.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik do të ndërmarrë iniciativa të cilat qojnë në arritje të rezultateve konkrete dhe do t'i kushtohet vëmendje komunikimit konstruktiv me të gjitha institucionet relevante në nivel lokal dhe qendror, me donatorë, si dhe investitorë potencial të huaj dhe vendor. Po ashtu do t'i ofrohet mbështetje bizneseve fillestare dhe atyre ekzistuese të vogla e të mesme përmes aktiviteteve trajnuese, këshilluese duke përfshirë edhe promovimin e bizneseve lokale. Një aktivitet kyç i kësaj drejtorie do të jetë inkurajimi i krijimit të bizneseve të reja duke ofruar shërbime bizneseve sidomos atyre fillestare në përgatitjen e aplikacioneve për thirrje për grante nga burimet e ndryshme financiare.

Një synim tjetër ku do të kemi çasje pro aktive do të jetë joshja e investitorëve vendor dhe të huaj përmes ofrimit të informatave profesionale relevante. Në anën tjetër do të identifikohen bizneset të cilat kanë interesim për të zgjeruar aktivitetin e tyre biznesor dhe për të hyrë në partneritet me investitorë potencial.

DZHE do të jetë e kyçur aktivisht edhe sa i përket implementimit të të gjitha projekteve të financuara nga ana e donatorëve të ndryshëm me qëllim të koordinimit të aktiviteteve dhe maksimizimit të efektit të rezultateve të pritshme, e në të njëjtën kohë do të angazhohet edhe për identifikimin e donatorëve të mundshëm potencial në rastet dhe projektet që mund të identifikohen në ndërkohë gjatë këtij mandati.

OBJEKTIVAT KRYESORE TË PUNËS

- Hulumtimin e mundësive për të siguruar donacione dhe burime të tjera financiare për realizimin e projekteve zhvillimore,

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

- Hartimin e programeve sipas veprimtarive dhe sektorëve të ndryshëm ekonomik, dhe përgatitjen e propozimeve konkrete për projekte të rëndësishme të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e sektorëve të veçantë,
- Ofrimin e shërbimeve për regjistrimin e bizneseve - Qendra e Regjistrimit të Bizneseve
- Bashkëpunimi dhe koordinimi i projekteve lidhur me Partneritet Publiko Privat,
- Bashkëpunimin me Institucionet Ndërkombëtare dhe organizatave të ndryshme financiare për projekte të ndryshme zhvillimore e sidomos në projekte të investimeve kapitale,
- Koordinimi dhe bashkëpunimi me Organizatat jo Qeveritare që mund të përkrahin me projektet ideore të cilat kanë në fokus promovimin dhe zhvillimin ekonomik lokal,
- Bashkëpunimi i ngushtë me bizneset lokale lidhur me përmirësimin e klimës për të bërë biznes,
- Koordinimi dhe mbikëqyrja e realizimit të projekteve – bashkëfinancimi i projekteve të financuara në pjesën më të madhe nga donatorët, qeveria dhe komuniteti - Zotimet ndaj marrëveshjeve të nëshkruara,
- Organizimin e panjoreve për promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve,
- Komunikimin e vazhdueshëm me investitor potencial vendor dhe të huaj përfshirë diasporën me qëllim të informimit lidhur me lehtësirat, planet zhvillimore, projektet dhe mundësitë praktike që ofron Komuna në raport me investitorët,
- Promovimin e potencialeve turistike të komunës së Rahovecit në ndërlidhje me pakot e mundshme turistike në bashkëpunim me komunat tjera të rajonit.

Prioritetet e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm:

Duke u bazuar në planifikimin e buxhetit, përcjelljen e thirrjeve të MIT-së për aplikim të fondeve dhe të granteve, prioritetet e drejtorisë do të kategorizohen në periudha tremujore.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

Gjatë periudhës tremujore janar, shkurt dhe mars, DEZHT planifikon ofrimin e mbështetjes për bizneset fillestare dhe atyre ekzistuese të vogla e të mesme, përmes aktiviteteve trajnuese, këshilluese, duke përfshirë edhe promovimin e bizneseve lokale.

Planifikimi dhe regjistrimi i të gjitha subjekteve afariste prej librit kryesor të vitit 2020 dhe regjistrimi në librin e ri të vitit 2021, kalkulimi i ngarkesave për vitin 2021 në formë elektronike, përpilimi dhe analizimi i ngarkesave të taksës afariste komunale për vitin 2021, mirëmbajtja e sistemit të pasurisë financiare dhe jo financiare, do ta karakterizojnë këtë periudhë tremujore.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

Regjistrimi i aseteve kapitale, mbikëqyrja dhe inkasimi i të hyrave në qira, si dhe mbikëqyrja e objekteve afariste komunale gjatë gjithë vitit, lidhja e kontratave të reja, rritja e inkasimit të të hyrave në taksë afariste komunale, ofrimi i shërbimeve për regjistrimin e bizneseve do të vazhdojnë ta karakterizojnë këtë periudhë tremujore.

Hartimi i programeve sipas veprimtarive dhe sektorëve të ndryshëm ekonomik, si dhe përgatitja e propozimeve konkrete për projekte të rëndësishme të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e sektorëve të veçantë - janë synim i yni, me fokus të veçantë, për vitin 2020.

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

Gjatë periudhës së tretë të vitit 2021, DEZHT planifikon të vazhdojë me shpërndarjen e të gjitha aktvendimeve të bizneseve për ngarkesën e taksave dhe të saldoeve ose (obligimeve të mbetura), si në taksa afariste komunale dhe në qira.

Tremujori i katër: tetor, nëntor, dhjetor

Në periudhën e katërt të vitit 2021 në bashkëpunim me DBPZHR-në, do të përkujdesemi të bëjmë organizimin e panairit dimëror, padyshim që prioritet i DEZHT-së mbetet realizimi i buxhetit në përpikmëri si dhe rritja e të hyrave komunale nëpërmjet inkasimit të të hyrave nga taksat dhe qiraja.

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ka hartuar planin vjetor të punës duke u bazuar në prioritetet strategjike dhe të nevojave të adresuara nga qytetarët e komunës. Duke u bazuar edhe në përvojën e viteve të kaluara, plani vjetor i punës për vitin 2021 është hartuar me kujdes të veçantë, në mënyrë që të jetë i kompletuar në aspektin e zbatimit dhe përmbushjes së vizionit të qeverise komunale. Planin është i ndarë në katër periudha tre mujore.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

Në tremujorin e parë si dhe në tremujoret e tjerë të vitit 2021, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, planifikon që të bëjë shqyrtimin e të gjitha kërkesave nga qytetarët në afatin minimal ligjor, siç janë: lejet ndërtimore, lejet e rrënit, kushtet ndërtimore, lejet mjedisore komunale, pëlqimet, vërtetimet urbanistike, njoftime dhe shkresa të ndryshme rreth zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe planeve të tjera rregulluese, si dhe mbrojtjes së mjedisit.

Rritja e të hyrave vetanake përmes lëshimit të lejeve ndërtimore, procesit të legalizimit dhe lejeve mjedisore komunale, në bashkëpunim me Drejtorinë për Punë Inspektuese, legalizimi i objekteve pa leje dhe respektimi i ligjit të ri për trajtimin e objekteve pa leje, hartimi i planeve rregulluese urbane, sipas ligjeve të reja të planifikimit hapësinor do të vazhdojnë ta karakterizojnë këtë periudhë tremujore.

Zbatimin e Planit të Prokurimit për nisjen e procedurave të prokurimit publik në afatin e përcaktuar në plan. Hartimin e projekteve në bazë të prioritetëve edhe për Drejtoritë tjera dhe hartimi i projektit zbatues për Sheshin Qendror të Qytetit, si projekti më i madh i vitit 2021.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

Miratimi i Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit, rritja e kualitetit të hartimit të projekteve të ndryshme për investime, përmes revidimit ose kontrollit dhe pranimin nga një komision profesional komunal, rritja e kualitetit të mbikëqyrjes, rrjedhimisht të punimeve në projektet kapitale, duke punuar ngushtë me organin mbikëqyrës, përkrahja e iniciativave në ruajtjen e mjedisit, shënimi i ditëve ndërkombëtare të tokës, ujit, mjedisit - janë disa nga planifikimet kyçe të DUPMM-së për këtë periudhë tremujore.

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, synim kryesor kemi hartimin e projektit kryesor të sheshit qendror të Rahovecit dhe nisjen e punimeve në këtë projekt. Rritjen e të hyrave vetanake përmes lëshimit të lejeve ndërtimore, procesit të legalizimit dhe lejeve mjedisore komunale, në bashkëpunim me Drejtorinë për Punë Inspektuese. Legalizimin e objekteve pa leje dhe respektimin e ligjit të ri për trajtimin e objekteve pa leje. Gjithashtu zbatimin e plotë të planit të prokurimit dhe shpalljen e të gjitha projekteve kapitale të parapara për vitin 2021 nga buxheti i Komunës së Rahovecit.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

Aplikimi i masave të EE-së në projekte të ndryshme kapitale, shndërrimi i deponive ilegale në hapësira të gjelbëruara, parkingje të reja në qytet, ndërtimi i memorialëve për heronjtë e dëshmorë, i komplekseve të dëshmorëve e martirëve, rregullimit të varrezave, pllakave përkujtimore, shtatoreve, busteve, vazhdimi i trajtimit të shtretërve të lumenjve dhe përrenjve, përmes investimeve kapitale nga Komuna e Rahovecit dhe mbështetjes nga Qeveria e Kosovës, me qëllim mbrojtjen nga vërshimet dhe ruajtjen e mjedisit, krijimi i hapësirave të reja të gjelbëruara, rregullimi i parqeve dhe mbjellja e drunjtëve, hartimi i planeve rregulluese dhe projekte konkrete në hapësira publike me pjesëmarrjen e qytetarëve e me mbështetje teknike nga organizatat joqeveritare të planifikimit urban.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

Fokusi i periudhës së fundit të vitit do të jetë: menaxhimi sa më efektiv i projekteve kapitale të menaxhuara nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bashkëpunim me organin mbikëqyrës, sigurisht, se prioriteti kryesor do të jetë realizimi i buxhetit.

Rritja e përkushtimit në mbrojtjen e mjedisit, pastrimit të deponive ilegale, në bashkëpunim me Drejtorinë për Shërbime Publike, është poashtu prioritet kyç i kësaj drejtorie.

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021, synim kryesor kemi vazhdimin e trajtimit të shtretërve të lumenjve dhe përrenjve, përmes investimeve kapitale nga Komuna e Rahovecit dhe mbështetjes nga Qeveria e Kosovës, me qëllim mbrojtjen nga vërshimet dhe ruajtjen e mjedisit, krijimi i hapësirave të reja të gjelbëruara, rregullimin e parqeve dhe mbjelljen e drunjve.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Drejtoria për Shërbime Publike për vitin 2021 planifikon rritjen e investimeve në infrastrukturë publike, në ndriçim publik, ndërtimin e rrugëve lokale, zgjerimin e rrjeteve të kanalizimeve fekale si dhe trajtimin e tyre përmes gropave septike, mirëmbajtjen e hapësirave publike si dhe investimeve tjera të nevojshme që janë prioritet për qytetarët e komunës sonë.

DSHP këtë plan do të mundohet ta arrijë përmes:

- Implementimit të projekteve kapitale në infrastrukturë publike, në rrugë, në ndriçim publik, në zgjerim të rrjeteve të ujërave fekale dhe atmosferike, në trotuare si dhe në projekte tjera në interes të qytetarëve,
- Mirëmbajtjes së rrugëve, gjatë dy sezoneve,
- Mirëmbajtjen e hapësirave publike, parqeve, varrezave, lapidarëve, si dhe projekteve tjera që janë implementuar dhe kanë nevojë për mirëmbajtje,
- Implementimin e disa projekteve që janë bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës, MPL-së, MMPH-së si dhe grandet e fituara nga donatorë të ndryshëm si dhe nga grandit i performancës.

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

Prioritetet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike

Duke u bazuar në planifikimin e buxhetit, si dhe në planifikimin e bërë nga Drejtoria për investime publike, prioritetet e drejtorisë do të kategorizohen në periudha tremujore.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

- Pastrimin e rrugëve dhe trotuareve nga bora dhe intervenimet e tjera emergjente (Janar-Shkurt-Mars 2021);
- Intervenimet emergjente në infrastrukturë (Janar-Shkurt-Mars 2021)
- Heqjen e deponive ilegale të inerteve (Gjatë tërë vitit 2021);
- Analizimin e kontratave dhe përmbushjen e tyre në projektet si: trotuare, rrugë, rreth-rrotullime, hapësira publike, mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve, të martirëve, të civilëve, po ashtu, të shesheve, pllakave përkujtimore, të hapësirave të gjelbëruara etj.(Gjatë tërë vitit 2021);
- Hartimin e projekteve të reja për ndërtimin e rrjeteve të kanalizimit, të rrugëve, ndriçimit publik, trotuareve, etj;
- Mbledhja e të hyrave nga sipërfaqet publike sipas rregullores së DSHP-së;
- Mirëmbajtjen e rregullt të kanaleve të ujërave fekale nga kompania KRU-Gjakova si dhe investime të reja në ndërrim të gypave të ujit, zgjerime në ujësjellës dhe investime të reja në bashkëfinancim me komunën;

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

- Ndërtimin e rrugëve në qytet dhe fshatrat e komunës sipas prioriteteve dhe planit të prokurimit (2021);
- Ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimeve dhe ndërhyrjet emergjente në disa vendbanime të komunës së Rahovecit (2021);
- Ndërtimin e trotuareve në qytet dhe fshatrat e komunës sipas prioriteteve (Gjatë tërë vitit 2021);
- Ndërtimin e semaforëve të rinj në qytet-vazhdim (Maj-Qershor 2021);
- Hapjen e procedurave për disa punë si: rrugët lokale qytet-fshat, përmirësimi i kanalizimeve, furnizimin me ujë të pijshëm për fshatrat Zatriq, Mirasor dhe Kaznik në bashkëfinancim me KRU Gjakovën, mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe atyre në qytet, muret mbrojtëse sipas prioriteteve etj;
- Pas kategorizimit të rrugës qarkore në Rahovec, do të angazhohemi në ç'pronësimin e pronave përmes departamentit për ç'pronësime në MMPH;
- Fillimin e punëve me projektin për sinjalizim horizontal dhe vertikal të rrugëve(Gjatë tërë vitit 2021);
- Vendosjen e disa pengesave në rrugë sipas standardeve të përcaktuara;
- Inicimin, analizimin e madhësisë dhe dendësisë së qarkullimit në rrugët e qytetit për verifikimin e senseve të lëvizjes;
- Krijimi i parkingjeve të reja në qytet;
- Krijimin e infrastrukturës së nevojshme për personat me nevoja të veqanta;
- Në bashkëpunim me policinë e Kosovës dhe kompaninë për autobartje të veturave, do të ketë angazhim gjatë gjithë vitit 2021;
- Ndriçimin publik në qytet dhe në të gjitha fshatrat e komunës sonë.

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

- Ndërtimin e rrugës Rahovec-Potoqan si dhe për Fortesë, fazën përfundimtare;
- Vazhdimin e ndërtimit të rrugëve lokale qytet dhe në të gjitha vendbanimet e komunës sonë;
- Ndërtimin e rrugëve në Zatriq si dhe disa pjesëve të kanalizimit;
- Vazhdimin e projektit të rrugëve sipas marrëveshjeve me MIT, rruga Rahovec-Hamoc-Fortesë, rruga Xërxë Sapniq-Ratkoc si dhe rruga katër korsi Rahovec –Xërxë (Korrik-Gusht-Shtator 2021);
- Parapërgaditje për planin e ri të menaxhimit të mbeturinave, pas skadimit të afatit të planit të vjetër 2016-2021;
- Fillimi i implementimit të planeve tjera për mbeturina, atyre të ngurta dhe ato të vëllimshme.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

- Trajtimin, largimin e qenve endacak në bazë të marrëveshjes së AVUK-it me kompanitë private të licencuara për trajtimin e tyre;
- Infrastruktura në stacionin e autobusëve-vazhdim;
- Menaxhimi i deponive për mbeturina nga demolimet dhe ndërtimet;
- Eliminimin e të gjitha deponive ilegale- inerteve;
- Në bashkëpunim me KEDS do të caktojmë prioritet për shtrirjen e rrjetit elektrik si dhe vendosjes së trafave sipas kërkesave të qytetarëve;
- Përmbylljen e disa projekteve kapitale;
- Përgatitjen në fund-vit për mirëmbajtjen e rrugëve gjate sezonit dimëror;
- Raportin vjetor të drejtorisë, planin vjetor të prokurimit, planin vjetor të drejtorisë për vitin që vjen.

Synimet e DSHP-së

Përkushtim i veçantë i DSHP-së do të jetë përmirësimi i infrastrukturës publike për qytetarët e komunës sonë. Në kuadër të infrastrukturës parashihet që kujdes i shtuar do të jetë te:

- Trajtimi i ujërave atmosferik në qytet,
- Infrastruktura publike në rrjetin e kanalizimeve fekale dhe gropave septike, zgjerimet,
- Ndërtimi i rrugëve lokale, ndriçimi publik, trotualet dhe mirëmbajtja e hapësirave publike.

DREJTORIA PËR BUIQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Duke pasur parasysh se sektori i Bujqësisë është në fokusin kryesor të Komunës sonë, Drejtoria për BPZHR, për vitin 2021 ka paraparë që të vazhdojë mbështetjen e fermerëve për rritjen e kapaciteteve prodhuese, modernizimin e bujqësisë, tërheqjen e investimeve, zbatimin e projekteve të hartuara gjatë planifikimit, me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve, rritjes ekonomike dhe të punësimit. DBPZHR këtë plan do të mundohet ta arrijë përmes:

- Zbatimit të politikave zhvillimore përmes përkrahjes direkte të fermerëve – subvencionimit;
- Shërbimeve këshillimore, si një instrument shumë i rëndësishëm që ndikon në rritjen e vetëdijes dhe avansimit të ofrimit të produktve sa më cilësore;
- Implementimit të projekteve kapitale në bujqësi që ndikon në mbrojtje të produkteve bujqësore;

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

- Zbatimin e projekteve të donatorëve dhe mbështetjes direkte në lëmin e bujqësisë për iniciativat e qytetarëve në ngritjen e cilësisë dhe sasisë së prodhimeve bujqësore.

Përveç aktiviteteve të parapara për periudhën kohore janar-dhjetor 2021, stafi i drejtorisë për BPZHR do të jenë të angazhuar edhe në komisione të ndryshme për mbikëqyrjen dhe pranimë teknike të projekteve kapitale pranë kësaj drejtorie, si dhe në komisione të tjera sipas nevojave dhe kërkesave që do të parashtrihen në drejtorinë tonë.

Prioritetet e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Duke u bazuar në planifikimin e buxhetit, përcjelljen e thirrjeve të MBPZHR-së për skemën e pagesave direkte dhe të grandeve, si dhe detyrave të tjera, prioritetet e drejtorisë do të kategorizohen në periudha tremujore.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

Këtë periudhë tremujore do ta karakterizojë kryesisht trajtimi i aplikacioneve për skemën e grandeve dhe pagesave direkte duke u bazuar në thirrjet për aplikime që do të hapen nga MBPZHR. Stafi i drejtorisë synojmë të jetë i gatshëm të përballojë fluksin e fermerëve gjatë kryerjes së procesit të aplikimit.

Pas përfundimit të fazës së aplikimit të gjitha dosjet do të dorëzohen në Agjencionin për zhvillimin e bujqësisë për të vazhduar me kontrollën administrative dhe kontrollën e terrenit në mënyrë që të hapet rruga për pagesa të vitit 2021.

Duke vazhduar punët nga ky vit, si: kontrata për dhënien e fletëpagesave të serrave, mekanizmave bujqësore, komoreve ftohëse dhe laktofrizave ndërmjet drejtorisë së bujqësisë dhe fermerëve përfitues.

Përcjellja e projekteve kapitale, si: rregullimi i rrugëve fushore, ndërtimi i kanaleve të kullimit dhe dranazhimit të tokave bujqësore, ndërtimi i serrave, ndërtimin e stallave të lopëve qumështore dhe shpezëve, ndërtimin e komoreve ftohëse.

Poashtu, në këtë periudhë kohore do të iniciohen edhe procedurat e shpalljes së tenderëve për zbatimin e projekteve kapitale si dhe përcjellja e projekteve që janë në vazhdim dhe organizimin për shpërndarjen e mekanizmave bujqësorë fermerëve përfitues.

Si proces mjaft i rëndësishëm në këtë periudhë kohore do të jetë edhe shpallja e ankandit publik për dhënien e tokës bujqësore komunale me qera. Të gjitha procedurat do të iniciohen konform rregullativës ligjore që e kemi në fuqi për dhënien e tokës bujqësore me qera.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

Periudha kyçe në këtë vit është kjo në të cilën pritet të hapen thirrjet nga komuna për përkrahje të fermerëve me grande. Në këtë periudhë do të hapen thirrje për të përkrahur fermerët në të gjithë sektorët me mekanizëm bujqësor, si: sektori i vreshtarisë, sektori i perimekulturës, blegtorisë, bletarisë etj.

Përcjellja e mbjelljeve pranverore për të parë më afër ecurinë e punëve agroteknike, duke iu ofruar këshillat e nevojshme fermerëve për mbjellje, në mënyrë që të kenë rendiment dhe cilësi të kënaqshme.

Formimi i komisioneve për përzgjedhjen e përfituesve të hapur nga thirrja e BPZHR dhe mbikëqyrja e projekteve kapitale do të vazhdojnë ta përcjellin këtë periudhë tremujore.

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

Përmes thirrjeve publike që do të hapen do të jenë të përfshirë pothuajse të gjithë sektorët e bujqësisë që zhvillohen në komunën tonë

Padyshim që theksi do të bie në sektorin e vreshtarisë, perime-kulturës, blegtorisë dhe lavërtarisë por, nuk do të mbesin anash edhe sektorët tjetër siç janë ; Bimët mjekësore Artomatike , ato të përpunimit të pemëve dhe perimeve duke avansuar edhe në sektorin e prodhimit të produkteve jo alkoolike si: Pekmez, Reqe, Pestil etj.

Periodha kohore nga janari deri në qershor kryesisht do të ketë tri objektiva:

- Përfundimi me sukses i fazës së aplikimit për subvencione në kuadër të MBPZHR-së
- Inicimi i procedurave për shpallje të tenderëve për investime kapitale nga buxheti i ndarë për drejtorinë e bujqësisë, dhe
- Shpërndarja e mekanizmave bujqësorë për fermerët përfitues.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

Korrje-shirjet do të karakterizojnë periudhën e tretë të vitit. Poashtu, nuk do të mungojë përcjellja e projekteve të investimeve kapitale si dhe shpërndarja në mënyrë të drejtë dhe pa anime e grandeve të vogla nga komuna e Rahovecit.

Tradita e vjeljes së rrushit sikur vitet paraprake edhe gjatë vitit 2021 do të organizohet gjatë muajit shtator, ku komuna e Rahovecit do të ofrojë mbështetje OJQ-ve rreth organizimit dhe mbarëvajtjes së festave me karakter bujqësor si: HardhFest, Agrofesta, Panairi i Produkteve në fund të vitit etj.

Kjo periudhë kohore do të karakterizohet edhe me funksionalizim të tregut të rrushit ku tani e sa vite jemi duke investuar dhe përgatitur për fermerët e komunës sonë me qëllim që të kenë mundësi dhe qasje në produktet e tyre t'i plasojnë te konsumatori përmes këtij tregu.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

Periodha e fundit të vitit do të karakterizohet me përcjelljen e mbledhjeve të prodhimeve vjeshtore, koordinimi i bodrumeve për grumbullim të rrushit si dhe përpunueseve të perimeve në tërë territorin e komunës sonë.

Kjo periudhë kohore do të karakterizohet me formim të komisioneve për verifikim të afërmëve që janë përfitues nga fondet e komunës së Rahovecit gjatë viteve 2020-2021.

Sigurisht se prioriteti kryesor do të jetë realizimi i buxhetit, do të kujdesemi që punët e kryera të mbikëqyren dhe të shpenzohet buxheti në përpikëri.

Periodha kohore nga korriku deri në dhjetor kryesisht do të ketë tre objektiva:

- Fushata e korrje shirjeve;
- Përcjellja e investimeve kapitale dhe shpenzimi i buxhetit në përpikmëri;
- Komisionet e verifikimit të përfituesve për mekanizëm bujqësor;
- Organizimi i festave që kanë karakter promovim të produkteve bujqësore të komunës sonë.

Synimet e DBPZHR-së

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

Përkushtim i veçantë i DBPZHR-së do të jetë përmirësimi i infrastrukturës bujqësore për fermerët e vyshëm të komunës sonë. Në kuadër të infrastrukturës parashihet që kujdes i shtuar do të jetë të:

- Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore;
- Intervenimi në ndërtimin e kanaleve të kullimit dhe drenazhimit të tokave bujqësore;
- Zgjerim i sistemit të ujitjes në pjesët ku mungon;
- Pastrim dhe mirëmbajtja e përroskave, si dhe
- Krijimi i ekipeve mobile të pranimit të aplikacioneve për pagesa direkte në dy qendrat më të mëdha të komunës sonë.

Sektori i pylltarisë

Në kuadër të sektorit të pylltarisë fokusi do të jetë:

- Mbrojtja e pyjeve;
- Rritja e sipërfaqeve me pyje të reja;
- Bashkëpunim i qëndrueshëm me Agjencinë Pyjore të Kosovës për pronat që janë dhënë në shfrytëzim;
- Angazhim maksimal në parandalimin e zjarreve në bashkëpunim me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Sektori i zhvillimit rural

Edhe zhvillimit rural do t'i jepet rendësi e veçantë duke u nisur nga fakti se komuna jonë njihet si një zonë me zhvillim të theksuar rural.

Me kujdes të veçantë do të trajtohen aspektet për trajtim dhe mbrojtje të faunës e cila është mjaft e pasur, falë rrjedhave të shumta të ujërave në tërë territorin e komunës sonë.

Gjuetia dhe peshkataria do të jenë dy fusha që do të kenë vëmendje të shtuar në planet tona.

DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Fillimi i vitit të ri, do të filloj me qasje në detyrat e reja dhe obligimet e mbetura nga viti paraprak. Qysh në fillim të vitit 2021 do t'i qasemi punës në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara nga Kryetari i Komunës në përputhje me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale dhe Statutin e Komunës së Rahovecit.

Prioritetet e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Prioritetet tona kryesore gjatë vitit 2021 do të fokusohen në shërbime cilësore në përputhje me afatet kohore dhe të unifikuara ligjrisht. Qëllimi kryesor i drejtorisë do të jetë i fokusuar në shërbime komfor akteve juridike.

- Vazhdimi i evidentimit dhe lirim të pronave të uzurpuara në nivel të komunës;
- Gjeoreferencimi i hartave- planeve gjeodezike të pa përfunduara;
- Vazhdimi i inventarizimit të dokumentacionit dhe skenimi masiv i dokumentacionit të pa skanuar;
- Shpronësimi i pronave private për hapje të rrugëve publike në nivel të Komunës.

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

Sfidat e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

- Themelimi i komisionit për komosacion;
- Vazhdimi i migrimit të zonave kadastrale në komosacion të zonave që nuk janë të migruara në nivel të komunës;
- Rindërtimi i zonave kadastrale në bashkëpunim me Agjencionin Kadastral të Kosovës.

SEKTORI PËR KADASTËR DHE PRONË

- Sektori për Kadastër dhe Pronë, gjate periudhës një vjecare parashihet që të pranojë dhe kryej më shumë se 1300 lëndë.

SEKTORI PËR GJEODEZI

- Sektori për Gjeodezi parashihet që të pranojë dhe zgjidhë mbi 620 lëndë.

Duke filluar nga muaji shkurt i vitit 2021 pritet që të ketë rritje të kërkesave për nxjerrjen e certifikatave pronësore nga ana e fermerëve për aplikim në kuadër të subvencioneve që pritet t'ju ndajë Qeveria e Kosovës, këtë proces do ta menaxhojmë me shumë kujdes duke e rritur stafin mbështetës dhe do të jemi në shërbim të qytetarëve me shumë profesionalizëm dhe në kohë reale.

Vlen të përmendet sektori i gjeodezisë për punën e tyre që do ta kenë në terren, si dhe shërbimi pronësoro juridik për angazhimin e dhënë në përgatitjen e akteve si për nevoja të Kuvendit të Komunës ashtu edhe përgatitjen e akteve për persona fizik dhe juridik.

Do të vazhdojmë me përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm në lidhje me evidentimin e pronave si ato komunale dhe ato private që janë vendëreniet e dëshmorëve të kombit me qëllim që këto parcela t'i shpallim zona me interes të veçantë, kjo mbetet sfidë që të përfundohen deri në fillim të vitit 2021.

Gjatë vitit 2021 nuk do të mungojë edhe qasja ndaj detyrave të tjera, si në sektorin e gjeodezisë ashtu edhe në atë të kadastrës dhe pronës, ku vlen të cekem:

- Propozim vendimet për seancat e Kuvendit Komunal;
- Përgatitja e lëndëve për gjykatë dhe subjekteve të tjera të përfshira në zbatimin e ligjit;
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe personave juridik;
- Punët e gjeodezisë inxhinierisë për nevojat e Kuvendit Komunal dhe palëve të tjera;
- Matjet kadastrale për vërtetimin e uzurpimeve arbitrare;
- Përgatitja e Aktvendimeve për uzurpimet arbitrare;
- Punë të tjera sipas planit;
- Me propozim të Kryetarit të Komunës, drejtuar Kuvendit të Komunës, do të bëhet shpallja e interesit të përgjithshëm të pronave komunale për zhvillim ekonomik të Komunës.

Detyrat tjera të Drejtorisë

- Përgatitja e akt dokumentit për angazhimin e gjeodetëve Komunal jashtë drejtorisë;
- Përgatitja e akteve ndaj uzurpatorëve në nivel të Komunës;
- Dalja në terren e Shërbimit pronësoro-juridik, me kërkesë të Drejtorisë për Inspeksion;
- Dalja e gjeodetëve në terren për matjen e rrugëve në nivel Komune.

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, për gjatë vitit 2021, planifikon të organizojë aktivitete në fusha me rëndësi për jetën e përditshme, duke përfshirë ato muzikore, shfaqje teatrale, art, aktivitete rinore, sportive dhe hartim të projekteve për ruajtjen e trashëgimisë historike e kulturore.

Përveç buxhetit komunal, prioritet është gjetja e burimeve tjera financiare, duke përfshirë edhe ato qendrore; MKRS dhe donatorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar, si dhe thellimin e bashkëpunimit me komunat tjera, OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm.

Prioritetet për vitin 2021:

Trajtimi dhe shfrytëzimi i objekteve dhe institucioneve ekzistuese kulturore e sportive në komunën e Rahovecit. Objektet që ofrohen për këto aktivitete janë:

- Shtëpia e Kulturës në Rahovec, Krushë të Madhe, Ratkoc, Xerxë, Drenoc;
- Biblioteka komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec, Krushë të Madhe, Ratkoc dhe Hoçë të Madhe;
- Stadiumi "Jahja Danuza" & fushat sportive dhe rekreative;
- Palestra "Mizahir Isma".

Gjatë muajve të parë të vitit 2021, DKRS do përkushtohet maksimalisht në arritjen e objektivave në kuadër të kompetencave të drejtorisë, duke përmbyshur planin e punës.

- Përkrahja dhe nxitja (frymëzimi) i krijuesve dhe kreativitetit kulturor;
- Zbatimi i planit të prokurimit për projekte kapitale;
- Hartimi i projekteve në kuadër të projekteve kapitale.

Sektori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Prioritetet dhe puna në kuadër të tri sektorëve, për periudhën e tre mujorit të parë:

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

Ndjekja e të gjitha procedurave të nevojshme, për fillim të punimeve të tri projekteve për komunën e Rahovecit, nga memorandum bashkëpunimi me MKRS-së.

- Ndërtimin e stadiumit të futbollit të kategorisë së dytë, në qytet, sipas standardeve të FIFA-së;
- Ndërtimin e palestrës sportive në Krushë të Madhe;
- Ndërtimin e stadiumit të futbollit të kategorisë së dytë, me standardet e Superligës së Kosovës, në Ratkoc.
- Ndjekja e të gjitha procedurave të nevojshme, për fillim të punimeve, të projektit për ndërtim të Qendrës për Art, Kulturë dhe Inovacion;
- Mbështetja e eventeve gjithëpërfshirëse lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare: festivale, panaire artizanati etj;
- Ndarja e subvencioneve në dy periudha, në kuadër të sektorit të Kulturës dhe Rinisë dhe Sportit;
- Nxitja e bashkëpunimit me OJQ-të në nivel komunal e më gjerë, përmes takimeve të ndryshme;

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

- Hartimi i planit për projektin me titull të kontratës "Ndertimi i infrastruktures për aktivitete kulturore në Dejne dhe sipas prioriteteve"
- Hartimi i planit për projektin me titull të kontratës "Rregullimi i terreneve sportive";
- Hartimi i planit për projektin me titull të kontratës "Restaurimi i monumenteve kulturore-historike", kujdesi për objektet në listën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe caktimi i atyre që duhet të ruhen, evidentimi dhe përkufizimi i vlerave kulturore e historike të objekteve të trashëgimisë kulturore;
- Organizime dhe përgatitje rreth Manifestimi kulturor dhe përkujtimor "Flaka e Janarit"
- Shpallja e konkursit letrar për fëmijë dhe të rinj;
- Organizime dhe përgatitje rreth festës së Pavarësisë -17 Shkurti;
- Përfundimi i punimve, në kuadër të projektit "Riparimi i Shtëpisë së Kulturës në Ratkoc";
- Epopeja e UÇK-së;
- Tryezë diskutimi me të burgosur politik, për Ditën Ndërkombëtare e të burgosurve politik;
- Forcimin e rolit të mjeteve të informimit në promovimin e idesë për masovizim të sportit, përmes shënimit të datave me rëndësi për sportin, dhe organizimeve të ndryshme rreth sensibilizimit;
- Funkcionalizimi i Këshillit të Veprimit Rinor Lokal;
- Vazhdimi i aktiviteteve në kuadër të këndit librar;
- Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Poezisë, me aktivitete të ndryshme;
- Ndërtimi i terreneve sportive dhe rekreative, dhe mirëmbajtja e këtyre hapësirave;
- Nxemje qendrore për sallen e bibliotekës dhe sallen e shtëpisë së kulturës;
- Përgatitja e specifikacionit për tenderin për instrumentet muzikore.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

- Gjallërimi i jetës kulturore- artistike si edhe nxitja, promovimi i talenteve të reja dhe inkurajimi i krijuesve të rinj të shkollave të mesme;
- Organizimin e trajnimeve që kanë qëllim vetëdijësimin e të rinjëve;
- Pjesëmarrja e punonjësve të bibliotekave, në trajnime/ konferenca lidhur me librin, në nivel regional dhe qendror;
- Hartimi i planit për projektin me titullin e kontratës "Ndërtimi i muraleve dhe veprave të artit në hapësirat publike";
- Hartimi i planit për projektin me titullin e kontratës "Ndertimi i kompleksit sportive në zonën turistike të Rahovecit";
- Përgatitja e specifikacionit "Furnizime me flamuj, kurora e buqeta lulesh";
- Organizim të aktiviteteve, për nder të Ditës së Monumenteve Kulturore e Historike;
- Organizimi i garave sportive e kulturore, në kuadër të festave zyrtare;
- Art n'Vneshta të Rahovecit;
- Rahoveci Tour – 2021;
- Manifestimet kulturore e përkujtimore "Java e Dëshmorëve";
- Festivali i folklorit "Anadrinia Jehon" (20 vjetori vit jubilar);
- Dita e Qendrës së Shtëpisë së Kulturës "Mensur Zymberaj";
- Aktivitet për nder të Ditës Ndërkombëtare të Muzeve;
- Dita e Çlirimit të Komunës së Rahovecit;
- Festivali Mbarëkombëtar i Muzikës Klasike "Do Re Mi- Unë dhe Ti";

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

- Përfundimi i punimeve në kuadër të projektit "Ndertimi i infrastruktures për aktivitete kulturore në Dejne dhe sipas prioriteteve";
- Formimi i një grupi koreografik me fëmijë në Komunen e Rahovecit;
- Përfundimi i punimeve në kuadër të projektit "Investime në infrastrukturen kulturore dhe kënde të lojrave për fëmijë.

Tremujori i tretë: korrik, qusht, shtator

- Organizimi i aktiviteteve edukativo-arsimore në bibliotekë;
- Evidentimi i punës në bibliotekë, përmes kartelave të librit;
- Përgatitja e informatave, lidhur me ecurinë e lexuesve në bibliotekë;
- Furnizimi me libra në Bibliotekën Komunale "Sulejman Krasniqi" dhe nëndegë;
- Organizime rreth përgatitjeve për festivalin, Hardh Fest 2020;
- Organizime në kuadër të Muajit të mërgatës;
- Organizim të aktiviteteve sportive, për nder të Ditës Ndërkombëtare të Sportit për Zhvillim dhe Paqe;
- Përfshirja e minoriteteve dhe grupeve të marginalizuara në aktivitete;
- Organizim të aktiviteteve sportive, për nder të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë;
- Organizimi i ekspozitave në bashkëpunim me OJQ- të;
- Organizimi i shfaqjeve teatrale;
- Ekspozitë me fotografi, nga fotografët e komunës së Rahovecit;
- Organizim të trajnimeve për ndërmarrësi, për të rinjtë.

Tremujori i katërt: tetor, nëtor, dhjetor

- Në kuadër të bibliotekave, do të përgatiten raportet, përpunimi fizik i materialeve bibliotekare, regjistrimi i anëtarësimeve të reja, promovimi i aktiviteteve në faqen e bibliotekës, fuqizimi i librit përmes vizitave në shkolla dhe organizimi i aktiviteteve të ndryshme;
- Përkrahja dhe frymëzim i krijimtarisë dhe kreativitetit kulturor, përmes shpalljes së konkursave letrare gjatë festave zyrtare dhe subvencioneve ;
- Dita e Bibliotekës "Sulejman Krasniqi" ;
- Shpallja e konkursit për Cmimin "Sulejman Krasniqi"
- Aktivitete përkujtimore e kulturore për "Festat e Nëntorit" ;
- Nxitja e të rinjve nga zonat rurale që të përfshihen në sa më shumë në aktivitete;
- Promovimi i sportit në mesin e të rinjëve, si dhe identifikimi dhe përkrahja e talentëve të rinjë;
- Forcimin e rolit të mjeteve të informimit në promovimin e idesë për t'u marr me sport
- Panairi i Sportit "Rahoveci 2020"- Qellimi i këtij aktiviteti është që fëmijët të jenë sa më afër sportit. (DKRS, Komiteti Olimpik i Kosovës);
- Dita Ndërkombëtare e Sportit për Zhvillim dhe Paqe;
- Formimi i Keshillit Organizativ, për Sportistin e Vitit "2020"
- Organizim të aktiviteteve në kuadër të "Javës Olimpikë";
- Organizimi i aktivitetit Kros Vjeshtor;
- Dita Botërore e Librit;
- Dita e 28 Nëntorit, festa e Flamurit Kombëtar;
- Dita Kombëtare e Rinisë;
- Aktivitete për fëmijë "Rëndësia e bibliotekës për një të ardhme të ndritur";

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

- Përmirësimi, ndërtimi i terreneve sportive dhe mirëmbajtja e këtyre objekteve.

Përveç këtyre punëve, do redlizohen edhe aktivitete e punë të përditshme, si:

- Raportet javore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore,;
- Pranimi dhe shqyrtimi i lëndëve;
- Takimi me klube dhe shoqata sportive;
- Organizimi i aktiviteteve kulturore e sportive;
- Monitorimi i aktiviteteve sportive;
- Takime me rini.

DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

Në bazë të planit vjetor të punës për vitin kalendarik 2021, sipas dinamikës së punëve do të zbatohet të gjitha ligjet përkatëse, sipas specifikave të lëmive të inspektorëve: tregtisë, shëmtarisë, veterinarisë, ndërtimtarisë, pronësisë, komunikacionit dhe të mjedisit.

DPI këtë plan do të mundohet ta arrijë përmes koordinimit dhe bashkëpunimit me institucionet gjegjëse si:

- Policinë e Kosovës, Stacionin Policor Rahovec
- Gjykatën Themelore në Gjakovë- dega Rahovec
- Bashkëpunimi me komunitetin dhe shoqërinë civile
- Koordinimi i veprimeve me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Inspektorët Rajonal
- Bashkëpunimi me operatorët e transportit publik dhe të mallrave

Plani për drejtorinë Inspektuese ka këto qëllime kryesore:

Mbrojtja sa më efikase e interesave të qytetarëve të komunës së Rahovecit, në bashkëpunim me të gjitha palët e interesit si: institucionet shtetërore, organet komunale, komuniteti i biznesit, qytetarët etj.

Synimet kryesore

Zbatimi i plotë dhe i pa anshëm i rregullatave ligjore dhe nënligjore që është në fuqi, identifikimi dhe eliminimi i dukurive negative.

Objektivat

- Menaxhimi, parandalimi dhe luftimi i pandemisë Covid-19;
- Dyfishimi i përpjekjeve për mbrojtje të ambientit;
- Eliminimi i ideponive ilegale;
- Ndalimin e ekspozimit të produkteve ushqimore sipas rregullores në fuqi;
- Mbrojtjen e tokave bujqësore;
- Mbrojtjen e pronës publike;
- Parandalimi i ndërtimeve pa leje
- Luftimi i ekonomisë informale.

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

Prioritetet e Drejtorisë për Punë Inspektuese:

Duke u bazuar në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, prioritetet e drejtorisë do të kategorizohen në periudha tremujore.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, planifikojmë të bëjmë kompletimin e lëndëve të bartura nga viti paraprak, duke respektuar afatet procedurale e ligjore.

Në këtë fazë kryesisht fillojnë përgatitjet për ndërtime pranverore, por si ngecje do të jenë kushtet atmosferike dhe ne do të jemi vazhdimisht në vëzhgim të terrenit, gjatë kontrollimeve do të verifikojmë objektet të cilat nuk posedojnë leje ndërtimi, do të merren masa paraprake të parapara me ligjet e ndërtimit dhe rregulloret në fuqi.

Ndalimi dhe asgjësimi i mallrave që shkaktojnë dëme dhe rrezik për shëndetin, jetën dhe mjedisin e konsumatorëve, kontrolle të vazhdueshme në transportim dhe bartje të mallit, gjë kjo e cila mund të arrihet përmes bashkëpunimit të inspektorit të tregut në koordinim me inspektorët e tjerë dhe organet e autorizuar.

Kontrollimi i objekteve shkollore dhe parashkollore, shëndetësore, kulturës fizike, sportit dhe rekreacionit, objektet e mbajtjes së higjienës personale, objektet publike, objekteve për furnizim me ujë të pijshëm etj.

Detyrimi i biznesve për legalizimin e veprimtarisë pranë zyrës së bizneseve në Rahovec.

Kontrollimi i mishtoreve dhe thertoreve gjatë tërë vitit, inspektimi për ruajtjen e tokës bujqësore nga degradimet jo ligjore dhe inspektimi i barnatoreve veterinarë dhe bujqësore.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2021, do të merremi me lëndët e plotëfuqishme me qëllim që t'i ekzekutojmë këto lëndë, duke u përqendruar në vendbanimet e komunës së Rahovecit, aty ku janë evidentuar uzurpues të pronave publike.

Bashkëpunimi me inspektorët e nivelit qendror për mjedis lidhur me koordinimin e aktiviteteve në fushën e mjedisit, të mbikëqyrjes së hapësirave të gjelbëruara, të inspektimit të ambulanteve dhe barnatoreve shëndetësore lidhur me menaxhimin e mbeturinave sanitare, aktivitete këto që do ta karakterizojnë këtë periudhë tremujore.

Kontrollime mbi cilësitë, çmimet dhe kushtet e shitjes me çmime në aksion në të gjitha lokalitetet.

Kontrollimi i objekteve hoteliere, kushtet higjienike-sanitare, ushqimi, personeli, hapësirat e punës, menaxhimi i mbeturinave etj.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, synim kryesor kemi inspektimin dhe parandalimin e ndërtimeve pa leje, kontrollimin e objekteve të vjetra nga aspekti i mirëmbajtjes, mbrojtjen e konsumatorëve,

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

luftimin e tregtisë joformale dhe konkurrencës së padrejtë tregtare si dhe mbikëqyrjen e kushteve higjienike sanitare nëpër të gjitha objektet publike.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

Këtë periudhë tremujore e karakterizon fluks më i shtuar i numrit të automjeteve nga mërgimtarët tanë, si dhe sezona e pushimeve verore, andaj, inspektori i komunikacionit në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Stacionin Polcor në Rahovec, Njësinë e Trafikut, do të kujdesen për krijimin e sigurisë më të madhe dhe qarkullimin e lirë në komunikacion.

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiave tona kemi paraparë edhe planifikimin rreth furnizimit me shenja horizontale dhe vertikale të komunikacionit, për rrugët e reja dhe mirëmbajtjen e shenjave në rrugët ekzistuese.

Mbikëqyrja e kyçjeve në sistemin e rrjetit të ujësjellësit publik nga personat fizik dhe juridik, mënyra e shfrytëzimit dhe keqpërdorimet eventuale të ujit të pijshëm (larja e rrugëve, sipërfaqeve të hapura publike, autolarjet, ujtja e kopshteve etj), mbikëqyrja e ndërhyrjeve eventuale mbi infrastrukturën rrugore (ekzekutimi i punëve publike apo private), mbikëqyrja e hedhjes së mbeturinave jashtë vendeve të caktuara, do të vazhdojnë ta karakterizojnë periudhën tremujore.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

Fokusi i periudhës së fundit të vitit do të jetë verifikimi i të gjitha dokumenteve si: procesverbale, vendime, njoftime etj.

Sigurisht se prioriteti kryesor do të jetë realizimi i buxhetit, rritja e presionit në mënyrë të vazhdueshme në gjykata me qëllim shqyrtimin e lëndëve të dërguara nga inspektoriat, informimi i qytetarëve për domosdoshmërinë e pajisjes me leje të ndryshme që lëshohen nga komuna, pranim-shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, shqiptimi i gjobave ndaj kundërvajtësve.

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021, synim kryesor kemi mbrojtjen sa më efikase të interesave të qytetarëve të komunës së Rahovecit, në bashkëpunim me të gjitha palët e interesit si: institucionet shtetërore, organet komunale, komunitetin e biznesit dhe qytetarët, si dhe zbatimin e plotë dhe të paanshëm të rregullativës ligjore dhe nënligjore që është në fuqi, identifikimin dhe eliminimin e dukurive negative, vendosja konform ligjeve për mbishkrime, panot dhe tabelat reklamuese, kontrolli rreth shfrytëzimit të sipërfaqeve publike.

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH) në punën e saj mbështetet: në ligjet, urdhëresat administrative dhe rregulloret në fuqi. Aktivitetet e drejtorisë janë të vazhdueshme dhe të pa parashikuara sipas intensitetit që mund të ndodhin nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera brenda vitit.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH) për vitin 2021 planifikon bëjë këto aktivitete:

PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE 2021

Emërtimi i detyrave/aktiviteteve të planifikuara	Bartësi i detyrës/aktiviteteve	Bashkëpunimi me:	Periodha e realizimit:
Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, anëtarët e Kuvendit Komunal drejtorët, përfaqësues të mediave, të LMT-së, OSBE-së dhe të gjithë të pranishmit në sallë. Meqenëse kemi mjaftë pika të rendit të ditës por urgjenca e kërkon që me i shtuar edhe ato pika të rendit të ditës dhe ne grupi i PDK-së i pranojmë ato pika që të futen në rendin e ditës por e kam një vërejtje rreth pikave të rendit të ditës që i kemi pasur. Në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kam kërkuar që të hyjë në rend të ditës grupi punues që ka qenë për rikategorizimin e monumentit të natyrës, Kanioni i Drinit të Bardhë tek Ura e Fshejtë dhe kam si vërejtje se unë nuk kam kërkuar informatë, pasi ne emër të grupit e kam kërkuar këtë pikë dhe ju e keni shkruar informatë, pra në këtë çështje nuk pajtohem pasi është dashur me qenë pika e rendit të ditës ashtu siç duhet dhe më pastaj kishim procedua sipas nevojave që është.

Vahid Krasniqi – Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtor komunal, asambleist dhe gjithë të pranishmë në sallë. Meqenëse kryetarja e komisionit Besa Bytyqi sot nuk është e pranishme, desha me kërkuar që të futet në rendin e ditës edhe lista rezervë për emërtimin e rrugëve, objekteve, shesheve, për shkak se kjo liste, ne e kemi parë vendimin se kjo liste është obligative dhe përdorimi është e tillë neve na bllokon komplet procesin si komision për emërtimet apo propozimet e kryetarëve të fshatrave apo të bashkësive që na kanë ardhë si kërkesë për emërtimin e rrugëve. Unë nuk po kërkoj që kjo listë të shfuqizohet por po kërkoj që kjo listë të rekomandohet dhe të bëhet liste rekomanduese dhe ne si komision do të mundohemi patjetër që të përdorim sa më shumë këto emra pasi janë afërsisht 17 emra të papërdorur por gjithsej deri më tani janë përdorur afër 80% të emërtimeve të rrugëve jashtë kësaj liste dhe përdorimi është kjo ne nuk mundemi me procesue me tutje apo të i sjellim në kuvend ne të ardhmen. Kërkoj prej kolegëve që kjo listë të bëhet liste rekomanduese dhe ne do të mundohemi patjetër që çdo emër këtu ta përdorim si emërtim të rrugëve shesheve objekteve apo të parqeve.

Munib Durguti – Faleminderit kryesues, unë desha të ndërlidhem me kolegun parafolës, sa i përket listës rezervë, meqenëse jam në komisionin për ankesa e kam shqyrtuar legjislacionin në fuqi që e rregullon këtë fushë. Lista rezerve mundet të plotësohet me propozime edhe aktuale, pasi nuk jem peng i listës rezervë që është lënë nga komisioni paraprak për emërtim, por të gjitha propozimet që ka marr në formë kërkesë peticione e që i plotësojnë kushtet në bazë ligjeve, ne mund të pasurojmë atë listë.

Kryesuesi – Faleminderit z. Durguti, atëherë të nderuar kolegë kuvendarë e qesim në votim rendin e ditës me pikat shtesë. Konstatohet se unanimisht aprovohet rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Atëherë meqë nuk kemi diçka rreth procesverbalit, e qesim në votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Ali Morina – Përshëndetje kryetar, nënkryetar, drejtor të drejtorive komunale, të nderuar asamblistë dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë do të ngre dy çështje, e para ka të bëjë me projektin e kubëzimit të rrugëve, pasi është mirë që komuna e Rahovecit tash ka një kontratë për kubëzimin e rrugëve, ku në njërin Lot ka filluar kubëzimi i rrugëve në fshatin Vrajakë, por unë jam shumë i shqetësuar me intensitetin e ulët të punëve që po bëhet atje dhe kërkoj nga drejtori Krasniqi që të bëjë tryzni të kompania që të shtojë intensitetin e punëve për të finalizuar projektin nëpër fshatra që janë të parapara të kryhen. E dyta ka të bëjë me Majën e Shkodranit, ku vërtet ai vend po bëhet atraksion turistik jo vetëm për qytetarët e Kosovës por edhe të vendeve fqinje dhe kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve e Publike apo cila drejtori që ka në ombrellën e saj ndriçimin publik që të vendoset ndriçimi publik në pjesën para mureve të kalasë sepse me të vërtetë natën kalaja nuk po vërehet dhe me vendosjen e disa dritave do të shihet poshtë qytetit dhe do të duket me bukur dhe më mirë.

Munib Durguti – Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, përfaqësues të mediave dhe të gjithë të pranishmit. Unë dëshiroj ta potencoj një problem që është krijuar me rastin e punimeve që ndodhin tash në rrugën Xhelal Hajda, pasi e dimë që aty është duke u ndërtuar një kanal për kullimin e ujërave të shiut, mbledhjen tyre dhe derdhjen në lumin Duhillo, me ç'rast ajo rrugë është e bllokuar për komunikacion dhe kemi një komunikacion tepër të rënduar në dy rrugë tjera si në rrugën Ibrahim Rugova dhe Gëzim Hamza-Piktori. Andaj, kërkoj nga kryetari që për momentin apo në mënyrë të përkohshme që këto dy rrugë t'i vendos rrugë njëkahëshe për qarkullim, për arsye se të dyja këto rrugë nuk kanë trotuare ndërsa kemi një qarkullim të dyanshëm për mjete motorike edhe po ashtu këto dy rrugë janë tepër të ngarkuara edhe nxënësit që po shkojnë në shkollë dhe krijohet një tollovi dhe bllokim të madh në komunikacion. Kështu që e shoh shume të arsyeshme që përderisa zhvillohen punime në rrugën kryesore Xhelal Hajda, që këto dy rrugë të vendosen si rrugë njëkahëshe të qarkullimit.

Florida Bajraktari – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. I nderuari kryetar, në fillim të këtij mandati krijova përshtypjen e mirë për ju, pasi thash me vete se kryetari si duket do të bëhet transparent në punën e tij. Që në mbledhjet e para fillova t'i sjellësh raportet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm por fatkeqësisht ajo praktikë nuk zgjati shumë, pasi ato auditime ishin të qeverisjes se kaluar. Pyetja është se pse e ndërpreve atë praktikë të mirë dhe e dyta është se Komiteti i Auditimit a është funksional pasi që nga formimi e deri me sot kur po flasim vetëm një herë na ka raportuar për punën që ka bërë. Pyetja ime është se kur do të raportojë para Kuvendit, pasi që jemi ndër komunat më transparente dhe mendoj se duhet që ta arsyetojmë veten.

Ali Zhuniqi – Përshëndetje kryesues, kryetar, kolegë kuvendarë. Pyetja ime ka të bëjë lidhur me çështjen e një operatori ekonomik i cili ka marr si lloj subvencioni me ju shërbye qytetareve e konkretisht është shërbim veterinar, edhe unë kam 3 apo 4 pyetje edhe pse drejtorit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ju kam adresua edhe pse drejtori nuk ma kthyer dhe kjo është arsyeja e pyetjes që po bëj tani, pasi unë i kam kërkuar shumë që ka përfituar operatori ekonomik edhe u dhënë si subvencion për me ju shërbye qytetareve. Pyetja e parë është se sa ka kushtua ky subvencion që ja keni dhënë atij operatori ekonomik për me ju shërbye qytetarëve, edhe në bazë të rregullores se kuvendit shumat të cilat janë mbi 2000 euro a kalojnë përmes asamblesë për me ju dhanë atij operatori ekonomik edhe pyetja e tretë nëse kjo shumë është më shume se 2000 euro a duhet t'i kalojë të gjitha procedurat e prokurimit publik, si në komunat tjera që zakonisht ndodh edhe praktikatat e tilla qoftë për vaksinim apo qoftë të sëmundjeve të krerëve, kafshëve zakonisht qiten ne tenderim dhe pas procedurave të prokurimit publik ato shkojnë. Edhe a ka të drejtë komuna me subvencionua një operator privat ekonomik, pa marr parasysh llojin e shërbimit që ka, në mënyrë që i njëjti operator me ju shërbye qytetarëve ndërsa ne praktikë ne e dimë që zakonisht që subvencionimi shkon direkt nga ana e kryetarit apo stafit komplet të drejtorive të caktuara dhe në ndërkohe ju e keni subvencionuar një operator ekonomik për me ju shërbye qytetareve dhe nëse ka mundësi drejtori me na tregua rreth këtyre pyetjeve që i parashtrova deri më tani.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, unë do të bëj një pyetje për drejtorin. Kemi mbushjen e rrugëve fushore në fshatin Celinë, ku e shoh që ai operator ekonomik ka që një muaj që ka fillua, ku ka kryer disa pjesë edhe nuk e ka bërë mbushjen e mirë të rrugës, kështu që dua të di se a keni kontaktuar me atë dhe kur do ta përfundoj atë rrugë, pasi jemi në prag të stinës së dimrit edhe mbetet keq pastaj rruga për kalim. Po ashtu rreth rrugës lidhet si pyetje e dytë, që është mirë duke u rregulluar shtrati i lumit në mes të Krushës së Madhe dhe Celinës ku ajo pjesë që është rregulluar është bërë mirë dhe do të vazhdoj me siguri por një shqetësim të banorëve të asaj zone ku banojnë është që tash jemi në prag të stinës së dimrit ku ka shira e borë dhe është e pamundur me kalua aty njerëzit pasi fillojnë tash shirat dhe do të ishte mirë se paku e intervenua me disa

kamionë zhavorr që me ju bë të mundshme me kalue ata edhe pastaj kur të vinë ato procedurat tjera i kryeni sipas rendit dhe planifikimit që i keni.

Mirjeta Krasniqi - Përshëndetje për juve, kryetar, nënkryetar, drejtor, kolegë këshilltar dhe media. Pyetja ime ka të bëjë me drejtorinë e Arsimit gjegjësisht me gjithë qeverinë komunale, ku dua të di me kërkesën që kanë bërë një pjesë e arsimtareve se si qëndron në lidhje me pagesën e shujtës ditore, pra si qëndron komuna e Rahovecit për këtë dhe deri ku ka ecur vendimi deri me tani, pasi që kjo është e paraparë me kontratën kolektive në vitin 2017.

Fehmi Hoxha – Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, kuvendarë, drejtorë të ekzekutivit, media dhe gjithë pranishëm. Unë dua të përsëris përsëri pyetjen time duke u bazuar në zotimet e kryetarit para miratimit të projekcionit buxhetor për rregullimin e kanalizimit fekal dhe ujërave atmosferike në rrugën Fahredin Hoxha. Kryetari është zotuar se do të përfundoj këtë punë para vitit të ri në këtë vit. Pyetja ime është pasi kemi edhe një muaj dhe koha po keqësohet, a do të filloj dhe do të përfundoj këtë vit apo kalojmë në vitin tjetër.

Shqipe Kryeziu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Pyetja ime ka të bëjë me drejtorinë komunale të arsimit, ku para disa muajve drejtori e ka shpallur një konkurs të fshehtë me arsye se ka pasur probleme teknike, ku është punësuar një mësimdhënëse prej komunës së Prizrenit me Bachelor për lëndët juridike në shkollën Selajdin Mullaabazi-Mici. Por, mësimdhënësjë në fjalë ka qenë zëvendësim i orëve për pushim të lehonisë që ka shkuar. Mësimdhënësjë është rikthyer në muajin qershor por ajo që është punësuar ende është në listën e pagave, pra ende paguhet edhe pse qëndron në shtëpi. Pyetja ime ka të bëjë se a është e drejtë një mësimdhënëse që vjen paguhet me 200 euro dhe i mban me këto që keni marr për pandemi kurse ajo duke qëndruar në shtëpi me marr rrogë të plotë. Unë vet rastësisht e kam parë në listën e pagave dhe nuk është thashethem.

Fahrie Lushi – Faleminderit kryesues, i nderuari kryetar, nënkryetar, kolege këshilltarë dhe media. Unë kam një pyetje që lidhet me ujin e pijes dhe desha ta pyes kryetarin, se sa shpesh shikohet cilësia e ujit të pijes sepse kohëve të fundit në komunën tonë uji ka një erë dhe ne e dimë se uji është i vetmi gaz që nuk ka as ngjyrë dhe as erë, kështu që ju sugjeroj që të merreni pak me cilësinë e ujit sepse ka ankesa nga shumë banorë.

Kryetari – Përshëndetje për kryesuesin, për anëtarët e kuvendit të komunës, drejtorët e drejtorive, nënkryetarin, mediat, përfaqësuesit që përcjellin këtë seancë si OSBE-së, LMT-së, faleminderit për praninë tuaj këtu. Unë do të përgjigjem vetëm disa pyetjeve që kanë të bëjnë me qeverinë komunale ndërsa do të kursehem në përgjigjet që do të japin drejtorët si drejtori i arsimit apo edhe ndonjë drejtor tjetër. Ndërtimi i rrugëve lokale, sigurisht që drejtori Përparimi mund të jep edhe detaje të tjera, ne kemi një plan të performancës që e kemi fituar për këtë vit 255,729 euro, ku prej tyre 155,000 janë për rrugë lokale ndërsa 100,000 janë për shtretër të përrenjve ose lumenjve. Ekziston rreziku që edhe ky 155,000 që për shkak të shkurtimeve buxhetore që edhe me herët isha në komunikim që ato komuna që nuk kanë nënshkrua kontrata edhe kanë fitua grantin e performances, ekziston mundësia me ja marr mirëpo nuk jemi pa rrezik edhe ne. Pra janë 3 operator (lote), ku një lotë ka filluar punën në Vrajakë, një lote ka filluar punën në Krushë të Madhe dhe një lotë ka filluar punën në qytet. Ku të gjithë i kanë nga 50,000 euro dhe vetëm njëri i ka 55,000. Të gjitha punët në fakt që e mbulojnë këtë shumë janë kryer, edhe ky që ka filluar në Vrajakë që ka ndërtuar një rrugë mbi 600 metra dhe ka nisë rrugën tjetër, po ashtu edhe ky që është duke punuar në Krushë dhe po ashtu ky tjetri që është duke punuar në Rahovec, pra nuk kanë mjete tjera për këtë vit, por sidoqoftë unë pajtohem me Alinë se duhet me u rritë dinamika me mirëkuptim dhe mirëbesim që me rrite aktivitetin dhe intensitetin e punëve që me krye ma shume rrugë. Por këto dy rrugë në Vrajakë janë shumë të gjata, ku njëra është 700 metra kurse tjetra mbi 500 metra, edhe kanë qenë rrugë jo të hapura edhe ka pasur probleme pak me prona dhe shpresoj se do të vazhdoj aktiviteti. Te ndriçimi publik para mureve të Kalasë të Maja e Shkodranit jam dakord dhe është diskutuar ndonjëherë dhe ka pasur ndonjë ide por do të ishte mirë me pas edhe ndriçim publik edhe

kalaja prej guri që me u pa më mirë, pasi ato drita që janë aty janë rregulluar dhe janë riparuar edhe janë vendos edhe të reja, po ashtu siç e dini ka pasur edhe dëme në Majën e Shkodranit dhe tash ai objekt ose ai monument është nën përkujdesje të kamerave të sigurisë që në disa pozicione monitorohet edhe nuk besoj që do të ketë telashe, kështu që mirëmbajtja edhe siguria është me e lartë, edhe mund të ketë ndriçim në muret e kalasë por sivjet nuk besoj që mundemi me mbërri aty. Te pyetja e parashtruar nga Munib Durguti, ka kërkuar me bo zgjidhje për shkak të ngarkesës së madhe që ka rruga Ibrahim Rugova dhe Gëzim Hamza, sigurisht për shkak të punimeve në kanalin e ujërave atmosferik. Është e vërtetë se punimet në kanalin e ujërave atmosferik vazhdojnë dhe ka pasur disa sfida operatori që besoj i keni parë edhe ju pasi po ka shembje e sidomos në pjesën ka është duke operuar tani dhe unë mendoj se është duke u bërë një zgjidhje e mirë aty, e më pastaj zgjidhja duhet të vazhdohet te lumi Duhlllo e teposhtë. Por, a kam të drejtë me vendos tash rrugë njëkajshe dhe unë mendoj se mirë që e keni ngritë këtë çështje dhe do të shohim me policinë e me pjesën e trafikut e ekspertizën e tyre që e kanë dhe nëse ma jep mundësinë Kuvendi i Komunës do të operoj kuptohet edhe në përputhje me mirëkuptimin dhe porosinë që mundemi me marr prej kësaj seance. Edhe nëse bëhet rrugë njëkahëshe, nuk jam i sigurt se ka duhet me u bo dhe nuk e di këtë, e sigurisht duhet me u konsultua edhe me shërbimet publike edhe me urbanizmin e po ashtu edhe me policinë. Kështu që nëse ma jepni mandatin me vendos, unë punoj në këtë drejtim edhe menjëherë pas kësaj seance mundem me i thirr këto ekipe edhe me punua gradualisht edhe me ardh deri një vendimmarrje e drejtë. Tek pyetja e parashtruar nga Florida Bajraktari, ndoshta edhe mundeni me u zhgënjye te unë apo me krijua ndonjë situatë zhgënjyese, por Njësia e Auditimit të Brendshëm, ju e dini se e ka një plan që i auditon të gjitha drejtoritë në planin vjetor të auditimit, edhe unë vet edhe në mandatin e parë edhe në mandatin e dytë sipas logjikes time i kam kërkuar me i qitë në Kuvend, edhe nganjëherë se nuk ka pika të rendit të ditës në fillim të mandatit por i kemi qitë dhe ndërkohe ka ardh një rekomandim që mos me i qitë sepse është në shpërputhje me obligimet ligjore që bartim të gjithë ne, edhe ju si kuvend edhe ne si ekzekutiv, ngasë auditori i brendshëm është këshilltar i kryetarit të komunës dhe auditori i brendshëm nuk i raporton kuvendit të komunës por e këshillon kryetarin e komunës dhe e ndihmon dhe raportet e auditimit të brendshëm në kuptimin e llogaridhënies janë në duart e auditorëve të jashtëm pra të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe nëse ka vërejtje konkluzione të gjetura dhe rekomandime i jep auditori i jashtëm për auditorin e brendshëm. Pra, është aspekti ligjor ai që ka ndihmuar se përndryshe absolutisht unë në këtë pikëpamje jam shumë transparent edhe jam për me i paraqitë raportet e auditimit por në kuptimin ligjor por edhe në kuptimin logjik pas interpretimve dhe shpjegimeve që i kanë bërë është e ndaluar me i qitë në kuvendin e komunës, kështu që në këtë kuptim nëse ka mbetur matja e transparencës të bëhet edhe në këtë pikë, unë vet e kam bërë këtë punë dikur edhe në fillim të mandatit por edhe në mandatin e parë, tash jam detyruar me ndërpre edhe përkundër që mua nuk me kishte penguar kurrë me i qitë raportet e auditimit asnjëherë, sepse unë i mendoj se raportet e auditimit neve na ndihmojnë. Pastaj pyetjen e parashtruar nga Ali Zhuniqi, unë po përpikem me dhanë një përgjigje parimore që lidhet me subvencionet, kur dihet se në subvencione nuk ka tender por ka një rregullore për shpërndarjen apo ndarjen e subvencioneve, ju e dini e sidomos ata që kanë përvojë në administratë dhe nëse e lexojmë ligjin dhe rregulloren e Ministrisë së Financave por edhe rregulloren që e ka aprovuar ky kuvend në mandatin e z. Vehapi, unë deri 1000 euro si kryetar komune kam të drejtë me ja dhanë një subjekti fizik, deri 2000 euro kam të drejtë OJQ-ve ndërsa përtej shumes 2000 euro duhet me pyet Kuvendin e Komunës. Tash rregullorja për ndarjen e subvencioneve thotë, lëshohet thirrja për aplikime në pozicione të caktuara për produkte të caktuara etj. dhe në kuadër të kësaj ne kemi zbatuar një rregullore që ka të bëjë, pasi është një zotim publik i kryetarit të komunës që shërbimet veterinare me u krye falas dhe më vjen mirë që kemi mbërri tash, pasi e kemi lëshuar thirrjen dhe ka konkurrua vetëm një operator dhe thirrja ka qenë publike dhe kanë pasur të drejtë për subvencione me aplikuar dhjetë operatorë tjerë të kësaj komune pasi duhet në subvencione me aplikua vetëm të komunës pasi nuk është

tender por vetëm thirrje publike. Kështu që ka aplikua një operator i cili ka plotësuar kriteret dhe nuk e di a janë ekzekutuar mjetet por e di që ka qenë shumë e paraparë për shërbime veterinare në komunën e Rahovecit nga ekipet veterinare të kësaj komune që mu krye ky projekt. Tash nuk ka nevojë me pyet kuvendin e komunës në këtë rast, sepse thirrjet për aplikime në subvencione lëshohen në bazë të rregullores dhe në bazë të ligjit, kështu kemi vepruar edhe me bursa edhe me të gjitha kategoritë e subvencioneve të komunës së Rahovecit, kështu kemi veprua edhe në sport, rini e kulturë. Pra, çështja është se nuk ka asnjë lloj shkelje as minimale, që mund të mos ketë zbatim të plotë të kontratës sepse operatorët nganjëherë dinë mos me qenë të përpiktë por ajo është detyrë e komunës e komisioneve për me monitoruar zbatimin e kontratës e në këtë rast e shërbimeve veterinare. Ne e kemi për detyrë me dërgua një raport për hargjimin e subvencioneve kuptohet në vitin e ardhshëm kur bëhet raportimi. Kjo është e vërteta e vetme parimore pa u lëshua ne detaje që ndoshta mund të ju jep edhe drejtoria se çfarë lloj shërbimesh veterinare kanë me u kryer edhe çfarë shume e subvencioneve që nuk e di tash. Por, të gjitha detajet edhe kriteret e thirrjes edhe qëllimin e këtij shërbimi e shpjegon edhe në thirrje por edhe në bazë të kontratës që lidhet edhe pastaj monitorimi i zbatimit të asaj kontrate dhe raportin në fund që i bie Kuvendit të Komunës. Pra, ndoshta është ndonjë keqkuptim në kuptimin e asaj që unë nuk jap subvencione me shume se 2000 për OJQ dhe më shumë se 1000 euro me nënshkrim të kryetarit të komunës por kam të drejtë edhe 50,000 euro me i dhanë në thirrje për aplikim pa e pyetur Kuvendin e Komunës sepse Kuvendi i Komunës ka vendosur me miratimin e buxhetit sa ka subvencione ne kulturë rini sport pastaj sa ka zyra e kryetarit, shëndetësia, arsimit, bujqësia etj. dhe i mbetet ekzekutivit që në bazë të ligjeve dhe rregulloreve ne fuqi përmes thirrjeve me i lëshua ato subvencione ose në shuma të vogla edhe kryetari pa pasur nevojë për thirrje lëshon p.sh. ndihma momentale 300, 400, 500, 1000 euro subvencionon dhe për OJQ deri në 2000 euro pa e pyetur askënd pasi është e përcaktuar me rregullore dhe ata që janë jurist munden me demantua por për çdo veprim e konsultoj Zyrën Ligjore po ashtu edhe rregulloret dhe ligjet që janë faktikisht në fuqi. Drejtori i Bujqësisë Berat Duraku ka mundësi me plotësua këtë çështje por unë vetëm përgjigjen parimore e dhashë që nuk ka ndonjë shkelje as edhe minimale. Shkelje mundet me pas ne zbatim të kontratës por detyra jonë është me monitorua zbatimin e plotë të kontratës.

Ali Zhuniqi – Në cilën rregullore që the më herët që ne e kemi votua këtu d.m.th. ju keni qitë kriter që një operator ekonomik konkretisht biznes me pas përvojë pune dhe unë nuk e di nëse ekziston rregullore që thirrja është bërë mbi përvojën e punës se operatorit ekonomik dhe mendoj se kjo është shkelje dhe zyrtaret ligjor i kemi këtu edhe munden me na dhanë përgjigje në lidhje me këtë.

Isak Hoti – Është rregullorja për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes se subvencioneve, edhe ne këtë rregullore i kemi paraparë dy kategori persona fizik dhe juridik dhe mbi bazën e kërkesës dhe mbi bazën e thirrjes publike që janë dy kategori. Nëse shkoni radhe, te rregullat e përgjithshme e keni nenin 4, pastaj vlerësimi i kërkesave e keni te neni 8, kriteret janë të përcaktuara për secilën drejtori veç e veç, pastaj neni 19 ku nuk mundesh me ja dhanë një operator ekonomik qoftë edhe një organizate jo qeveritare nëse nuk e ka përvojën e punës ne atë lëmi d.m.th. është përvojë që ai e dëshmon me dëshmitë e veta që ka krye atë veprimtari qoftë në komunën tonë apo dikun tjetër, pasi është obligative dhe e domosdoshme. Pra te neni 19 e keni të përcaktuar e gjithë procedura se si zhvillohet tek drejtoria për Bujqësi, po ashtu ceket edhe numri i rregullores 1427 të datës 28.04.2017, dhe sa e mbaj mend e kemi bo me Demos-in zviceran ne bashkëpunim me ata dhe kemi pasur goxha shume polemika pasi kryetari atëherë kërkonte me çdo kusht që ne kuvend të votohen çka janë mbi 2000 euro për gjithçka. Megjithatë te thirrja publike, Demos nuk ka lejuar në atë kohë edhe e kemi miratuar ashtu, kështu që mbi bazën e thirrjes publike ka mundësi nëse i ke këto subvencione mbi bazën e buxhetit të vitit paraprak i ke paraparë 500,000 euro siç tha kryetari me herët, keni të drejtë me i dhanë pa e sjellë edhe njëherë ne kuvend mirëpo duhet plotësuar kushtet kriteret të përcaktuara mbi bazën e kësaj

rregullore. Kështu që mbi bazën e këtyre kritereve në rregullore asnjë ligj por edhe asnjë udhëzim administrativ ti nuk mundesh me pae gjithçka.

Kryetari – Tek shtrati i përroit që ndan Krushën e Madhe dhe Celinën, është e vërtetë që duhet me rrafshua rrugët aty dhe kontrata parasheh edhe ndërtimin e rrugëve në të dy anët e po ashtu edhe ndriçim publik e plotë elemente tjera por meqenëse jemi në prag të dimrit është mirë të intervenohet sa më shpejtë që është e mundur. Pastaj te rrugët fushore, unë i kam vërejtjet e mia e po ashtu edhe drejtori i ka vërejtjet e tija për mënyrën se si ka punuar, nuk jemi të kënaqur me punën që bënë por ne do të insistojmë që ta zbatojë sa më shpejtë kontratën, pasi kemi kapak vështirësi me atë operatorin, që realisht nuk e kemi me operatorin tjetër që të njëjtën punë e bën por e di që ka pak ngecje në Celinë. Pastaj pyetja e parashtruar nga Mirjeta Krasniqi rreth shujtave, edhe me herët e patëm këtë diskutim me Zyrën Kombëtare të Auditimit edhe me një pjesë të asamblistëve të komunës tonë. Ne kemi problem me shujta edhe po rritet numri i padive për me i fitua shujtat sipas kontratës kolektive. Ne e kemi ngritur zërin edhe ne emër të komunës së Rahovecit e po ashtu edhe ne Asociacionin e Komunave e kemi bërë problem këtë çështje pasi nuk është çështje e vogël dhe ne e dimë se ju takojnë shujtat edhe pagat jubilarë mësimdhënësve sipas kontratës kolektive por gjithashtu e dimë se ne nuk jemi nënshkruar të kontratës kolektive dhe ashtu si Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së Arsimit dhe Financave ka vendos me ju lejua komunave me planifikua mjete për paga jubilarë duhet ta bëjë të njëjtën gjë sipas nenin 46 edhe për shujta. Nëse nuk e bëjnë ata atëherë ne jemi të kërcënuar realisht në pikëpamje buxhetore për shkak se ata kanë me i realizua të drejtat e tyre që pa të drejtë me i vendos barrë komunës ndërsa niveli qendror nënshkruan kontrata pa u konsultua me nivelin lokal edhe atëherë kur nënshkruan kontrata edhe merr obligime ligjore me i sigurua mjetet edhe nuk e bën këtë punë, kështu që jemi në diskutim sipër se si do të gjendet zgjidhja për shujtat që ju takojnë mësimdhënësve. Kështu që nëse ata i merrin komunës tonë atëherë afërsisht mbi 2 milion do të i kushtojnë shujtat e mësimdhënësve, pasi ata kanë shkuar qoftë përmes sindikatës apo përmes avokatëve dhe ka filluar me u rritë numri i padive në gjykatë. Shpresojmë që të gjendet një zgjidhje dhe ne do të vazhdojmë punën tonë që kjo çështje e adresuar për nivelin qendror të merret shumë seriozisht edhe të ju ndihmohet komunave që të ju hiqet barra që në njëfarë mënyrë nuk ju takon sepse edhe ashtu nuk po të japim mundësi planifikimi dhe nuk po sigurojnë fond me i pague edhe njëkohësisht po e fitojnë të drejtën tash mësimdhënësit për me realizua kontratën kolektive e nënshkruar në vitin 2017. Te pyetja e parashtruar nga z. Fehmi Hoxha rreth kanalizimit fekal, unë e di që drejtori Përparim Krasniqi ka qenë te ju dhe ka biseduar me juve dhe poashtu e dimë që nuk është problem i vogël, pra është problem me i madhe nga ajo që me ka informua drejtori Përparimi dhe e di që për me ndodhë ajo punë duhet një buxhet shume më i madh se sa që është menduar në fillim. E di që kjo punë duhet me u krye dhe unë zotimin e mbaj dhe nuk jam i sigurt se a do të mundet me u krye sivjet për arsye objektive dhe asnjë arsye tjetër mirëpo ai projekt kushton shumë më tepër se sa që është menduar dhe ne nuk e kemi pasur në pozicionin e kontratës pasi duhet me u krye edhe dy apo tri veprime shtesë për me ardh deri te një kanalizim që realisht është shqetësim legjitim i juaji dhe me të drejtë e ke ngritur disa herë dhe ndoshta drejtori Përparim Krasniqi ka mundësi me ju informua më shumë rreth kësaj punë. Pastaj pyetja e parashtruar nga Fahrie Lushi rreth ujit të pijes. Për cilësinë e ujit të pijes është e vërtetë që bëhen analizat e ujit dhe nxjerren rezultate të analizave nga një ekspertizë e caktuar që e ka në këtë rast KRU Gjakova për ato vende ku mbulohen me ujin e pijshëm nga ujëmbledhësi i Radoniqit. Arsyja që uji kundërmon ndonjëherë, me sa kam njohuri unë që algat dhe myshqet që krijohen në liqen krijojnë një materie që kundërmon dhe pastaj ujit i vjen era dhe nuk e ka shijen e ujit të nevojshëm për pije. Por edhe për atë problem ka zgjidhje me sa e di unë sepse ata që kujdesen për ujin e pijshëm në KRU Gjakova kanë ekspertizën apo kanë marr materie apo substanca që i eliminojnë ato që krijohen dhe krijojnë erë por mos të harrojmë që ka gypa të asbestit që janë shumë të vjetër dhe plotë probleme tjera teknike prej fabrikës së filtrave nëpër gypa që janë shume të vjetër dhe nuk është bërë ndërrimi i tyre dhe plot probleme tjera por unë

mendoj që është mirë si çështje që e ngrite dhe ta kemi më të qartë se këto ankesa duhet me i adresua edhe njëherë gjatë bisedës apo komunikimit që kemi KRU Gjakova. Unë nuk kisha dashur me u lëshua më shumë përveç Shqipe Kryeziut që me ju përgjigj drejtori Avni Morina për çështjen e konkursit.

Avni Morina – Përshëndetje për te gjithë të pranishmit. Çështja e futjes në listën e pagave të mësimdhënësve është një çështje që përballemi çdo muaj ku kemi punëtor të rinjë, pasi ne i përcjellim ndryshimet çdo fillim muaji para datës 10 dhe jo çdo herë na shkon mirë në vendosjen e punëtorëve në listën e pagave dhe kjo ndodhë për arsye se ne kemi numrin e kufizuar se sa punëtor i kemi në drejtorinë e arsimit dhe nëse e kemi një me tepër atëherë Ministria e Financave na thotë që të presim deri sa të lëshohet një vend tjetër. Dhe njëta gjë ka ndodhur edhe me rastin që e përmendi Shqipe Kryeziu dhe unë këtë ja kam sqaruar Shqipes mirëpo kjo ka deshtë me bo edhe publike këtë çështje. Por, është një çështje që përballemi çdo herë kur nuk mund t'i fusim në listën e pagave atëherë detyrohemi të presim për një muaj, dy muaj dhe deri ne 4 muaj pastaj kur i kemi futur ne listën e pagave ju kemi vazhdua kontratën për atë kohë sa kanë punuar punëtorët. Dhe krejt është normale që punëtorja që ishte deri me tash, ajo është në listën e pagave sepse mbi 3 muaj nuk i kemi dhënë pagë sepse nuk kemi mundur me futë në listën e pagave dhe ajo do të jetë në listën e pagave deri sa të ja paguajmë borxhin pastaj largohet nga lista.

Kryesuesi – Faleminderit shumë drejtor për sqarimin, të nderuar kolegë kuvendarë kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për vënien në debat publik të Koncept planit për Deponinë e mbeturinave të ngurta.

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryesues, te nderuar anëtarë të kuvendit, monitorues dhe gjithë të pranishmit në sallë. Drejtoria e Shërbimeve Publike ka hedhur në debat publik të dy plan rregulloret, plan lokal për menaxhimin e mbeturinave të ngurta dhe planin e menaxhimit të deponive për mbeturina të vëllimshme mirëpo pasi si pike e tretë e rendit të ditës, vetëm për planin e mbeturinave të ngurta. Shkurtimisht ky plan lokal për menaxhimin e mbeturinave inerte është një dokument planifikimi që mundëson zbatimin e strategjisë kombëtare d.m.th. që si synim kryesor ka përmbushjen e zbatimit të politikave kombëtare të menaxhimit të mbeturinave. Ky koncept dokument, shkurtimisht do të ju jap pasi edhe e keni materialin mjaft voluminoz që përfshin mbledhjen e të dhënave, vlerësimin aktual, opsionet e menaxhimit, shërbimit cilësor dhe nevojat financiare dhe investimet. Përmes këtij plani komuna e Rahovecit rritë standardet e përmirësuar për mjedise të pastër dhe zvogëlon sasinë e mbeturinave, që po ashtu ky plan ofron edhe një zgjidhje që përmirëson standardet e shërbimit dhe minimizojnë ndikimet negative dhe ekonomike me qytetaret. Fushëveprim kryesor i këtij plani ka synim që të përmirësojë menaxhimin e mbeturinave inerte në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme. Përmes këtij plani i inkurajojmë ndarjen e tyre në burim si pika referuese deri te riciklimi edhe ndarja në nivel të përpunimit. Ky plan si synim ka fokus që qytetaret dhe bizneset që operojnë në fusha të ndryshme të bëjnë ndarjen efektive për grumbullimin e mbeturinave inerte. Sa i përket deponive ilegale, ne tash kemi edhe disa zona tjera përveç Rahovecit që i kemi caktua për grumbullimin e mbeturinave inerte, që po ashtu me vendim të kuvendit janë caktua edhe disa zona tjera në vendbanime tjera kështu që ky plan është harmonizuar dhe besoj që do të ju shërbejë gjithë qytetareve. Shkurtimisht kjo është në pika referuese dhe nëse keni diçka ne do të jemi këtu për sqarime shtesë për këtë deponi.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, e falënderoj drejtorin për prezantimin e kësaj pike të koncept planit për deponinë e mbeturinave të ngurta. Unë do të kërkoj disa sqarime nga drejtori edhe për deponinë e mbeturinave të ngurta edhe për deponinë e mbeturinave të vëllimshme. Por, paraprakisht kërkoj nga drejtori që na tregojë se deponinë që na e kemi caktuar lokacionin për këto deponi atje lart, pasi dua të di se a është i njëjti lokacion për këto dy plan koncepte edhe të mbeturinave të ngurta edhe të vëllimshme d.m.th. me një vend pra me një parcelë, pastaj e dyta që më intereson pak me tepër deri ku komuna e Rahovecit ka mbërri me bo përgatitjen e infrastrukturës në këtë lokacion të deponisë. Po ashtu desha me shkue edhe ajo që më intereson pak më shumë

tek tabelat 3,4,5 që janë faza e pare, e dytë, e tretë, e katërt pasi po dua me i pas më shumë të qarta për vete që mandej me dal edhe në debat publik, që me na sqarua në pika të shkurta, pasi siç e pashë unë psh tabela 3, zërat e kostos për ndërtimin e lokacionit të deponisë e kap një shumë prej 40,000 euro, pastaj e kemi tabelën 4, vlerësimi i kostove i pajisjeve për deponinë inerte 293,000 euro, pastaj tabela 5 vlerësimi i kostove për operimin mirëmbajtjen 43,016 euro. Pyetja ime është kjo, se cilat janë përgjegjësitë e komunës dhe sa ka me dhanë buxhet komuna që me investua ne ato deponi të mbeturinave edhe cilat janë përgjegjësitë që i merr operatori ekonomik qoftë privat apo diçka tjetër që mundet me marr atë për menaxhimin e deponisë së mbeturinave, pra dëshirojmë me ditë se sa duhet me investua komuna rreth këtyre tabelave që te jemi të qarte rreth kësaj çështje.

Përparim Krasniqi – Është e vërtetë se është pjesë e deponisë që është e caktuar me vendim të kuvendit në Rahovec mirëpo ne nuk do të ndalemi vetëm me këtë deponi pasi do të shpërndahemi edhe ne deponi tjera që janë të caktuara nga ky kuvend që janë te shpërndara edhe ne vendbanime tjera. Pjesë e këtij lokacioni do të ndahet edhe një pjesë e këtij që do të krijohet një data bazë dhe do të krijohet një vend i posaçëm për hedhjen e mbeturinave të vëllimshme dhe te ngurta d.m.th. do të bëhet një klasifikim brenda kësaj zonës. Mirëpo ne pikën e tretë që e kemi kur te marrim vendimin me kriteret që do të hedhim ne ankand publik, për shkak se ka dështua ankandi publik për shkak të këtyre mjeteve atëherë do të caktohen edhe kriteret se si do te menaxhohet deponia legale. Pra kjo është arsyeja që ne pikën e tretë do të sqarojmë te gjitha këto që i përmenda pak me herët tek investimet, sigurisht se komuna e Rahovecit duhet me planifikua investime me afatgjate pasi komuna jone ka fillua edhe ne grandin e dytë është shpallur për mjedis të pastër d.m.th. ka fitua grandin e dytë dhe ne duhet me u kujdes që këto deponi të jenë të pastra. Po ashtu për sqarim, ekspertet e Giz-it ne bashkë punim me një OJQ- që janë partner lokal të Giz-it që janë duke bërë hartimin e planit kanë planifikua këto mjete mirëpo komuna e Rahovecit ne bazë të mundësive buxhetore që i ka ndanë mjete për këto ndarje ne burim të deponive.

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor për sqarimet, e qesim ne votim pikën e tretë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht kalon edhe pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për vënien në Debat Publik të Koncept Planit për Deponinë e mbeturinave të vëllimshme.

Kryesuesi – Të nderuar kolegë kuvendarë, e qesim në votim pikën e katërt të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovet pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër personave juridik P – 02279-0, 02280 -0, 02281-0.

Përparim Krasniqi – Përshëndetje për te gjithë. E keni edhe materialin përpara që keni një arsyetim që është bart tek deponia legale për shkak se ne ankandin publik nuk ka pasur të interesuar për marrjen në menaxhim të deponisë legale ne Rahovec për shkak të kriterëve që i përcakton rregullorja për taksa tarifa dhe gjoba, që është vlere minimale prej 2000 euro që duhet të përcakton komuna e Rahovecit në momentin kur operatori ekonomik e merr ne shfrytëzim. Ne për shkak të ankandit i kemi hequr të gjitha procedurat ligjore dhe e kemi vënë në ankand mirëpo nuk ka pasur të interesuar dhe tash është ideja me shfuqizua vendimin paraprak dhe me marrë një vendim që nëse jepet në shfrytëzim me ankand publik të jepet pa pagesë, që ne të mos bëjmë asnjë lloje diskriminimi jo vetëm për Rahovec por edhe ne zonat tjera që janë shpallur me vendim të kuvendit deponit legale që të jepen pa pagesë të gjithë operatoreve që janë të interesuar me marr.

Rasim Fazliu – Unë fillimisht po kërkoj me ditë që komisioni që ka qenë i formuar rreth kësaj çështje, se cilat kanë qenë kushtet e kërkuara nga komisioni dhe sa ka qenë e caktuar pagesa për këtë deponi, pra, cilat kanë qenë kushtet e ankandit publik dhe me pa se sa kanë qenë të përballueshme. Pastaj unë kam një vërejtje, meqenëse jemi te komisionet do të flas pak në përgjithësi, pasi kam një vërejtje se te gjitha komisionet kanë dalë prej kuvendit edhe vërejtja ime shkon te komisionet, pasi asnjë komision nuk raporton para kuvendit kur

të kryen një punë të caktuar, pasi është obligative që komisioni apo kryesuesi i komisionit edhe me na njoftua për punën që kanë kryer dhe kemi marr këto vendime. Kështu që, ne si kuvend nuk dimë asgjë rreth punës se tyre pasi të gjitha komisionet kanë dal prej këtij kuvendi me përjashtim të komisionit për zgjedhjen e këshillit të fshatrave dhe te lagjeve ne qytet që kanë raportua këtu në kuvend kurse komisionet tjera nuk raportojnë në kuvend. Kështu që kërkoj tash e tutje çdo komision me raportue këtu në kuvend.

Përparim Krasniqi – I nderuari baca Rasim, në ankandin e shpallur kanë kushtet minimale, në vija të trasha që ka qenë e planifikuar të bëhet rrethoja një sigurim peshorja, për shkak se vendimin që ka marr kuvendi për deponimin e mbeturinave inerte, ku është caktuar për 0,40 cent për metër kub dhe po ashtu ka qenë ndarja në burim. Pra këto kanë qenë kriteret minimale që i kemi përcaktuar mirëpo rregullorja për taksa tarifa dhe gjoba, e përcakton që 2000 euro operatori ekonomik që merr atë duhet të i paguaj komunës se Rahovecit d.m.th. tash operatorët ekonomik nuk kanë pasur mundësi apo kanë menduar që nuk mundën me i mbledhë taksat atëherë pse me i pagua komunës se Rahovecit edhe kjo është arsyeja e tërheqjes prej ankandit, kështu që nuk ka pasur të interesuar. Pra ideja është me hedhë në ankand publik pa pagesë, për shkak se me ju ofrua mundësi operatoreve ekonomik jo vetëm ne Rahovec por edhe ne zona tjera që i kemi caktuar me vendim që të bëhet menaxhimi me i mirë i deponive inerte.

Kryesuesi - Faleminderit shume drejtor për sqarimin, tani e qesim ne votim pikën e pestë të rendit të ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Fatmir Iska - I nderuar kryesues, kryetar, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal. Në mungesë të drejtorit të Bujqësisë po e prezantoj unë shkurtimisht. Ju para vetes e keni vendimin, ku kërkohet ndërrimi i destinimit prej tokës bujqësore ne tokë ndërtimore, ku pala fillimisht ka parashtruar kërkesë në drejtorinë e bujqësisë për ndërrim të destinimit pastaj ka parashtruar kërkesë edhe në drejtorinë e urbanizmit, ku është pajisur me leje për kushtet ndërtimore në fakt dhe tash kërkohet leja e Kuvendit Komunal që me pas mundësi ai me u pajis me leje ndërtimore. Kërkesa e tij është për ndërtimin e një shtëpie në tokë private, ku pronar është Melit Bytyqi që është pronë private dhe tani mbetet tek ju vlerësimi dhe kërkoj prej juve pasi që drejtori i urbanizmit me kushtet ndërtimore, kështu që ju e vlerësoni dhe pastaj vendosni. Nëse ju vendosni për leje ndërtimore atëherë pronari do të filloj me ndërtimin e shtëpisë private në pronën e tij private.

Fehmi Hoxha – Faleminderit shume kryesues. Unë e pash këtu kërkesën e zotëriut në fjalë, që i është drejtuar drejtorisë se urbanizmit ku janë paraqitur edhe kushtet ndërtimore dhe shumë po befasonem ne këto kushtet ndërtimore në pikën 2 ku e ka nënshkruar një profesionalist shume i mirë Shpëtim Mustafa dhe drejtori, mirëpo ne pikën 2 është e mangët, ku lokacioni për të cilën është caktuar kushtet ndërtimore, ku sipas këtyre kushteve ndërtimore gjendet në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal me numër 2566, të datës 13.05.2013 dhe kanë destinim të përhershëm. E para, kjo nuk është e përcaktuar, pasi është shumë me rëndësi të dihet në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal parcela ne fjalë se çka është e dedikuar, se aty shkruan se për çka është, a është tokë bujqësore, kullosë, zonë ndërtimore, industriale apo çka. Në këtë rast po të ishte ndonjë investim strategjik që edhe në të kaluarën kemi pasur kërkesa të tilla për punësimin e njerëzve, e kemi fjalën për ndërrimin e destinimit e tokës bujqësore ne tokë ndërtimore për biznes që është Kosova Wine dhe me pas e kemi pasur edhe një kërkesë tjetër për Stone Castle ë është duke u ndërtuar hotel dhe me një arsyeshmëri të tillë është shume normale. Te gjitha objektet që janë të ndërtuara pa leje, ekziston në fuqi ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje për legalizim, kështu që të nderuar këtij dokumenti i mungon ortofoto e parcelës ne fjalë, a është shtëpi e ndërtuar apo jo. Unë nuk lejoj që ne si kuvendarë të bëjmë gabim dhe të marrim një vendim nëse shtëpia ka filluar të ndërtohet sepse është e kundërligjshme. Prandaj kërkoj nga propozuesi që të na argumentoj me ortofoto që është apo nuk është e ndërtuar shtëpia, pastaj që kjo pjesë çka është e paraparë me planin zhvillimor 2013 dhe njëkohësisht se çka është e paraparë me planin e ri zhvillimor komunal për të cilin

është bërë kërkesë për certifikimin paraprak në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Kështu që mos të ngutemi të bëjmë gabime se mundet edhe me na u kthye mbrapa. Nëse është e paraparë si ndërtim atëherë pse kërkohet ndërrimi i destinimit nëse është në kuadër të planit hapësinor për ndërtim nuk ka nevojë nëse është për ndërtim por nëse nuk është e paraparë për ndërtim atëherë ke të drejtë me shndërrua token bujqësore në tokë ndërtimore dhe nëse është e paraparë me Planin Zhvillimor Komunal për ndërtim nuk ka nevojë me angazhua ndërtuesin që me pagua taksa shtesë. Nëse është e paraparë atëherë mundet me ja lëshua kushtet ndërtimore menjëherë nëse është zona e ndërtimit, pra me ligj është e përcaktuar kështu.

Isak Hoti – Përshëndetje për te gjithë. I nderuari Fehmi Hoxha ka të drejtë por vetëm për shkak të klasës. Ndërrim destinimi nga 1 deri 4 është obligative marrja e vendimit në kuvend pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Bujqësisë. Nga 5 dhe 6 është obligative me udhëzim administrativ ku thotë: ndërrimi i përhershëm i destinimit të tokës bujqësore nga klasa e 5 dhe 6 do të bëhet me vendim të kuvendit d.m.th. ne kemi obligim me marr këtu vendim ndërsa nga 7 e tutje është vetëm në PZHK, ndërsa përveç PZHK-së nga 5 dhe 6 është obligim ligjor që me marr që me marr edhe një vendim kuvendi, për shkak se në listën poseduese shkruan se pavarësisht që me PZHK që e kemi paraparë që është për ndërtim edhe me PZHK –në e re por edhe me te vjetrën është ndërtim ajo pjesë mirëpo është obligative sipas këtij udhëzimi administrativ që me marr edhe një vendim në kuvend. Kështu që ligjërisht jemi në rregull pasi e kemi diskutua pasi kemi shkua që edhe në PZHK a është e paraparë për ndërtim, kështu që veç me plotësua procedurën, jemi të detyruar me marr edhe këtë vendim, pasi në certifikata është tokë bujqësore.

Fehmi Hoxha – Atëherë duhet të ndërrohet certifikata, nëse nuk është e harmonizuar me Planin Zhvillimor Komunal të vitit 2013. Mos të obligojmë ndërtuesin të paguaj taksa shtesë, se nëse është e paraparë për ndërtim duhet të ndërrohet certifikata dhe mos t'i merret para atij edhe nuk ka nevojë këtu me diskutua. Singërisht ju them se nëse është tokë ndërtimore në Planin Zhvillimor Komunal duhet të ndërrohet certifikata në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër.

Isak Hoti – Kërkesat e palëve kur vinë qoftë nëpër drejtori apo të njësisë, gjatë shqyrtimit hymë në rrjedha edhe e shohim se a është tokë bujqësore apo ndërtimore, sepse kjo varet edhe nga Agjensionin Kadastral dhe nuk është drejtpërdrejt nga ne dhe nuk mundemi me ndryshua asgjë. Kjo është vetëm një plotësim i procedurës, pasi kjo pronë është 1 euro m² dhe nuk me i pas afërsisht 500m², që realisht për komunën është edhe një e hyrë, pasi ligji e ka përcaktua udhëzimi administrativ edhe pse unë kam kërkuar edhe në instancat me te larta që ky udhëzim administrativ me u ndryshua është i kohës së UNMIK-ut i vitit 2006 dhe ne endemi punojmë me këtë udhëzim dhe deri sa nuk është shfuqizua, duhet me patjetër me zbatua me përpikëri.

Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Hoti për sqarimin, atëherë me që nuk kemi tjerë të lajmëruar, e qesim në votim pikën e gjashtë të rendit të ditës. Konstatoj se me një votë kundër, aprovohet pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për përkujdesje dhe Mbrojtje të Fëmijëve dhe marrja e vendimit për dalje në debat publik.

Mirsad Shala – I nderuar kryesues i kuvendit, Kryetar i Komunës, nënkryetar, drejtor të drejtorive dhe gjithë të pranishëm. Pas hyrjes në fuqi të ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, me datën 17 korrik 2020, Komuna e Rahovecit në bashkëpunim me qendrën e trajnimeve dhe burimeve për avokim dhe në partneritet me organizatën Save the Children in Kosova dhe në bashkëpunim me komunat e Republikës së Kosovës ka hartuar draft rregulloren unike komunale për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijës. Qëllimi i hartimit të kësaj rregullore është mbrojtja e fëmijës nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore abuzimit ndëshkimit trupor keqtrajtimit neglizhimit apo ndonjë formë tjetër që vë në rrezik jetën sigurinë shëndetin edukimin arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës. Për caktimin e detyrave dhe përgjegjësinë e subjekteve për mbrojtjen e fëmijës si dhe mënyrën e koordinimit raportimit dhe bashkëpunimit të tyre me qëllim të kontributit në sistemin për mbrojtjen e fëmijëve dhe kontributin në krijimin e një komune mike për fëmijë. Andaj pas diskutimit nga

ana e juaj, kërkoj nga ju që të merret vendimi për dalje ne debat publik të rregullores për përkujdesje dhe mbrojtjen e fëmijës ne komunën e Rahovecit.

Kryesuesi – Faleminderit z. Shala, të nderuar kolegë kuvendarë e kemi diskutuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, e cila është një rregullore që do të jetë unike për të gjitha komunat njëjtë, që janë pjesë e punës që është marr Save the Children dhe ARTC-ja.

Fahrie Lushi – Edhe ne KPF e kemi diskutuar sikur të gjitha pikat edhe këtë pikë, mirëpo thjesht e kam thënë edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa se si rregullore është e hartuar në përputhshmëri të çdo dispozite ligjore që u përkon me fëmijët dhe të drejtat e tyre. Mirëpo kur jemi te neni 12 dhe 13 të cilat vlen të përmenden sepse kanë të bëjnë me përkujdesjen e fëmijëve po ashtu sjellja në shkollë dhe çdo institucioni tjetër, duke filluar nga familja dhe unë do e ndërlidhë këtu me dy raste të vitit të kaluar, që kanë të bëjnë me abuzimin e një vajze të re në një objekt shume afër shkollës po ashtu edhe me ata fëmijë që keqtrajtohen nga mësimdhënësit në shkolla e sidomos është përmendur Shkolla e Mesme e Lartë në Ratkoc.

Kryesuesi – Faleminderit zonja Lushi, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, e qesim në votim pikën e shtatë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i Propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.124/20 të datës 29.10.2020, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë.

Isak Hoti – Fatkeqësisht jemi të obliguar me shfuqizua këtë vendim edhe pse e kam cekur edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa që janë marr dy vendime të dyfishta që për të njëjtën çështje ne e kemi zhvilluar një procedurë me herët në fshatin Radoste edhe konfirmimi i ligjshmërisë na është kthyer pozitiv dhe për të njëjtën çështje ne fshatin Gexhë ky vendim është kthyer negativ. Kemi pasur disa debate me MAPL-në rreth kësaj çështje mirëpo nuk kemi mundur me kthye këtë vendim. Kështu që jemi detyruar me ndërrua strategji, ku ky vendim te pika 9, nuk ka nevojë me shkue në MAPL, që është përcaktim të lokacionit dhe ne atë vendim kemi thënë që objekti si objekt por edhe prona nuk ka me ndërrua destinimin por objekti ka me mbet pavarësisht se cili donator mundet me ndreq dhe objekti ka me mbet pronë e komunës dhe nen mbikëqyrjen e komunës. Për ndryshe forma tjera për dhënien në shfrytëzim për këto dhe që kemi pasur edhe raste tjera përpos të caktimit të lokacionit për ndërtimin e këtyre objekteve për nevojat e fshatrave.

Kryesuesi – Faleminderit z. Hoti, atëherë të nderuar kolegë meqë jemi të detyruar ta shfuqizojmë se pari vendimin, e qesim ne votim pikën e tetë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e tetë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i Propozim vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e komunitetit të fshatit Gexhë.

Kryesuesi – E dhe me herët sqarimin z. Hoti, se duhet të bëhet vetëm kjo pjesa e plotësimit si caktim i lokacionit. Atëherë nëse nuk ka dikush diçka rreth pikës se nëntë, e qesim ne votim pikën e nëntë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e nëntë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër.

Isak Hoti – Fjala është për objektet e Palestrës që kanë me u dhënë në shfrytëzim dhe me hyrjen ne fuqi të rregullores se re në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale është obligative që secili objekt dhe secili lokal duhet me pas numrin dhe certifikatën e vet të pronës dhe si rezultat i kësaj na kanë kthyer negativ me plotësua edhe me ndryshua. Kështu që ne i kemi bo të gatshme edhe me siguri sekretaria e kuvendit ju ka dorëzuar juve planin e Palestrës bashkë me aktvendimin që e ka nxjerr Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, ku gjithsej janë 11 prona që janë të përcaktuara me metër katror dhe secili lokal e ka marr numrin në certifikatën e vet. Kështu që ne do të bëjmë gati menjëherë pas kësaj seance sepse nuk kemi pasur

mundësi që të kenë gati për këtë seancë edhe kur shkon vendimi ne MAPL atëherë do të shkon të bashkangjitura bashke me certifikatat e pronësisë, kështu që edhe ne këtë pikë jemi në rregull.

Fehmi Hoxha – Ne e kemi sjellë një vendim edhe nuk duhet ta shfuqizojmë atë vendim prej seancës se kaluar që me marr këtë vendim tjetër.

Isak Hoti – Në fakt është ndryshimi dhe plotësimi i vendimit pasi është gabim i titulluar si pikë edhe ashtu ka ardh te ju, përndryshe është ndryshimi dhe plotësimi i vendimit dhe nuk është vendim i ri.

Kryesuesi – Faleminderit z. Hoxha, atëherë më qe nuk kemi tjerë të lajmëruar, e qesim në votim pikën e dhjetë të rendit të ditës: **Ndryshimi dhe plotësimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër.** Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e dhjetë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

11. Informatë për zonën e mbrojtur "Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë".

Rumir Zhuniqi – I nderuar kryesues, i nderuar kryetar, kuvendarë dhe gjithë ju të pranishëm. E paraqes një informatë për Kanionin e Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë e cila është monument natyre me karakter hidrogeomorfologjik për shkak të këtyre karakteristikave natyrore, ky monument prej vitit 1986 është shpallur Zonë e Mbrojtur. Meqenëse kjo zonë ndodhet në kufirin administrativ ndërmjet komunës së Gjakovës dhe komunës së Rahovecit, të dy komunat janë dokorduar që këtë hapësirë pra këtë zonë të mbrojtur që ta shpallin monument natyre si zonë e mbrojtur. Sipërfaqja e përgjithshme në territorin e komunës së Rahovecit është 125 hektar ku me pronësi shoqërore është 84 hektar ndërsa pronësi private është 40 hektar. Zona ndahet në zonën e ngushtë apo rigoroze dhe zona e gjërë apo mbrojtëse. Me datën 10.05.2016 është formuar grupi punues për hartimin e arsyeshmerisë profesionale për trajtimin e Kanionit të Drinit të Bardhë apo rikategorizimit të kësaj zone. Në këtë komision apo grup punues kanë marr pjesë anëtarë të institutit për mbrojtjen e natyrës e po ashtu edhe nga komuna e Rahovecit me ish-drejtorin Fehmi Hoxha dhe nga komuna e Gjakovës si bashkëpunëtorë profesional për çështje mjedisore Fatos DEDA. Në raportin përfundimtar të arsyeshmerisë profesionale vetëm anëtari nga komuna e Gjakovës nuk e ka nënshkruar. Grupi punues ka propozuar me kufijtë e ri fillimisht për komunën e Rahovecit dhe me krijimin e rrethanave të përshtatshme edhe për atë të Gjakovës të mbetet ne kategorinë e monumentit të natyrës mirëpo në propozim është dhënë arsyeja apo është propozuar që zona të zvogëlohet pra zona e mbrojtur. Pjesa e cila është propozuar që të hiqet është pjesa nën rrugën kryesore që të dërgon në Gjakovë.

Kryetari – Në fillim u shtrua çështja se pse është informatë edhe pse nuk ka një përpjekje me cilësue rendin e ditës dhe me dërgua ne funksion të vendimmarrjes nga ana e Kuvendit. Unë besoj që e kenë parasysh se ne nuk mundemi me veprue ne drejtim të vendimmarrjes pa pasur një informatë të qartë dhe të sakte se çka është zona e mbrojtur se çka nënkupton zona e mbrojtur sa është zona e mbrojtur pastaj çka duhet mbrojtur dhe çka është zonë e ngushtë dhe çka është zonë e gjërë dhe pa pasur edhe një dakordim edhe nga komuna e Gjakovës sepse ju e dini se vetëm lumi e ndan zonën apo kanionin dhe ne duhet të përgatitemi nëse kërkohet vendimmarrje. Dhe tash për tash nuk ka pasur as mundësi por as nuk kemi të drejtë me i dhanë vetes një detyrë për një çështje kaq strategjike edhe përkundër faktit se ne jemi të vetëdijshëm se ka edhe përpjekje për ngushtim të zonës, se ka edhe ndërtime edhe të paligjshme e pa leje, po ashtu ka edhe përpjekje për me përvetësue pronën publike dhe pronën komunale dhe deri me tani kemi mbërri me i ndalue plotë veprimtari të cilat ndoshta kishin pas dëshirë ata me i zhvillua. Unë mendoj që në të ardhmen, ne duhet të përgatitemi me informacione edhe më të shumta se si duhet të kategorizohet zona e mbrojtur dhe jo si të ngushtohet zona e mbrojtur, që sipas komisionit veç po dihet që janë kategoria rigoroze apo e ngushtë që është e paprekshme dhe kategoria me e gjërë që përfshin një sfond më të gjërë me sipërfaqe, edhe kjo duhet të studiohet dhe të hulumtohet dhe besoj që tani për tani ne nuk duhet të ngutemi dhe pajtohem me Fehmi Hoxhën që tha se ne nuk duhet me lejua me gabua pa e ditur se ku jemi. Unë e di që dikush ka përmend se ka kritere por nëse bëhet fjalë për kategorizim të zonës duhet të shkojmë me tutje në studim në hulumtim në argumentim dhe faktim dhe nëse bëhet fjalë për

ngushtim të zonës duhet të kemi parasysh se është situatë e rrezikshme ngushtimi i zonës se mbrojtur nuk është mirë me ndodhë se paku apo me marr vendime ne si komunë pa i pae edhe disa parametra tjerë siç është komuna e Gjakovës pastaj me pae gjendjen faktike në terren dhe pastaj me vendos edhe kriteret specifika e plote gjëra tjera, në mënyrë që Kuvendi i Komunës me qenë me i aftësuar dhe me i përgatitur për me marr një vendim duke pasur para vetes edhe një busullë të qartë edhe në përputhje me ligjin edhe në përputhje me synimet që ka komuna jonë. Për më tepër e kemi edhe komunën e Gjakovës që përsëri duhet me pas një linjë komunikimi dhe të bashkëpunimit me ata sepse nuk mund të ndodhin veprime të tjera në pjesën ku është e Rahovecit dhe veprime tjera në pjesën ku është e Gjakovës sepse me ligj kjo është një zonë e cila duhet të mbrohet dhe mund të kategorizohet zona por duhet të kemi kujdes kur bëhet fjalë për ngushtimin e zonës se mbrojtur. Unë e di që kjo informatë na ka bo me syhapur sepse kam kërkuar prej drejtorit të Urbanizmit në përputhje me kërkesën që ka pasur grupi i PDK-së qoftë i Fehmiut apo i Rasimit apo si grup dhe po ashtu edhe ne emër të komunës është bërë përpjekje edhe me herët dhe ne tash kemi fillua me hy në thelbin e një informacioni i cili ka nevojë akoma më shumë me u qartësua me u argumentua me u faktua në mënyrë që në një nga seancat e ardhshme me qenë më të gatshme për diskutime të cilat ndoshta mund të qojnë nga ndonjë vendimmarrje me e drejtë edhe e ligjshme e kuvendit të Komunës së Rahovecit. Pra nëse dikush e ka keqkuptua në fillim, unë po ju sigurojë që kjo është arsyeja edhe asnjë arsye tjetër nuk ekziston pse rendi i ditës nuk është bërë kategorizimi apo ri kategorizimi i zonës por është bërë një informatë, që ta kenë të qartë anëtarët e Kuvendit dhe qytetaret e Komunës së Rahovecit se ne nuk kemi shumë zona të mbrojtura dhe po ju siguroj që e kemi një zonë të mbrojtur të Manastiri i Zoqishtit apo të Hoça e Madhe dhe ta dini se nëse ne duam të mbrojmë zona të mbrojtura atëherë pa hy neper disa filtra nuk mund të bëhet asgjë në ato zona edhe ne meqenëse e kemi Kanionin e Urës së Fshejtë të kujdesemi edhe pak më shumë për informacione që të jemi edhe me të qartë në mënyrë që të jemi me kompetent diskutime edhe ne vendimmarrje në të ardhmen, ndoshta në janar do të ketë diçka më shumë, tani nuk po dua me paragjyke por sidoqoftë informata besoj që është e vlefshme pasi kemi edhe informacion shtesë që kemi grumbullue edhe kemi kërkuar edhe prej komunës së Gjakovës e po ashtu kemi marr edhe krejt punën që ka bo asamblisti Fehmi Hoxha edhe normalisht jemi në përpjekje që gjatë procesit të marrim edhe informacione tjera të vlefshme si fakte dëshmi që ta qartësojmë synimin se çka dëshirojmë me bo rreth kësaj zone. Unë mendoj se hapësirë për debat ka gjithmonë por me qellim e mora fjalën që mos me pas asnjë lloj keqkuptimi.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, unë pajtohem me kryetarin 100% për të gjitha fjalët që i tha, por dua me sqarua pse e kemi ngritë këtë çështje si pikë të rendit të ditës, pasi arsyeja është se ky material ka qenë i përgatitur qysh ne vitin 2015, por, ne e kemi pasur në diskutim këtu në dy mbledhje por për shkak se ka qenë vit zgjedhor e kemi shtyrë pasi kemi konsiderua se mundet me u bo politikë, pra kjo ka qenë arsyeja. Edhe çështja që e kam ngritë duke mendua se ky është material i gatshëm edhe ne mund ta diskutojmë edhe të marrim vendime, përndryshe atëherë kur e kemi pasur ne vitin 2017 por edhe sot, unë personalisht e ndaj mendimin e njëjtë edhe tani se nuk jam për ngushtimin e zonave apo zonës se mbrojtur në këtë rast absolutisht, dhe ne duhet të insistojmë edhe si kuvend edhe në çfarëdo forme tjetër që me insistua që zonën e mbrojtur me ruajt, edhe më vjen shumë keq që ndër vite e deri me sot që qeveritë përkatëse që kanë qenë, që kanë lejuar me u ndërtua aty pa leje që është një papërgjegjshmëri atyre qeverive. Përveç kësaj jam për atë që mos me u ngutë që me pas mundësi me shqyrtua mirë edhe me punua mirë në këtë drejtim edhe me bo materialin e gatshëm edhe me mbrojtë tamam ashtu siç është zonë e mbrojtur. Po kërkoj që për mbledhjen e radhës, të na servohet prej drejtorisë përkatëse lista e gjithë atyre njerëzve qoftë që kanë ndërtua apo që kanë uzurpua, dua të bëhet publike këtu dhe nuk dëshiroj që ne si kuvend me marr vendime symbyllas dhe dëshirojmë me ditë në çdo detaj pasi jemi përfaqësues të komunës së Rahovecit pasi jemi të zgjedhur me votën e tyre.

Fehmi Hoxha – Me qellim dola këtu pasi ne mandatin kur unë isha drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor atëherë është iniciuar kjo procedurë, që do të thotë së është si informatë që edhe unë pajtohem së mirë që e keni bërë si informatë, mirëpo kjo është vendimmarrje e re dhe pak nga këta kanë qenë atëherë edhe mirë do të ishte me pas një informatë pak me të thuktë pasi është një çështje mjaft delikate mirëpo unë do të mundohem me pika të shkurta të ju informoj rreth procedurave që janë zhvilluar. Me vendim të Kuvendit Komunal është marr iniciativa për rikategorizimin e zonave të mbrojtura. Përgjegjës për kategorizim dhe rikategorizim në baze të ligjit mbi planifikimin hapësinor është Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Natyrore, atëherë që ka funksionuar pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Është marr vendim pastaj është bërë debat publik me qytetaret, kemi shkuar së bashku me ish kryesuesin e Kuvendit dhe kuvendarë të tjerë, kemi shkuar edhe ne lokalitete si në Gexhë dhe Xerxë ku kemi marr propozimet dhe kërkesat nga individë qytetarë dhe para se marr vendim për hapjen e shqyrtimit publik, të gjitha ato kërkesa janë shqyrtuar këtu në kuvend dhe është marr vendimi për shqyrtim publik që ka pasur 30 ditë afat, ku brenda afatit përsëri janë shqyrtuar të gjitha kërkesat ku grupi punues që ishte i formuar atëherë me vendim të sekretarit të Ministrisë së Mjedisit i ka shqyrtuar të gjitha dhe ka ardhë në përfundim dhe faktikisht ja ka dhënë Kuvendit Komunal propozimin profesional për ri kategorizimin e zonës së mbrojtur, ku 18 muaj është punuar ku të gjitha ekipet profesionale edhe të botanikës edhe të historisë arkeologjisë kanë qenë të kyçura ne ekipet tjera, prandaj edhe e ceku shefi i grupit tonë të PDK-së që është tërhequr për shkak të zgjedhjeve që mos të politizohet. Ne vitin 1986 është shpallur zonë e mbrojtur nga ana e ish Kuvendit Komunal në kohën e ish-Jugosllavisë ndërmjet komunës së Rahovecit dhe Gjakovës, ku në bazë të ligjeve të atëhershme kanë pasur mundësi të dy komunat ta shpallin një zonë ndërsa tani ligji për vetëqeverisje lokale ka ndryshuar dhe planifikimin hapësinor për komunën e Rahovecit e bën propozuesi pra ekzekutivi dhe vendos kuvendi edhe për komunën e Gjakovës dhe për këtë arsye nëse keni marrë materialin që edhe drejtori e ka komplet materialin që besoj që ja keni përcjell edhe kryetarit, aty është marrë vendim nga ministria dhe instituti që njëherë të shkon nga Rahoveci pastaj ne momentin që krijohen kushtet del edhe ne Gjakovë. Por, e rëndësishme është se vendimi i vitit 1986 duhet të ndryshohet preambula, a po doni me lan ashtu si është, me ngushtua apo me zgjerua, krejt kjo varet prej diskutimeve si do të rrjedhin, prej propozimit të ekzekutivit edhe vendimmarrja është e kuvendit. Pra, preambula duhet të ndryshohet dhe të harmonizohet me ligjet aktuale të Republikës së Kosovës dhe për këtë kam kërkuar që të hyjë në diskutim publik. Pra, është mirë të diskutohet dhe të analizohet mirëpo kërkojmë që propozimin profesional të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve Natyrore që janë përgjegjës për kategorizim dhe hartimin e propozimit profesional nuk vendosin ata por pikërisht është ky kuvend dhe sigurisht që ne do ta diskutojmë se si do të bëhet, që a do të zgjerohet apo ngushtohet mirëpo propozimi profesional për shkak të informatës më të mirë dhe më thuktë që do e këtë secili kuvendarë t'i dorëzohet secilit një kopje dhe me pas do ta analizojmë dhe do të ishte mirë që për hir të Planit Zhvillimor Komunal pra planit të ri të cilin e kemi që është bërë kërkesa në ministrinë përkatëse për marrjen e certifikimit paraprak, pasi është peng kjo zonë dhe duhet të rregullohet pasi kurrëgjë s'po e ndryshojmë veçse po e ndërrojmë preambulën nëse ju jeni të pajtimit mirëpo duhet të rregullohet për me ecë tutje edhe Plani Zhvillimor Komunal dhe pas Planit Zhvillimor Komunal është harta zonale që është proces që janë të lidhura. Pra po kërkoj që secilit kuvendarë që ti shpërndahet nga një propozim profesional i institutit për mbrojtjen e monumenteve natyrore dhe do të vendosim përsëri dhe do ta bëjmë bashkë dhe jo të ngutemi që të bëjmë diçka jo mirë.

Kryetari – Unë pajtohem me Rasimin se duhet t'i sjellët kuvendit lista e operatorëve qofshin subjekte fizike apo juridike që operojnë në zonën e mbrojtur dhe të dihet saktësisht se kush janë dhe kush ka ndërhy në zonën e mbrojtur edhe pajtohem plotësisht me këtë edhe besoj që drejtorja e Urbanizmit do ta sjellë këtë listë në seancën e ardhshme. Pastaj ne jemi në proces të përmbylljes të asaj që quhet Plani i ri Zhvillimor Komunal

dhe me pastaj e kemi të ndërlidhur Hartën Zonale. Në Hartën Zonale sigurisht se mund të precizohet shumëçka, në planin zhvillimor në vija të trasha mund të vendosen parime por në Hartën Zonale përcaktohet dhe definohet pothuajse gjithçka. Unë po besoj që kemi kohë të mjaftueshme me u shërbye edhe me vlerësimet që i ka bërë instituti për mbrojtjen e monumenteve të natyrës por mos të harrojmë se duhet me i pa në proces se çka ka ndodhur me PZHK-në dhe çka do të ndodhë me pastaj me Hartën Zonale, që sigurisht që të gjitha kanë me u diskutue në këtë Kuvend të Komunës. Po ashtu duhet me pas parasysh se ne nuk mundemi në një hapësirë ku është kanioni i Urës së Fshejtë pra Drini i Bardhë nuk mund të operojmë pa u koordinua edhe me komunën e Gjakovës. Pra, nuk është se unë jam për me mbet peng në fuqi ligjet dhe preambulat e krahinës autonome të Kosovës pasi tash jemi shtet, mirëpo nuk mundemi me bo asgjë edhe pa komunën e Gjakovës, kështu që duhet me rritë fokusin edhe ekspertizën edhe të komunës se Gjakovës bashkë me ekspertizën e komunës së Rahovecit pasi ka një kanion aty që e ndan komunën e Rahovecit me atë të Gjakovës si kufinj administrativ dhe është monument i mbrojtur pavarësisht vendimeve dhe vendimet duhet me qenë në përputhje me ligjet për zonat e mbrojtura dhe monumenteve të natyrës. Unë mendoj se kemi kohë me bisedua edhe pajtohem edhe me atë që kërkoj Fehmia që t'i jepet edhe vlerësimi i institutit, pasi tash mund të ketë zhvillime te reja dhe me i dhanë mundësi që pjesa e kuvendarëve që janë më të rinj edhe që janë ndoshta për herë të parë në këtë kuvend me pas informata më të qarta edhe duhet me u shërbye edhe me shume informacione pasi kjo është pjesë e nisur kaherë dhe në momentin kur kemi argumente fakte dhe plot dëshmi atëherë besoj që vendimmarrja është më e lehtë. Kështu që nuk po them që duhet me vonua këtë çështje pasi drejtorja e urbanizmit nëse kërkon ndihmën e ndonjë komisioni të Kuvendit atëherë secili grup parlamentar mund ta caktoj në njërin prej anëtarëve të grupit për krijimin e këtij komisioni, jo vetëm në funksion të përshpejtimit por edhe te sigurimit të një informacioni me te plotë për krejt ato çka kanë ndodhur dhe çka është dashtë me ndodhë ne te ardhmen. Unë e kam edhe si propozim që nëse mundeni me nxjerr një komision prej kuvendit që me u marr me këtë punë në ndihmë të drejtorisë së Urbanizmit do të ishte ne funksion të ndihmës rreth kësaj çështje.

Fehmi Hoxha – Rreth kanionit është ligji i ujërave që e përcakton qartë, 150 metra afër lumit nuk guxon me u ndërmarr asnjë veprim, pasi është e ndaluar me ligjin e ujërave.

Kryesuesi – Faleminderit z. Hoxha, kalojmë ne pikën e parë shtesë: **Plani i Punës vjetore të Kuvendit për vitin 2021, për dalje në debat publik.**

E qesim në votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e parë shtesë. Kalojmë në pikën e dytë shtesë: **Plani i punës vjetore për vitin 2021 i Kryetarit të Komunës për dalje në debat publik.**

E qesim në votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet edhe pika e dytë shtesë.

Me propozimin e anëtarit të kuvendit z. Vahid Krasniqi që të jetë edhe një pikë tjetër : **Lista rezervë për emërtimin e rrugëve.**

Vahid Krasniqi – Sipas sqarimit të kolegut Munib Durgutit, kjo po i bie që skemi nevojë me e qitë sepse na ndalon ligji për me dal jashtë asaj ligji, kështu që ata emra që vijnë si të rinj mundemi me i futë në atë listë si plotësuese, bazohem nga ajo që tha z. Durguti nëse vërtet është i sigurt mirëpo nëse nuk është i sigurt atëherë të fusim ne votim edhe ta bëjmë si listë rekomanduese e jo listë obligative, pasi sipas vendimit të fundit është listë obligative.

Munib Durguti – Faleminderit kryesues, unë ndoshta pak e kam keqkuptua që nëse komisioni aktual për emërtime lidhet ekskluzivisht me listën e rezervë që është formuar prej komisionit paraprak atëherë këtu kemi mospajtime sepse nuk kam parë që duhet me qenë e që thotë duhet gjithmonë ajo liste te përdoret. Por drejtorja për urbanizëm apo zyrtari për urbanizëm çdo herë hulumton në teren dhe plotëson listën e rezerve dhe i sjellë kuvendit për aprovim. Atëherë nëse kemi një liste që ka aprovue drejtorja përkatëse edhe dëshiron me i lexua emrat që kanë ardhë prej lagjeve të qytetit, fshatrave apo këshillave atëherë le të propozojnë edhe e

lexojmë një nga një edhe e aprovojmë listën e rezervë pasi kuvendi është ai që e aprovon, pasi aty thotë me ligjin administrativ se Kuvendi është ai që e aprovon, mirëpo nëse nuk kemi emra të gatshëm atëherë e shtymë për seancën tjetër.

Kryetari – Kuvendi i Komunës ka vendos që komisioni kur e ka sjellë listën rezervë pas shqyrtimit të ankesave ka obligim në emërtime të reja me respektua listën e rezerve, unë kështu e kam kuptuar Vahidin edhe kështu besoj që është. Pra, asambleisti Vahid Krasniqi po thotë që a mundet kuvendi i Komunës që me heq karakterin obligativ pra opsionin obligues listës rezerve që me pastaj me mbet listë rekomanduese me plotësime të reja që bëhen nga komisioni i ri për emërtime. Pra Vahidi po thotë që kuvendi ka për obligim me zbatue listën e rezerve, kështu që nuk është patjetër i obliguar me ja vënë emrin një rruge me emrin e listës rezervë, do të ishte mirë me përfill listën rezervë por jo me qenë obligative.

Vahid Krasniqi – Ashtu siç tha Munibi me herët, ne si komision ende jemi pa e përfundua punën dhe neve vazhdimisht po na vinë kërkesa prej bashkësive lokale dhe fshatrave. Unë kërkoj dhe kish me qenë me mirë që këtë listë ta fusim si rekomanduese dhe të kemi mundësi që ta votojmë pasi nuk po i heqim dhe ne i kemi përdor afërsisht 20% emra e kësaj liste por nuk mundemi me i përdor krejt pasi kërkesat tani që janë bërë janë me nënshkrime si lagje bashkësi lokale apo kryetar i fshatit. Kështu që ta fusim si listë rekomanduese edhe po besoj që është më mirë edhe me e lehtë edhe për komisionin por edhe për kuvendin në fund me vendos.

Kryesuesi – Të nderuar kolegë, a keni të qartë lidhur me kërkesën dhe propozimin e z. Vahid Krasniqi.

Rasim Fazliu - Ne edhe për emërtimin e rrugëve është ligji dhe ne qysh atëherë e kemi punuar në baze të ligjit, por ajo që po dua të them është që nuk jemi kundër asaj që me largua fjalën obligative edhe me vendos rekomanduese, mirëpo edhe nuk jam për atë që grupe të caktuara të njerëzve po veprojnë në terren dhe po manipulojnë edhe ndonjëherë po i marrin edhe me forcë, që më pastaj po vjen deri te keqkuptimi edhe po krijohet mos pajtueshmëri. Kështu që jam për atë që komisioni me qenë shumë i vëmendshëm sepse ne jemi Kuvend Komunal dhe jemi për me i ofrua njerëzit e jo me i përçarë njerëzit kështu që me qenë shumë të vëmendshëm në këtë drejtim dhe gjithashtu jam për atë që me i emërtua me emra nga njerëzit me meritore që janë edhe që e dëshiron vet ai lokalitet por gjithsesi edhe kuvendi është mirë me u informua me ato emra dhe sigurisht në fund ato propozime në fund kanë me ardh edhe në kuvend për miratim por ndoshta nuk do të ishte keq që në këtë mbledhje, anëtarët e kuvendit me na prezantua me atë listë të emrave, në mënyrë që mos të marrim vendime pa u koordinuar pasi arsyeshmëria është e mirë dhe e saktë pasi nuk është e drejtë me than si diçka obligative pasi asgjë nuk është obligative, po besoj që isha i qartë rreth kësaj çështje. Por mos të lejohet që të bëhen manipulime pasi jam për sinqeritet dhe meritokraci.

Kryesuesi- Faleminderit z. Fazliu, besoj që u sqaruam rreth kësaj çështje që po kërkohet pra fjala obligative të zëvendësohet me fjalën rekomandim. Atëherë e qesim në votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika shtesë e rendit të ditës. Të nderuar kolegë kuvendarë, kryetar, drejtor të drejtorive, ju falënderoj shumë për kontributin e dhënë dhe mirupafshim në mbledhjen e radhës.


Mbledhja përfundoj 12:30

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

KRYESUESI

Afrim Dina



RAPORT I KUVENDIT KOMUNAL TË RAHOVECIT

(JANAR- NËNTOR)

2020

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
QËLLIMI I RAPORTIT	3
FUNKSIONIMI I KUVENDIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT	3
KOMITETET E KUVENDIT TË KOMUNËS	3
KOMITETI PËR KOMUNITETE.....	5
KOMITETET KONSULTATIVE	5
MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS DHE KOMITETEVE.....	5
KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA	17
DËGJIMET BUXHETORE PËR VITIN 2021	19
MONITORIMI I MBLEDHJEVE.....	23
RAPORTIMI I KRYETARIT TË KOMUNËS	23
NJOFTIMET PËR MBLEDHJE DHE MATERIALET PËRCJELLËSE.....	23
ÇËSHTJET E DISKUTUARA NË KUVEND- AKTET E KUVENDIT TË KOMUNËS.....	24
PUBLIKIMI I AKTEVE NË UEB-FAQEN ZYRTARE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT	25
SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE	25
RISHQYRTIMI I AKTEVE LIGJORE TË EVIDENTUARA.....	25
PËRFUNDIM	26

HYRJE

Të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit,

Bazuar në ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, në Planin e Punës së Kuvendit të Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin njëmbëdhjetë mujor lidhur me aktivitetet, punët, angazhimet dhe arritjet e Kuvendit të Komunës së Rahovecit përgjatë periudhës janar- nëntor 2020.

Në sistemin e vetëqeverisjes lokale të Republikës së Kosovës, komuna është njësia themelore e vetëqeverisjes me ç'rast i gjithë territori i Kosovës është i ndarë në 38 komuna.

Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës janë organet kryesore të komunës dhe që të dyja zgjedhen veç e veç dhe me vota të drejtpërdrejta të qytetarëve të komunës, të cilat janë obliguara të ushtrojnë kompetencat në mënyrë ligjore dhe transparente, duke siguruar edhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

Ky sistem promovon sjelljen demokratike, transparente dhe llogaridhënien e organeve të komunës si dhe garanton një kontroll të ndërsjellë ndërmjet organeve komunale.

Në kuadër të organeve të Komunës së Rahovecit, Kuvendi është organi më i lartë vendimmarrës, i cili ushtron funksionin e tij në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Planin e Punës së Kuvendit të Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit.

QËLLIMI I RAPORTIT

Përmes këtij raporti jemi munduar të krijojmë një pasqyrim të qartë për qytetarët, lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre. Ky raport ka për qëllim që të rrit transparencën dhe llogaridhënien e Kuvendit të Komunës së Rahovecit karshi qytetarëve.

Vërejtje: Raporti që do ju paraqesim në vazhdim përfshin periudhën raportuese: janar- nëntor 2020, ndërkaq pas përfundimit të vitit 2020, i njëjti do të publikohet i kompletuar në ueb faqen zyrtare të komunës së Rahovecit.

FUNKSIONIMI I KUVENDIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT

Kuvendi i Komunës së Rahovecit është organi më i lartë vendimmarrës i komunës, i cili funksionon në bazë të legjislacionit për vetëqeverisjen lokale në Republikën e Kosovës Nr.03/L-040, Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, dhe Planit të Punës së Kuvendit të Komunës. Kuvendi duhet të mbajë së paku 10 mbledhje në vit, 5 (pesë) prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit. Ky është kriteri minimal i specifikuar, i cili kërkohet të respektohet, ndërsa komunave u është lënë mundësia të përshtatin numrin e mbledhjeve varësisht nga nevojat.

KOMITETET E KUVENDIT TË KOMUNËS

Kuvendi i Komunës ka komitetet obligative sic janë:

- Komiteti për Politikë dhe Financa,
- Komiteti për Komunitete si dhe
- Komitetet konsultative ndihmëse të cilat kanë për qëllim shqyrtimin e hollësishëm të politikave, dokumenteve strategjike, vendimeve dhe rregulloreve të komunës nga njëra anë, si dhe mbikqyrjen e veprimtarive të degës ekzekutive në anën tjetër.

Andaj, Kuvendi i Komunës, themelon komitete të posaçme, të cilat e ndihmojnë atë në përmbushjen e këtyre obligimeve dhe ushtrimin e këtyre kompetencave.

Komitetet e Kuvendit të Komunës së Rahovecit

- Komiteti për Politikë dhe Financa (i përhershëm)
- Komiteti i Komuniteteve (i përhershëm)
- Komitetet Konsultative (Këshilldhënëse)

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Komiteti për Politikë dhe Financa është organi kryesor i Kuvendit të Komunës, i cili shqyrton paraprakisht të gjitha çështjet që parashihen të shqyrtohen në Kuvendin e Komunës. Kështu, Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e:

- Të gjitha politikave,
- Dokumenteve fiskale dhe financiare,
- Planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik,
- Kornizës vjetore buxhetore afatmesme,
- Planit vjetor të prokurimit,
- Rregullores vjetore për tatimet, tarifatat dhe pagesat,
- Planit vjetor të punës për auditimin e brendshëm,
- Planit buxhetor vjetor, afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, si dhe
- Marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin Komunal.

Komiteti për Politikë dhe Financa, gjatë kësaj periudhe raportuese ka pasur një performancë të mirë duke e përmbushur obligimin e tij ligjor, që të mbajë takimet e rregullta, por edhe të trajtojë të gjitha dokumentet e rëndësishme para se ato të kalojnë për diskutim në Kuvend.

Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) mbledhje për periudhën: janar –nëntor, gjatë këtyre seancave ka diskutuar pika të ndryshme duke qenë në kompetencë të saj, ajo ka diskutuar dhe ka rekomanduar Kuvendit për të gjitha çështjet që i ka pasur në rend të ditës.

KOMITETI PËR KOMUNITETE

Komiteti për Komunitete është komiteti i dytë obligativ i Kuvendit të Komunës, detyrë e të cilit është:

- Shqyrtimi i përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim.
- Shqyrtimi i të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se respektohen plotësisht të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- I rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për të avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Komiteti për Komunitete si komitet i përhershëm në këtë dymbëdhjetë mujor ka vepruar në mënyrë të rregullt dhe në përbërje të plotë, dhe gjatë këtij viti ka mbajtur gjithsej gjashtë (6) mbledhje të rregullta.

KOMITETET KONSULTATIVE

Komitetet Konsultative - Kuvendi i Komunës themelon komitete konsultative apo këshillëdhënës sektorial me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimarrjes në komunë. Në Komunën tonë është i themeluar Komiteti për Komiteti për Auditim të Brendshëm, kurse Komiteti për Shërbime Publike nuk është themeluar pasi që ka dështuar konkursi.

MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS DHE KOMITETEVE

Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar rregullat e mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës. Ky ligj ka normuar mbajtjen e së paku dhjetë (10) seancave në vit të Kuvendit të Komunës, ku pesë mbledhje duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë dhe pesë mbledhje në gjashtëmujorin e dytë.

RAPORT I PUNËS (JANAR- NËNTOR) 2020

Bazuar në këtë, Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka përmbushur obligimin ligjor sipas nenit 43.2 të LVL-ës, ku në periudhën janar- nëntor 2020 ka mbajtur:

- 11 (njëmbëmbëdhjetë) mbledhje të rregullta;
- 2 (dy) mbledhje komemorative më datë 21.01.2020 dhe më datë 09.07.2020 , mbledhje këto të mbajtura me rastin e vdekjes së ish Kryetarit të komunës së Rahovecit, z. Esat Haxhijaha dhe inspektorit të komunës së Rahovecit, z. Sabahajdin Qeska, inspektorit të komunës së Rahovecit;
- 1 (një) mbledhje solemne është mbajtur më datë 14 Qershor, për nder të Ditës së Çlirimit të Komunës së Rahovecit dhe
- 1 (një) mbledhje e jashtëzakonshme është mbajtur më datë :09.07.2020.

Të gjitha mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun duke përfshirë edhe mbledhjet e komiteteve. Si rregull, mbledhjet e komiteteve mbahen para mbledhjeve të Kuvendit. Duke marrë parasysh përgjegjësitë e dhëna me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, komitetet shqyrtojnë agjendën nga Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit, ofrimi i rekomandimeve, shqyrtimi i propozim-akteve. Vlen të theksohet se në të gjitha mbledhjet e Kuvendit Komunal Rahovec, ka qenë prezent, Kryetari i Komunës së Rahovecit dhe drejtorët e drejtorive komunale.

MBLEDHJET E KUVENDIT

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat statistikore për zhvillimet dhe ecuritë e punimeve të Kuvendit të Komunës së Rahovecit dhe komiteteve, për periudhën një veçare. Në tabelë janë të paraqitura numri i seancave të mbajtura dhe lloji i mbledhjeve për periudhën janar-nëntor 2020.

Seancat e Kuvendit Komunal	Seanca të rregullta	Seanca të jashtëzakonshme	Seanca tjera(solemne)	Nr. i seancave për muaj	Pika në rend dite
Janar	1		1	2	11
Shkurt	1			1	10
Mars	1			1	10
Prill	1			1	6
Maj	1			1	6

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- NËNTOR) 2020

Qershor	1		1	2	5
Korrik	1	1	1	3	11
Gusht	1			1	9
Shtator	1			1	7
Tetor	1			1	18
Nëntor	1			1	14
Dhjetor	0			0	0
Gjithsesj:	11	1	3	15	107 pika të rendit të ditës

Në vijim të raportit do të gjeni edhe fotografi të realizuara gjatë mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal – Rahovec.



OMU

Nr	Emri i Vendimit	Emri i Rregullores	Emri i Planit	Emri i Raportit	Emri i Informatës	Data e Aprovimit
----	-----------------	--------------------	---------------	-----------------	-------------------	------------------

Fotografitë e paraqitura janë vetëm të disa mbledhjeve të rregullta të mbajtura nga Kuvendi Komunal i Rahovecit për vitin 2020. Në vijim të këtij raporti poashtu do të evidentohen të gjitha vendimet, rregulloret dhe planet e miratuara nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit në periudhën janar – nëntor 2020.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- NËNTOR) 2020

1	Vendim për këmbim të pronës komunale me pronë private		Planin e punës së Kryetarit të Komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2020,	Raporti vjetor i punës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2019.	Informatë e Planit vjetor të njësisë së auditimit të brendshëm të KK- Rahovec	30.01.2020
2	Vendimi për miratimin e buxhetit për vitin 2020		Plani veprimi të Rekomandimeve për vitin 2019 nga auditori kombëtar (të jashtëm) dhe.	Raportit vjetor Financiar i Komunës së Rahovecit për vitin 2019.		30.01.2020
3	Vendim, për tejkalimin e të hyrave vetanake për vitin 2019 *			Raporti i punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2019		30.01.2010
4	Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për ndërtimin e Sheshit Qendror të Qytetit, në Rahovec,					30.01.2020
4	Vendimit për marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe Bashkisë së Vlorës të Republikës së Shqipërisë.		Plani i punës Prokurimit për vitin 2020,	Raporti vjetor i Komandantit të stacionit policor për vitin 2019- Rahovec.		28.02.2020
5	Vendimit për marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe Komunës Civita të Republikës së Italis					28.02.2020

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- NËNTOR) 2020

6	Vendimi marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe Komunës Frascineto të Republikës së Italis					28.02.2020
7	Vendim për Memorandum mirëkuptimit për mbulimin e pjeshëm të shpenzimeve të strehimores „Shtëpia e sigurte,, për periudhën 3 (Tre) vjeçare 2020-2022,					28.02.2020
8	Plotësim ndryshimi i vendimit të datës 16.02.2018 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi,					28.02.2020
9	Vendim për vënien në debat publik të Draft Rregullores për Taksa Komunale,					28.02.2020
10	Vendimi i Kryetarit të Komunës për shpallje të interesit të përgjithshëm parcela Nr.P-71510068-01713-5 në zonën kadastrale në Ratkoc,		Planit lokal për veprim në mjedis për vitin 2019-2024,	Raporti për menaxhimin e asetëve komunale për vitin 2019	Informatë për listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre	30.03.2020
11	Vendimi i Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike komunale në fshatin Radostë,		Planit komunal të veprimit për eficiencë për vitin 2019-2020			30.03.2020
12	Vendim për ndarje të mjeteve financiare					30.03.2020

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- NËNTOR) 2020

13	Vendim për dalje në ndihmë bizneseve të komunës së Rahovecit					30.03.2020
14	Vendim për bartjen e të hyrave vetanake të vitit 2018-2019 në vitin 2020,			Raportit Financiar Janar-Mars 2020	Informatë mbi mbikëqyrjen e zbatimit të planit të veprimit kundër korrupsionit 2018-2021.	30.04.2020
15	Vendim i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave juridik P-02279/0, 02280/0 dhe 02281/0					30.04.2020
16	Vendim për bartjen e tejkallimit të të hyrave vetanake nga viti 2019,			Raporti i DKA-së për ecurinë e zhvillimit të mësimit online/ në distancë		29.05.2020
17	Vendim për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë,					29.05.2020
18	Vendim i kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme – lokaleve afariste të Komunës në shfrytëzim personave juridik,					29.05.2020
19	Vendim mbi Kornizen Afatmesme Buxhetore (KAB) 2021-2023	Draft –rregullore për taksa komunale				29.06.2020
20	Vendimi i Kryetarit të Komunës për faljen e borgjit për taksë komunale.					29.06.2020

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- NËNTOR) 2020

21				Raporti i DKA-së rreth përfundimit të vitit mësimor 2019/2020	Informatë nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm	29.07.2020
22	Vendimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme personave fizik dhe juridik në shfrytëzim afatgjatë,			Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për periudhën 6-mujore Janar – Qershor 2020,	Informatës nga DSHPS-ja për periudhën 6-mujore Janar – Qershor 2020,	29.07.2020
23	Vendimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pëlqimit për këmbim të pronës publike komunale P- 04381-0,			Raporti nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa për periudhën 6-mujore Janar – Qershor 2020,	Informatë mbi implementimin e Planit për Investime në Hapësirat e Hapura Publike në Komunën e Rahovecit,	29.07.2020
24	Vendimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme personave fizik dhe juridik në shfrytëzim afatshkurtër,					29.07.2020
25	Vendim i Kryetarit të Komunës për bartjen e mjeteve nga rezervat e buxhetit komunal, nga kategoria e pozicionit të pagave në kategorinë e investimeve kapitale,			Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare të Komunës së Rahovecit,		27.08.2020
26	Vendim i Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-71510057-07998-0 në Rahovec,					27.08.2019
27	Vendim i Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P71510057-04475-0 në Rahovec,					27.08.2019

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- NËNTOR) 2020

28	Vendim i Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-71510057-04381-0,					27.08.2019
29	Vendim i Kryetarit të Komunës për emërtimin e Muzeut të Qytetit "Ali (Bajram) Hasku",					27.08.2019
30	Vendim i Kryetarit të Komunës për shfuqizimin e vendimit 01-Nr.90/20 të datës 29.07.2020 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë.					27.08.2019
31						29.09.2019
32				Raporti nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, për periudhën gjashtë mujore janar - qershor 2019		29.09.2019
33	Vendimi për miratimin e Buxhetit për vitin 2021,	Rregullore Komunale për Tatimin mbi Pronën e paluajtshme për vitin 2021,		Raporti i Performancës komunale janar – dhjetor 2019.		29.09.2019
34	Vendim për caktimin e komisionit ad-hoc për zgjedhjen dhe zëvendësimin e anëtarit të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe,					29.09.2019

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- NËNTOR) 2020

35	Vendim për transfere dhe rialokim të mjeteve					29.09.2019
36				Raporti Financiar për periudhën kohore janar – shtator 2020		29.10.2020
37	Vendim i Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte në Celinë, P- 71513083-00231-0					29.10.2020
38	Vendimi i Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte në Nagac, P- 71510055-00809-0				Informatë nga DKA-ja për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021.	29.10.2020
39	Vendimi i Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte në Krushë të Madhe, P-71513005-00258- 0,					29.10.2020
40	Vendimi i Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte në Krushë të Madhe, P-71513005-00257-0					29.10.2020
41	Vendimi i Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte në Krushë të Madhe, P-71513005-00256- 0,					29.10.2020

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- NËNTOR) 2020

42	Vendimi i Kryetarit të Komunës për shpallje me interes të përgjithshëm P-71510057-01817-0 – Rahovec,					29.10.2020
43	Vendimi i Kryetarit të Komunës për shpallje me interes të përgjithshëm P – 71510037-01015-96 – Xërxë					29.10.2020
44	Vendimi i Kryetarit të Komunës për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik – Rahovec,					29.10.2020
45	Vendimi i Kryetarit të Komunës për lirim nga qiraja të gjithë shfrytëzuesit e pronës së paluajtshme komunale,					29.10.2020
46	Vendim për shfuqizim të Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2020;					29.10.2020
47	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 1988 i datës 28.06.2018 për aprovimin e listës së anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe.					29.10.2020
48	Vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë në fshatin Gexhë.					29.10.2020

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- NËNTOR) 2020

49	Vendim për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër;					
50	Vendim për vënien në debat publik të Koncept Planit për Deponinë e Mbeturinave të Ngurta;					30.11.2020
51	Vendim për vënien në debat publik të Koncept Planit për Deponinë e Mbeturinave të Vëllimshme;	Draft Rregullore për Përkujdesje dhe Mbrojtje të Fëmijëve dhe marrja e vendimit për dalje në debat publik;			Informatë për zonën e mbrojtur "Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë"	30.11.2020
52	Vendim për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër personave juridik P-02279-0, 02280-0, 02281-0;					30.11.2020
53	Vendim për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;					30.11.2020
54	Vendim për shfuqizimin e Vendimit 01 Nr.124/20 të datës 29.10.2020, për dhënie në shfrytëzim afatgjatë;					30.11.2020
55	Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e komunitetit në fshatin Gexhë;					30.11.2020

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej dymbëdhjetë (11) mbledhje për periudhën: janar – nëntor 2020.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat statistikore për zhvillimet dhe ecuritë në Komitetin për Politikë dhe Financa të Komunës së Rahovecit për periudhën janar - nëntor të vitit 2020. Në tabelë janë të paraqitura numri i seancave të mbajtura dhe lloji i mbledhjeve për periudhën janar- nëntor 2020.

Komiteti për Politikë dhe Financa	Mbledhje të rregullta	Mbledhje të Jashtëzakonshme	Mbledhje tjera	Nr.i mbledhjeve për muaj	Pika në rend dite
Janar	1			1	10
Shkurt	1			1	8
Mars	1			1	8
Prill	1			1	5
Maj	1			1	6
Qershor	1			1	5
Korrik	1			1	11
Gusht	1			1	7
Shtator	1			1	7
Tetor	1			1	10
Nëntor	1			1	17
Dhjetor	0			0	0
Gjithsesj:	11			11	84 pika të rendit të ditës

RAPORT I PUNËS (JANAR- NËNTOR) 2020

Fotografi të paraqitura gjatë mbajtjes së mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa të kryesuar nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal Rahovec z. Afrim Dina.



KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC



DËGJIMET BUXHETORE PËR VITIN 2021

Njëra ndër parimet bazë për një qeverisje të mirë është zotimi se do të mbahen konsultime publike në lagje dhe fshatra. Arsyeja pse është përzgjedhur ky zotim është që të fuqizohet qeverisja e mirë, bazë e së cilës është pjesëmarrja qytetare në draftim të politikave lokale përfshirë buxhetin, për një qeverisje gjithëpërfshirëse.

Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, neni 61 e obligon Kuvendin Komunal pas

pranimit të propozim buxhetit të mbajë dëgjime buxhetore dhe më pas ta shqyrtojë dhe ndryshojë (siç e shihet të arsyeshme) draft buxhetin sipas inputit të qytetarëve, ndërsa Udhëzimi Administrativ për Transparencë në Komuna ofron detaje se si duhet të informohen qytetarët për takime publike, përfshirë dëgjimet buxhetore, dhe detajon procedurat për mbarrëvajtjen e tyre.

Në bazë të nenit 68, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 61 paragrafi 2 Të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr.03/L-048, neni 17, 18 pika 1.7 dhe 19 i Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryesuesi i Kuvendit në koordinim me Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, organizojnë dëgjime publike rreth përgatitjes së buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2021.

INFORMIMI RRETH MBAJTJES SË DËGJIMEVE BUXHETORE

RAPORT I PUNËS (JANAR- NËNTOR) 2020

Një nga sfidat kryesore të dëgjimeve buxhetore është mënyra e informimit të qytetarëve. UA për transparencë i obligon komunat që paralajmërimin e publikut për mbajtje të takimeve publike ta bëjnë përmes shpalljeve publike, mediave, ueb faqes dhe rrjeteve sociale të komunës 14 ditë para mbajtjes së dëgjimit. Komuna e Rahovecit ka bërë njoftimin për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore 14 ditë para mbajtjes së takimeve pikërisht më datë 22 qershor 2020, përmes shpalljeve publike, mediave, ueb faqes dhe rrjeteve sociale të komunës. Njoftimi ka përfshirë informata si data, koha dhe vendi i takimit, publikuar njoftimi, njoftimin mund ta gjeni në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2020/06/Kalendari-i-degjimeve-publike-me-qytetaret-e-Komunes-se-Rahovecit-per-buxhetin-e-vitit-2021.pdf>.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Rahovecit, z.Afrim Dina ka përgatitur kalendarin e dëgjimeve publike me qytetar për buxhetin e Komunës së Rahovecit për vitin 2021, në kuadër të këtij kalendari janë paraparë që të mbahen 10 (dhjetë) dëgjime publike me qytetarë. Dëgjimet publike me qytetarë, janë paraparë të fillojnë nga data 6 korrik dhe kanë përfunduar më datë 16 korrik 2020, janë mbajtur gjithsej 10 (dhjetë) dëgjime publike me qytetarë ashtu siç edhe ishte e paraparë me kalendarin e dëgjimeve publike, kalendarin mund ta gjeni në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/nees/ky-eshte-kalendari-i-degjimeve-publike-me-qytetare-te-komunes-se-rahovecit-per-buxhetin-e-vitit-2021/>. Dëgjimet buxhetore janë mbajtur në të gjitha vendbanimet, duke përfshirë edhe lagjet urbane në qytetin e Rahovecit, përpos Lagjes së Epërme ku banon komuniteti jo shumicë, arsyeja është mos interesimi i banorëve të asaj lagjeje.

Dëgjimet publike publike për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021, janë përcjellur edhe nga Zyra e Kuvendit Komunal Rahovec, si dhe Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, nga zyrtari për informim çdo ditë pas mbajtjes së dëgjimit publik në ueb faqen zyrtare të komunës së Rahovecit, janë publikuar të dhënat e mbajtjes së dëgjimeve me fotografi dhe të dhëna tjera të nevojshme.

Gjatë mbajtjes së dëgjimeve publike me qytetarë për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021 Komiteti për Politikë dhe Financa i kryesuar nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal z.Afrim Dina, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z.Afrim Limani kanë përcjellur vazhdimisht ecurinë e dëgjimeve publike me qytetarë të Komunës së Rahovecit për përgatitjen e buxhetit për vitin

RAPORT I PUNËS (JANAR- NËNTOR) 2020

2021, Komiteti për Politikë dhe Financa konsiderohet si organi kryesor i Kuvendit të Komunës, i cili shqyrton paraprakisht pothuajse të gjitha çështjet që parashihen të shqyrtohen në Kuvendin e Komunës.

Komiteti për Politikë dhe Financa, posaçërisht, dhe Kuvendi i Komunës në përgjithësi, kanë përgjegjësi të madhe në fazat e planifikimit dhe mbikëqyrjes së financave komunale. Në fazën e planifikimit, Komiteti për Politikë dhe Financa shqyrton dokumente të rëndësishme si buxheti komunal, korniza afatmesme buxhetore komunale, plani i prokurimit dhe i jep rekomandimet për veprime Kuvendit të Komunës.

Kuvendi i Komunës duke marrë parasysh edhe rekomandimet nga komiteti për politikë dhe financa, do të shqyrtojë, dhe në rast pajtimi, të miratojë, dokumentet kyçe të komunës që lidhen me menaxhimin e financave komunale.

Dëgjimet publike për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021, në secilin lokalitet janë udhëhequr nga Kryesuesi i KK-Rahovec z.Afrim Dina, pasuar më pas nga drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z.Afrim Limani i cili në secilin dëgjim të mbajtur ofroi informacionet e nevojshme lidhur me ndarjen e kategorive të buxhetit në ; Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shërbime Komunale, Subvencione e transfere dhe Investime Kapitale, të pranishmit në secilin dëgjim publik të mbajtur patën mundësi të informoheshin nga drejtori i DBF-së edhe për totalin e buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2021 e që në tërësi është: **14,548,823€**.

Kontribut të madh në dëgjime publike për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021, patjetër që kanë dhënë edhe anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, z.Rasim Fazliu, z.Dervish Cadraku, z.Fehmi Cena, znj.Fahrije Lushi- Morina, znj. Florida Bajraktari dhe znjsh.Fjolla Duraku të cilët gjatë gjithë kohës kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë e tyre karshi qytetarëve të Komunës së Rahovecit për të dëgjuar dhe marrë kërkesat, prioritetet, nevojat dhe shqetësimet e qytetarëve të secilit lokalitet të Komunës së Rahovecit.

Pjesëmarrës në dëgjime publike për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021 kanë qenë edhe drejtorë të drejtorive komunale, si drejtori i BPZHR-së z.Berat Duraku, drejtori i UPMM-së z.Rumir Zhuniqi, drejtori i Shërbimeve Publike z.Përparim Krasniqi, drejtoresha e Administratës znjsh.Saranda Sallteku, drejtori i DPI-së z.Besnik Hoti, drejtori i DKA-së, z.Avni Morina, drejtori i DGJKP-së z.Afrim Oruqi drejtori i DEZHT-së z.Artan Asllani, drejtoresha e DKRS-së, znjsh.Bjondina Kleqka, drejtori i DSHPS-së, z.Samir Mustafa dhe drejtori i DMSH-së z. Hasan Përboqi të cilët patën mundësi të dëgjojnë kërkesat dhe prioritetet e qytetarëve të Komunës së

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- NËNTOR) 2020

Rahovecit për vitin 2021, po ashtu në rast nevojë për sqarime shtesë në lidhur me ndonjë çështje që i preokupon qytetarët tanë shprehën gatishmërinë për dhënien e sqarimeve të kërkuara nga ana e tyre.

Fotografi të realizuara gjatë mbajtjes së dëgjimeve buxhetore për vitin 2021





MONITORIMI I MBLEDHJEVE

Monitorimi i mbledhjeve edhe gjatë këtij viti ka qenë i vazhdueshëm, puna dhe angazhimi ynë është monitoruar nga OSBE-ja, KFOR-i, OJQ-të

lokale si dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e cila vazhdimisht përcjell punën, aktivitetet dhe verifikimin e ligshmërisë së vendimeve tona. Gjithashtu, mbledhjet e Kuvendit Komunal Rahovec, janë regjistruar (xhiruar) rregullisht dhe janë transmetuar online për qytetarët e Komunës së Rahovecit.

RAPORTIMI I KRYETARIT TË KOMUNËS

Sistemi i qeverisjes lokale është një njësi e gjerë e cila përfshin edhe bashkëpunimin në mes të Ekzekutivit të komunës dhe Kuvendit me qëllim të realizimit të politikave publike në dobi të qytetarëve. Për këtë qëllim, mbikëqyrja dhe raportimi përbëjnë një proces mjaft të rëndësishëm të qeverisjes lokale, përmes të cilit mundësohet përcjellja sistematike e ngjarjeve dhe aktiviteteve brenda komunës. Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar përgjegjësinë e Kryetarit të Komunës për të raportuar në baza të rregullta ose atëherë kur kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Kryetari i Komunës së Rahovecit i paraqet me shkrim raportet në Kuvendin e Komunës. Formë tjetër e raportimit është edhe ajo verbale, ku anëtarët e Kuvendit parashtrojnë pyetje të drejtpërdrejta apo me shkrim, varësisht nga natyra e çështjes. Praktika të tilla, janë parë si mundësi e mirë e llogaridhënies së Ekzekutivit para Kuvendit të komunës dhe ofrimit të përgjigjeve për shumë çështje.

NJOFTIMET PËR MBLEDHJE DHE MATERIALET PËRCJELLËSE

RAPORT I PUNËS (JANAR- NËNTOR) 2020

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës, Planit të Punës së Kuvendit të Komunës, Rregullores së Punës së Kuvendit për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës, edhe për mbledhjet e të gjitha komiteteve të Kuvendit të Komunës, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët e Komunës së Rahovecit janë njoftuar me kohë, shtatë (7) ditë pune para mbledhjeve të rregullta, përmes shpalljes së njoftimeve publike në vendet e frekuentuara, si dhe përmes faqes zyrtare të komunës në internet.

Gjatë njoftimit dhe ndarjes së materialeve të mbledhjes është respektuar Ligji për Përdorimin e Gjuhëve. Njoftimet dhe materialet gjithashtu u janë dërguar edhe Ministrisë së Administrimit Lokal (MAPL) konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

ÇËSHTJET E DISKUTUARA NË KUVEND- AKTET E KUVENDIT TË KOMUNËS

Gjatë periudhës janar – nëntor, Kuvendi Komunal Rahovec ka zhvilluar 11 seanca të rregullta. Në kuadër të këtyre seancave është diskutuar për çështje të ndryshme me gjithsej 107 pika të rendit të ditës. Nga çështjet të cilat janë diskutuar në Kuvend, vërehet që për këtë periudhë njëmbëdhjetë mujore kemi disa akte të ndryshme komunale qofshin ato rregullore, vendime, plane, raporte, informata të ndryshme. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhëna për llojin dhe numrin e akteve komunale që ka miratuar Kuvendi i Komunës nga fushëveprimtaria e vet.

Siç mund të shihet nga tabela, për periudhën: janar - nëntor Kuvendi i Komunës ka nxjerrur këso lloj aktesh:

AKTE	NR.
RREGULLORE	3
PLANE	5
VENDIME	55
RAPORTE	13

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

RAPORT I PUNËS (JANAR- NËNTOR) 2020

INFORMATA	7
GJITHSEJ	83

PUBLIKIMI I AKTEVE NË UEB-FAQEN ZYRTARE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT

Si mjet kryesor për të ofruar qasjen e publikut në këto të dhëna, janë faqet zyrtare elektronike. Gjatë kësaj periudhe raportuese, të gjitha aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës janë publikuar në faqen elektronike të Komunës së Rahovecit.

SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE

Ministria e Pushtetit Lokal është autoritet mbikqyrës i komunave për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve, andaj gjatë periudhës janar - nëntor 2020 të gjitha aktet apo vendimet që janë marr në Kuvendin e Komunës së Rahovecit, i janë dërguar për shqyrtimin e ligjshmërisë, Ministrisë së Pushtetit Lokal. Numri i Konfirmimit të ligjshmërisë së vendimeve të kthyer nga MAPL-ja është gjithsej 33.

RISHQYRTIMI I AKTEVE LIGJORE TË EVIDENTUARA

Në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë, Ministria e Pushtetit Lokal ka shqyrtuar të gjitha aktet e miratuara nga ana e Kuvendit Komunal Rahovec, ku gjithsej na janë kthyer 22 konfirmime, dhe është rekomanduar rishikimi i 3 (tre) vendimeve të miratuara. Bazuar në këto rekomandime, vendimet janë rishqyrtuar dhe janë miratuar në përputhje me rekomandimet e MPL-së.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

PËRFUNDIM

Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Raporti i punës i Kuvendit Komunal- Rahovec, është dëshmi e respektit ndaj Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, në frymën e transparencës, llogaridhënies dhe performances sa më të mirë komunale dhe i dedikohet të zgjedhurve nga qytetarët, monitoruesve dhe publikut të gjerë.

Mirëpresim kontributin e secilit që përmes vërejtjeve, këshillave, plotësimeve apo të dobësive eventuale, që t'i bëjmë bashkërisht përmirësimet e nevojshme, në mënyrë që në të ardhmen ta bëjmë sa më mirë punën tonë.

Ju faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit

Afrim Dina

Udhëheqës për punë të Kuvendit

Skender Hamza

01 Nr. ____/2020

Rahovec, __.12. 2020



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLICA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E RAHOVECIT/ OPŠTINA ORAHOVAC/ MUNICIPALITY OF RAHOVEC



Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Rahovecit
Nr.

RAPORTI VJETOR I PUNËS

Për periudhën 01.01.2020 - 30.11.2020.

(i formës së shkurtër)

Raporti i punës së NJAB-së për periudhën Janar - Nëntor të vitit 2020

Ndërsa bazë ligjor ka pasur Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Udhëzimet Administrative për Auditim të Brendshëm, Doracakun e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit të Brendshëm dhe Instruksionet lidhur me Standardet Ndërkombëtarë të Auditimit të Brendshëm.

Në tabelën e mëposhtme do të paraqiten të gjitha auditimet të planifikuara dhe të kryera për periudhën Janar Nëntor të vitit 2020 sipas Planit Vjetor dhe sipas shkallës së rrezikshmërisë.

N.r.	Drejtoritë e synuara të auditimit të Planifikuara dhe të realizuara për periudhën Janar – Nëntor të vitit 2020	Shkalla e rrezikshmërisë sipas Planifikimit
1	Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit Hapsinor dhe Mbrojtjeje të Mjedisit. Procesi nën auditim: 1. Realizimi dhe inkasimi i të hyrave vetanake 2. Zbatimi i Taksaës për lëshimin e lejeve për ndërtim, përdorim, prishje të objekteve ndërtimore, 3. Dhënja e lejes Mjedisore Komunale,	I Mesëm 2 Rekomandime
2	Drejtoria e Kadastrës, Gjeodezi dhe Pronë Procesi nën auditim: 1. Grumbullimi i të hyrave vetanake sipas planit 2. Barazimi dhe harmonizimi i të hyrave në raport me zyrtarin e të hyrave vetanake 3. Mbledhja e Taksave për shërbimet kadastrale, 4. Mbledhja e taksave për regjistrimin e pronësisë dhe posedimit.	I Mesëm 3 Rekomandime
3	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sport Procesi nën auditim: 1. Grumbullimi i të hyrave vetanake sipas planit. 2. Inkasimi i Taksave për shfrytëzimin e sallave, stadijumeve(terreneve sportive), teknikës, biletat dhe anëtarësimi në bibliotek.	I Mesëm

	3. Shpenzimet 4. Menaxhimi i subvencioneve.	4 Rekomandime
4	Drejtoria e Ekonomisë, Zhvillim dhe Turizëm Procesi nën auditim: 1. Realizimi dhe harmonizimi i të hyrave nga qëraja dhe veprimtarit afariste 2. Taksat dhe ngarkesat vjetore për ushtrimin e afarizmit për subjekte juridike (ndërmarjet). 3. Dhënja në shfrytëzim të pronës komunale (ankand publik) Menaxhimi, evidentimi dhe mirëmbajtja e pasurive (asetet).	I Lartë 6 Rekomandime
5	Drejtoria për Shërbime Publike, Komunale Procesi nën auditim: 1. Menaxhimi i Projekteve 2. Inkasimi dhe Realizimi i të hyrave vetanake 3. Taksat për shfrytëzimin e përkohshëm të hapsires publike për kryerjen e veprimtarisë së tyre, subjektet afariste të regjistruara. 4. Taksat për vendosjen e objekteve të përkohshme (Baraka, kioska etj.) 5. Taksat për dhënie me qira të hapësirës publike dhe aseteve nëntokësore për shfrytëzimin.	I Mesëm 3 Rekomandime
6	Drejtoria për Administratë të Përgjithshme. Procesi nën auditim: 1. Aplikimi i tarifave në lëshimin e vërtetimeve dhe dokumenteve zyrtare 2. Realizimi dhe inkasimi i të hyrave vetanake. 3. Deponimi i mallrave Hyrje - Dalje në Depo. 4. Përdorimi i Automjetet zyrtare në bazë të udhëzimit administrativ.	I Mesëm 3 Rekomandime
7	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Procesi nën auditim: 1. Inkasimi dhe realizimi i të hyrave 2. Taksat për shërbimet Shëndetësore nga participimi. 3. Tarifat për sektorin e QPS-së	I Mesëm

	4. Shpërndarja e barnave esenciale. 5. Menaxhimi i automjeteve në bazë të udhëzimit në fuqi. 6. Mirëmbajtja e dosjeve të punëtorëve.	6 Rekomandime
8	Drejtoria për Financa dhe Buxhet Procesi nën auditim: 1. Inkasimi dhe realizimi i të hyrave nga tatimi në pronë. 2. Inkasimi dhe realizimi i të hyrave nga Automjetet motorrike 3. Shpenzimet 4. Dhënja e Avanseve 5. Shpenzimi i Paras së gatshme 6. Ndarja e subvencioneve në bazë të regullorës	I Lartë 4 Rekomandime
9	Zyra e Prokurimit Ky Auditim është në proces.	I Lartë

Gjithësejt: 31 Rekomandime.

Vlerësimi i objektivave për auditime, sipas shkallës së rrezikshmërisë është bërë në Planin Strategjik të NJAB-së për vitet 2020 – 2022.

Aktivitetet dhe angazhimet e tjera të Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Angazhimet tona kryesisht kanë qenë në:

- Verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të AB dhe Auditorit të Përgjithshëm të dhëna në auditimet e kaluara, si dhe përgatitja e raportit të gjashtëmujorit të dytë dhe raportin vjetor të NJAB-së për vitin 2020.
- Raportin e gjashtëmujorshit të dytë dhe Raportin Vjetor të NJAB-së për vitin 2019, i janë dorëzuar Njesisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), Kryetarit të Komunës dhe Komitetit për Auditim të Brendshëm, të gjitha janë dorëzuar brenda afatit kohor të paraparë me ligj.
- Përgatitja e planit të zbatimit të rekomandimeve dhe verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna në vitin 2020.
- Verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna në periudhën Janar – Qershor të vitit 2020.
- Si aktivitete tjera mund të ceken ofrimin e ndihmave profesionale të vazhdueshme për të gjitha Drejtoritë Komunale që kanë shfaqur interesim dhe nevojë, lidhur me të kuptuarit e rreziqeve në implementimin e rekomandimeve, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e tyre, duke e krijuar një regjistër me reziqe të identifikuarashtu që menaxhmentet gjegjëse të kenë më lehtë të ushtrojnë kontrollet gjegjëse adekuate për minimizimin e çdo rreziku që mund të jetë pengesë për zbatimin e objektivave të Drejtorive.

Gjithashtu NJAB-ja ka pasur angazhime me të gjithë zyrtarët të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e implementimit të rekomandimeve.

Vlerësimi përmbyllës

Në këtë periudhë (Janar-Nëntor) NJAB-ja nuk kan arritur objektivat e planifikuara në bazë të Planin Vjetor, për shkak të pandëmisë (Covid 19), nuk ka qenë e mundur të kryhet auditimi i brendshëm në Drejtorin për punë Inspektuese.

Kërkohet një angazhim më konkret i menaxhmenteve të Drejtorive Komunale dhe menaxhmentit të lartë të Komunës për implementimin e rekomandimeve për vitin 2020, të dhëna si nga Auditori i Përgjithshëm ashtu edhe nga Auditori i Brendshëm.

DNJAB.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12.2 shkronja (d), nenit 17 shkronja (f) dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe 46 paragrafi 1 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.6 i Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.12.2020, merr këtë:

V E N D I M

Për vënien në debat publik të Rregullores komunale për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Rahovecit

1. Kuvendi i Komunës së Rahovecit merr vendim për vënien në debat publik të Draft Rregullores komunale për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Rahovecit.
2. Të drejtë pjesëmarrje në debat publik kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit dhe subjektet të tjera të interesuara.
3. Për datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së debatit publik qytetarët dhe subjektet tjera të interesuara do të njoftohen përmes web - faqes zyrtare të Komunës dhe shpalljes publike në tabelën e shpalljeve .
4. Pyetjet, vërejtjet, sugjerimet, komentet etj. (verbale dhe me shkrim), mund ti drejtohen ekipit për përcjelljen e debatit publik drejtpërdrejtë ose përmes zyrës së Kuvendit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Administratë dhe zyra e Kryetarit të Komunës së Rahovecit.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Shërbime Publike,*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. __/20
Me datë: 29.12.2020

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



DRAFT RREGULLORE NR. 03/2020

PËR

**PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE BASHKËPUNIMIN
E KOMUNËS ME FSHATRA, VENDBANIMET DHE LAGJET
URBANE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT**

Nëntor 2020

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNAVE ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE

Kuvendi i Komunës në Rahovec

Në mbështetje të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12 pika c), nenit 17, nenit 34 paragrafi 34.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funkzionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, nenit 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.3, nenit 13, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.1 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur më datën _____, miraton këtë:

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNAVE ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim që të rregullojë organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Rahovecit, në themelimin e këshillave lokale, në ushtrimin e aktiviteteve që janë në përgjegjësi dhe kompetencë të komunës.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo rregullore përcakton themelimin, formën dhe mënyrën e bashkëpunimit të komunës me këshillat lokale për çështjet e interesit publik në ushtrimin e aktiviteteve që janë në kompetencë të komunës.

Neni 3 Komisioni për përzgjedhjen e këshillave lokale

1. Kuvendi i Komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në zgjedhjen e këshillave lokale. Komisioni duhet të ketë shtatë (7) anëtarë, katër (4) anëtarë nga Kuvendi i Komunës, një (1) nga ekzekutivi, një (1) nga shoqëria civile dhe një (1) nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës.
2. Komisioni duhet të reflektoj përfaqësim gjinor dhe etnik.
3. Kryesuesi i komisionit zgjedhet nga anëtarët e Komisionit.
4. Mandati i komisionit është lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës.

5. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, duhet të jetë përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së zgjedhjeve për anëtarë dhe kryetarë të këshillave lokale.
6. Së paku katër (4) anëtarë të komisionit të Kuvendit të Komunës, duhet të jenë të pranishëm në të gjitha takimet zgjedhore që organizohen për zgjedhjen e këshillave lokale.
7. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës dhe përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, bashkëpunojnë në mënyrë që të organizojnë zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale.
8. Komisioni i raporton Kuvendit të Komunës për procesin e përzgjedhjes së këshillave lokale.

Neni 4

Njoftimi për organizimin e takimeve për përzgjedhjen e këshillave lokale

1. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, përmes zyrës për informim, informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së takimit me qytetarë për zgjedhjen e këshillave lokale, përmes:
 - 1.1. shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe hapësirat më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen takimet për zgjedhjen e këshillave lokale;
 - 1.2. mediave lokale;
 - 1.3. ueb-faqes zyrtare të Komunës;
 - 1.4. Platforma tjera të komunikimit (digjital).
2. Njoftimi për publikun duhet të përmbajë rendin e ditës, datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së takimit.

Neni 5

Formimi i këshillave lokale

1. Këshilli lokal mund të ketë nga 5 (pesë) deri 9 (nëntë) anëtarë.
2. Numri i anëtarëve të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni, për secilin këshill lokal, përcaktohet nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane që janë të pranishëm në takimin zgjedhor.
3. Çdo fshat, vendbanim apo lagje urbane duhet të jetë i përfaqësuar në këshillin lokal.
4. Në raste kur këshilli lokal ka numër çift të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane, atëherë fshati, vendbanimi apo lagja urbane me numër më të madh të banorëve përfaqësohet me dy anëtarë në këshillin lokal.
5. Anëtarë të këshillave lokale zgjedhen kandidatët të cilët fitojnë numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i banorëve me të drejte vote të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë të pranishëm në takim zgjedhor.
6. Kryetari i këshillit lokal zgjedhet kandidati i cili fiton numrin më të madh të votave të qytetarëve që marrin pjesë në takim.
7. Nëse në rrethin e parë të votimit kemi dy apo me shumë kandidatë me numër të barabartë të votave, atëherë mbahet rrethi i dytë i votimit dhe kandidati që merr më shumë vota zgjedhet për anëtar dhe kryetar të këshillit lokal.
8. Rezultatet e zgjedhjeve, emrat e anëtarëve dhe të kryetarit të këshillit lokal, duhet të bëhen publike menjëherë pas takimit zgjedhor.
9. Procesverbali i hartuar nga takimi i qytetarëve, duhet të përmbajë datën, orën dhe vendin e mbajtjes së takimit, numrin dhe e , listën e pjesëmarrësve që kanë marrë pjesë në takim, të

- dhënat për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale, procedurat e votimit dhe çështje të tjera të adresuara në takim.
10. Procesverbalin e nënshkruajnë kryesuesi i takimit, anëtarët e komisionit dhe procesmbajtësi.

Neni 6

Kriteret e përzgjedhjes për këshillat lokale

1. Kandidatët për anëtarë të këshillave lokale duhet të jenë banorë të përhershëm në atë vendbanim ku mbahen takimet zgjedhore.
2. Kandidatët për anëtarë dhe kryetarë të këshillave lokale nuk mund të kandidohen nëse janë të zgjedhur apo të emëruar në poste udhëheqëse në strukturat e subjekteve politike.
3. Të drejtë vote kanë të gjithë banorët me moshë mbi 18 vjeç.
4. Çdo fshat, vendbanim apo lagje urbane duhet të propozojë së paku dy kandidatë për përfaqësim në këshillin lokal.
5. Takimet kanë legjitimitet juridik, nëse të pranishëm janë së paku 50 pjesëmarrës më të drejtë vote të atij vendbanimi.
6. Përbërja e këshillave lokale duhet të reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore sipas legjislacionit në fuqi.
7. Në këshillin lokal përfaqësohet edhe komuniteti joshumicë me numër më të madh të banorëve të atij lokaliteti që janë të pranishëm në takim dhe votojnë.
8. Zgjedhja bëhet përmes votimit të fshehtë .

Neni 7

Komisioni i ankesave

1. Kuvendi i Komunës themelon Komisionin e ankesave i cili shqyrton ankesat lidhur me procesin e zgjedhjes së këshillave lokale.
2. Komisioni i ankesave do të ketë 3 anëtarë të cilët zgjedhen nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
3. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës.
4. Të gjithë pjesëmarrësit në takimin zgjedhor mund të paraqesin ankesat e tyre, nëse konstatojnë ndonjë,parregullsi gjatë procesit zgjedhor.
5. Ankesat për parregullsi në procesin zgjedhor duhet të paraqiten pranë Komisionit për ankesa brenda 3 ditëve të punës.
6. Komisioni i ankesave është i obliguar që t'i shqyrtojë të gjitha ankesat dhe brenda afatit prej 15 ditëve nga data e parashtrimit të kërkesës, t'u kthejë përgjigje me shkrim atyre që kanë adresuar ankesën.
7. Vendimet e Komisionit të ankesave janë obligative.
8. Komisioni i ankesave i raporton Kuvendit të Komunës.

Neni 8

Mandati i këshillave lokale

1. Mandati i këshillave lokale është 4 (katër) vite.
2. Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokale përfundon si në vijim:

- 2.1. me përfundimin e mandatit;
- 2.2. nëse jep dorëheqje;
- 2.3. nëse shkarkohet;
- 2.4. nëse ndërron vendbanimin;
- 2.5. në rast të dënimit për vepër penale me një urdhër për burgim për 6 (gjashtë) muaj ose më tepër;
- 2.6. Nëse vdes.
3. Procedura e shkarkimit të kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokale bëhet sipas procedurës së zgjedhjes.
4. Në rast të humbjes së mandatit të kryetarit të këshillit lokal, komisioni komunal brenda 30 (tridhjetë) ditësh duhet të organizojë zgjedhjet për zgjedhjen e kryetarit të ri.
5. Zëvendësimi i anëtarëve të këshillave lokale në rastin e humbjes së mandatit bëhet nga lista e pritjes, me aprovimin e komisionit të kuvendit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.

Neni 9

Konsultimet ndërmjet komunës dhe këshillave lokale

1. Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Kryesuesin e Kuvendit organizojnë së paku dy takime në vit me kryetarët e këshillave lokale.
2. Kryetarët e këshillave lokale, ftohen të marrin pjesë në takime konsultative, debate dhe konsultime publike me qytetarë.
3. Kuvendi i Komunës duhet të konsultojë këshillin lokal, në çështje të caktuara me interes për komunitetin.

Neni 10

Bartja e aktiviteteve nga komunat te këshillat lokale

1. Komuna mund të bartë disa aktivitete që janë në kompetencë vetanake për t'i zbatuar këshillat lokale.
2. Këshilli lokal duhet të konsultohet dhe pranojë bartjen e aktiviteteve nga Komuna.
3. Bartja e aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal duhet të mbështetet me financim të nevojshëm.

Neni 11

Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e këshillit lokal

1. Këshilli lokal mund të takohet në çdo kohë për të shqyrtuar çështjet me interes të lokalitetit si dhe harton dhe miraton planin e punës së këshillit dhe rregullat e brendshme të funksionimit.
2. Këshilli lokal organizon, përcjellë dhe harton planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit në të gjitha sferat në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e Kuvendit, komitetet dhe drejtoritë komunale.
3. Këshilli lokal duhet të informojë komunën për kohën dhe agjendën e takimeve. Zyrtarë kompetent komunal mund të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshillat lokale.
4. Takimet e qytetarëve mund të organizohen me iniciativën e këshillit lokal.
5. Këshilli lokal mund të ndërmarrë aktivitetet, të cilat në veçanti ndikojnë në:
 - 5.1 Planifikimin urban dhe rural;
 - 5.2 Furnizimin me ujë, rregullimi i kanalizimit, drenazhimin;
 - 5.3 Shëndetësinë publike;

- 5.4 Mbrojtjen lokale të ambientit;
- 5.5 Turizmin;
- 5.6 Hapësirave publike dhe varrezave;
- 5.7 Aktiviteteve kulturore, arsimore, sportive etj.
- 6. Me pëlqimin e Kryetarit të Komunës, një anëtar i këshillit lokal mund të jetë pjesë e organeve për monitorimin, zbatimin e projekteve për investime kapitale në lokalitetet e tyre.
- 7. Këshillat lokale kanë të drejtë të bashkëpunojnë në mes veti në territorin e komunës përkatëse.
- 8. Këshillat lokale kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesë me shkrim organeve kompetente të Komunës për çështje të ndryshme në interes të lokalitetit dhe komuna i përgjigjet brenda afatit prej 30 ditësh.

Neni 12

Roli i kryetarëve të këshillave lokale

1. Kryetari i këshillit lokal përfaqëson fshatin, vendbanimin dhe lagjen urbane në konsultimet dhe diskutimet me organet e Komunës.
2. Kryetari i këshillit lokal ka obligim t'i informojë anëtarët e këshillit për rezultatet ose konkluzionet nga takimet me organet e komunës.
3. Kryetari i këshillit lokal thërret dhe udhëheq me mbledhjen e këshillit lokal dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit.
4. Kryetari i këshillit lokal nënshkruan propozimet e miratuara nga konkluzionet e këshillit lokal dhe është i obliguar që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e miratimit të tyre t'i adresojë në Zyrën e Kryetarit të Komunës.

Neni 13

Financimi i aktiviteteve

1. Aktivitetet e këshillave lokale dhe projektet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në mes komunës dhe këshillave lokale mund të financohen si vijon:
 - 1.1 Nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane;
 - 1.2 Nga komuna;
 - 1.3 Nga donatorët; dhe
 - 1.4 Me financim të përbashkët.

Neni 14

Kompensimi i kryetarëve të këshillave lokale

1. Për punën e tyre kryetarët e këshillave lokale kompensohen nga buxheti i komunës përkatëse.
2. Kompensimi për kryetarët e këshillave lokale bëhet në vlerën financiare ekuivalente me anëtarët e komiteteve obligative.
3. Kompensimi për pjesëmarrjen në takime bëhet vetëm për 6 (gjashtë) takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit kalendarik.

Neni 15
Mos përmbushja e përgjegjësi

Këshilli lokal mban obligime dhe përgjegjësi ligjore për të gjitha aktivitetet e bartura nga organet e Komunës në këshillin lokal.

Neni 16
Dispozitat kalimtare

1. Në rast të konfliktit të dispozitave të kësaj rregullore me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane apo me Statutin e Komunës, mbizotërojnë dispozitat e Ligjit, Udhëzimit Administrativ apo Statutit.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Rahovecit Nr. 3323 të datës 28.08.2014.

Neni 17
Përgjegjësia për zbatim

Kryetari i Komunës, Drejtoria për Administratë është përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në Web faqen e Komunës.

Nr.:

Afrim Dina

Data:

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.12.2020 merr këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit 01-Nr. 131/20 i datës 30.11.2020 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi 01-Nr. 131/20 i datës 30.11.2020 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër.
2. Anulohet procedura për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në zonën kadastrale në Rahovec, në vendin e quajtur Gavne Shume, e evidentuar P.SH. E Kosovës KK Rahovec.
3. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01Nr. ____/20
Datë: 29.12.2020

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14, 17 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë:29.12.2020 merr këtë:

V E N D I M

Për këmbimin e pronës komunale me pronën private

1. Miratohet propozimi Kryetarit të Komunës 01 Nr. 1573/20 i datës 08.12.2020 dhe jepet PËLQIMI për këmbimin e pronës publike komunale me pronën private për interes publik, e cila gjendet në vendin e quajtur Rakita Zonë Kadastrale Xërxë, ngastra me numër P-71510033-01015-10 sipas Certifikatës së pronësisë pronë e PSHE Kosovës KK. Rahovec me sipërfaqe prej 87m² (tetëdhjetë e shtatë metra katror) e cila ndahet nga pjesa e përgjithshme prej 1205m² (njëmijë e dyqind e pesë metra katror) **I JEPET** në posedim Faton (Zenel) Thaqi nga fsh. Xërxë, ndërsa ngastra sipas Certifikatës së pronësisë P-71510033-01015-9 në emër të Harley House SH.P.K me seli në Xërxë me sipërfaqe të përgjithshme prej 993m² (nëntëqind e nëntëdhjetë e tre metra katror) i muret pjesa e parcelës me sipërfaqe prej 87m² (tetëdhjetë e shtatë metra katror) dhe **I JEPET** Komunës së Rahovecit, në emër të këmbimit për hapjen e rrugës publike.
2. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën private të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është për interes publik, përkatësisht për hapjen e rrugës publike dhe se në të njëjtin vend nuk ekzistojnë parcela tjera komunale të përshtatshme për këtë qëllim.
3. OBLIGOHET, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që t'i zhvillojë procedurat ligjore në përputhje me dispozitat e nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
4. Vlerësimi i pronës komunale dhe pronës private të cekur në pikën 1 të këtij vendimi bëhet në bazë të ligjit përkatës për pronën e paluajtshme.

5. Pas përfundimit të procedurave për këmbim, rezultatet e këmbimit duhet publikuar, me përmbajtjen e të dhënave e provave të këmbëyer, si dhe emrin e pronarit privat me të cilin është bërë këmbimi.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Kuvendit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/20
Me datë: 29.12.2020

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipality Mayor



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/OPŠTINE/RAHOVEC/RAHOVEC MUNICIPALITY MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No. 1573 Nr. i faq./Br.str./No. pg. 158
Data/Datum/Date 08/12/2020
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 25 paragrafi 4, 5 dhe 6 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 74 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

PROPOZON

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit dhënien e PËLQIMIT për këmbimin e pronës publike komunale me pronën private për interes publik, e cila gjendet në vendin e quajtur Rakita, Zonë Kadastrale Xërxë, ngastra me numër P-71510033-01015-10 sipas Certifikatës së pronësisë pronë e PSHE Kosovës KK. Rahovec me sipërfaqe prej 87m² (tetëdhjetë e shtatë metra katror) e cila ndahet nga pjesa e përgjithshme prej 1205m² (njëmijë e dyqind e pesë metra katror) **I JEPET** në posedim Faton (Zenel) Thaqi nga fsh. Xërxë, ndërsa ngastra sipas Certifikatës së pronësisë P-71510033-01015-9 në emër të Harley House SH.P.K me seli në Xërxë me sipërfaqe të përgjithshme prej 993m² (nëntëqind e nëntëdhjetë e tre metra katror) i muret pjesa e parcelës me sipërfaqe prej 87m² (tetëdhjetë e shtatë metra katror) dhe **I JEPET** Komunës së Rahovecit, në emër të këmbimit për hapjen e rrugës publike.
2. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën private të cekur në pikën 1 të këtij propozimi është për interes publik, përkatësisht për hapjen e rrugës publike dhe se në të njëjtin vend nuk ekzistojnë parcela tjera komunale të përshtatshme për këtë qëllim.
3. OBLIGOHET, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që t'i zhvillojë procedurat ligjore në përputhje me dispozitat e nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
4. Vlerësimi i pronës komunale dhe pronës private të cekur në pikën 1 të këtij propozimi bëhet në bazë të ligjit përkatës për pronën e paluajtshme.
5. Pas përfundimit të procedurave për këmbim, rezultatet e këmbimit duhet publikuar, me përmbajtjen e të dhënave e provave të këmbyer, si dhe emrin e pronarit privat me të cilin është bërë këmbimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
2. Sekretarisë së Kuvendit dhe
3. Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/121 Nr. i fuqi/Brab./No. pg 1

Data/Datum/Date 29.10.2020

Në mbështetje të nenit 12 pika 1, nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c), nenit 40 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 2, nenit 4, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, propozimit të Kryetarit të Komunës me Nr. Protokolli 02/1338/20 të dt. 12.10.2020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.10.2020, miraton këtë:

V E N D I M

Shpallen me interes të përgjithshëm publik parcela P-71510033-01015-9 në Zonën Kadastrale Xërxë

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/1338/20 i dt. 12.10.2020 dhe shpallet interes i përgjithshëm publik pjesa e parcelës kadastrale P-71510033-01015-9, në sipërfaqe prej 87 m² (tetëdhjetë e shtatë metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 993m² (nëntëqind e nëntëdhjetë e tre metra katror) në vendin e quajtur Rakita, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në pronësi të Harley House SH.P.K.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës së cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë: "Hapja e rrugës publike" në Xërxë që gjendet në vendin e quajtur "Rakita", është tokë bujqësore kullos e klasit të katërt ZK.Xërxë.
3. Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- MAPL-së,
- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01-Nr.121/20
Datë:29.10.2020



KRYETARIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT
KUVENDIT KOMUNAL
PËR DREJTORIN PËR GJEODEZI DHE KADASTER

LËNDA: Kërkesë për kompenzim të pronës së paluajtshme

Komuna e Rahovecit, Drejtoria kompetente pas matjeve dhe skicimit ka bërë kubëzimin e rrugës lokale e cila gjendet në fshatin Xerxë, konkretisht rruga "Nëna Tereza", e cila cila fillon në rrugën kryesore Xerxë Prizren.

Gjatë matjeve nga drejtoria për gjeodezi dhe kadaster, me qëllim apo gabim një pjesë e parcelës sime me nr.1015-9 është përfshirë në pjesë të rrugës publike dhe me saktësisht 87 metra katror, është kubëzuar dhe shëndërru në rrugë publike pa dëjtin time dhe pa pëlqimin tim.

Me punimet dhe shërndërrimin e kësaj pjese të parcelës sime në rrugë publike unë nuk mund të e shfrytëzoj pronën time private ashtu siç e kam planifikuar dhe kjo paraqet pengesë të madhe për mua.

ANDAJ, me këtë kërkesë ju drejtohem juve si Kryetar i Komunës, që në bazë të kompetencave të juaja, pa e demtuar interesin primar të komunës, dhe duke e parë të nevojshme interesin timë si palë e demtuar pa pëlqimin time, pasi me është cenuar e drejta ime në pronë të paluajtshme e cila konsiderohet e pacenushme, të me kompenzohet pronë ime, me parcelën nr.1015-10

Nëse nuk me kompenzohet pjesa ime prej 87 metra katror, me parcelën nr.1015-10, apo një pjesë të saj, unë do të kthehem në pjesën time të parcelës të cilën e kemi shëndërruar në rrugë publike me kërkesë apo edhe me të fund do të kërkoj të drejtën time përmes rrugëve gjyqësore.

KËRKOJ; që kur të vlerësoni kërkesën time të vendosni me mirkuptim dhe të keni parasysh interesin e juaj po ashtu edhe interesin time si pronar legjitim i parcelës të cenuar nga ana juaj, dhe të më jepni si kompenzim parcelën me nr.1015-10, dhe ju bëj me dije se nuk pranoj asnjë kompenzim tjetër përveç kësaj.

Kërkesës ia bashkangjesini:

- Skica e vendit të ngjorjes.
- Akordim mbi barjen e pronës, apo legjitimim i bierjës

Shprehsoj në mirkuptimin tuaj, dhe do të aprova kërkesën time.

Rahovec
07.10.2020.

Paraqitësi i kërkesës
Faton Zenel Thaqi, fshat Xerxë-Rahovec
Me autorizim të Atif Morina



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu



Datë/Datum/Date:	09.12.2020	- III - Nr. i prot. <u>4958</u> Br. prot. <u>09.12.2020</u> Më Dt. <u>20</u>
Për/Za/To:	z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës	RAHOVEC ORAHOVAC
Nga/Od/From:	Arben Gashi, Kryesues i Komisionit për Vlerësimin e Pronës Komunale për Këmbim	
Lënda/Predmet/Subject:	Raport	

Në bazë të vendimit të kryetarit 1571/2020 të datës 08.12.2020 për caktimin e komisionit për Vlerësimin e Pronës Komunale për Këmbim në komunën e Rahovecit, komisioni në përbërje: Arben Gashi, kryesues, Ekrem Bytyqi, anëtar dhe Ali Kryeziu, anëtar.

Komisioni ka mbledhur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për Vlerësimin e Pronës Komunale për Këmbim në komunën e Rahovecit. Me datë 09.12.2020, komisioni ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka bërë vlerësimin e dy parcelave në Z.K. Xërxe komuna e Rahovecit, pasuria Shtetërore e Kosovës (PSH) KK.Rahovec dhe Pronës private në Z.K. Xërxë, komuna e Rahovecit. Duke u bazuar në neni 24 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Komisioni ka bërë vlerësimin se prona komunale që do jepen në këmbim, ka këto karakteristika: parcela e cila gjendet në vendin e quajtur "RAKITA" në zonën kadastrale Xërxë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1205m² P-71510033-01015-10 Pasuri Shtetërore e Kosovës KK.Rahovec, të ndahet pjesa e kësaj sipërfaqe prej 87m² dhe t'i jepet Pronarit privat (Faton Zenel) Thaqi në posedim të Harley House SH.P.K në Z.K Xërxë, komuna e Rahovecit. Kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim është: parcela e cila gjendet në vendin e quajtur "RAKITA" në fshatin Xërxë, komuna e Rahovecit, me sipërfaqe të përgjithshme prej 993m² P- 71510033-01015-9, në posedim të Harley House SH.P.K në Z.K Xërxë, të ndahet pjesa e kësaj sipërfaqe prej 87m² dhe t'i jepet Komunës së Rahovecit, në emër të këmbimit ku do të bëhet "Hapja e rrugës publike" në Z.K Xërxë, komuna e Rahovecit.

Komisioni për Vlerësimin e pronës Komunale për këmbim, ka vlerësuar se këmbimi i pronave të Paluajtshme duhet të bëhet pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme ku do të bëhet "Hapja e rrugës publike" është në interes të banorëve të fshatit Xërxë dhe dot t'i mundësoj lëvizjen e lirë të qytetarëve.

Bazuar në gjendje faktike në teren nga komisioni për Vlerësimin e Pronës Komunale për Këmbim, ka konstatuar se është sipërfaqe e përshtatshme ku do të bëhet “Hapja e rrugës publike” në fshatin Xërxë, komuna e Rahovecit.

Komisioni:

Arben Gashi, kryesues

Ekrem Bytyqi, anëtar

Ali Kryeziu, anëtar



Republika e Kosovës
Republica Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510033-01015-10

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	08-942/03-0054221/20
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	08.12.2020 - 09:35
Komuna / Opština / Municipality:	Rahovec / Orahovac / Rahovec
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	XËRXË / ZRZE / XËRXË
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	Rahovec / Orahovac / Rahovec

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-71510033-01015-10	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		1205	2-2000		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
RAKITA-/RAKITA-/RAKITA-		RAKITA-		

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²)
1	Bujësi/Pojë/Arë/Agro/Agriculture	Kullës/Pashnjak/pasture	Kullës E Klases 4/Pashnjak 4 Klase/4th Class Pasture	1205

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësi të adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Druzavina / single possessor	P.SHE KOSOV.K.K.RAHOVEC	KCID1503883	RAHOVEC/ ORAHOVAC / RAHOVEC /		RAHOVEC	1/1	2-2000	





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510033-01015-9

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	08-942/03-0054221/20
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	08.12.2020 - 09:35
Komuna / Opština / Municipality:	Rahovec / Orahovac / Rahovec
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	XËRXË / ZRZE / XËRXË
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	Rahovec / Orahovac / Rahovec

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71510033-01015-9	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatna imovina / Privately owned Land	Rrull	993	17-1997 35/2011		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivalište - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Podrobnosti adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
RAKITA-/RAKITA-/RAKITA-		RAKITA-		

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJIA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²)
1	Bujqësore/Pojlopriivredno/Agriculture	Kulllosa/Pashnjaci/pasune	Kulllosë E Klasës 4/Pasnjak 4 Klase/4th Class Pasture	993

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licenl broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posëdim individual / Individuaina Drzavina / single possessor	Harley House SH.P.K.	810137928	XËRXË / ZRZE / XËRXË		Fianuri pn.	1/1	Nr.pro.221-2020	23.03.2020



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Xërxë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71510033-01015-9	Parcelë / Parcela / Parcel	993



Shkalla/Razmera/Scale: 1:414

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 08.12.2020

Koha/ Vreme/ Time: 10:06:30

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:





Republika e Kosovës

Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning

АГЕНЦИЈА КАДАСТРАЛЕ И КОСОВЕЌУ КАТАСТАРСКА АГЕНЦИЈА КОСОВУ / КОСОВА CADASTRAL AGENCY

BAHOVEC


Nr. i njësise kadastrale / Br. kadastranske jedinice : 1015-9

Numri i lëndës / Broj predmeta : 03/2020

Lloji i njësise kadastrale / Vrsta kadastranske jedinice : Parcelë

Shkalla e zvogëllimit / Razmera plana : 1 : 750

Lista e koordinatave, kodit dhe përshkrimit i tyre / Lista koordinata, kod i njësive opis



Rilevori / Sahnio N.P.SH GeoModeling

(can the whiten / geodetic/kompasni / me i prezime geodes / kompani)

Nr. i llicencës / Br. licence : 26

Nenshkrimi / Potpis :

Data e rillevimit / Datum snimanja : 10.03.2020



Nenshkrimi / Potpis :

Approvi / Usvojio :

(can the whiten / person / ryrat / me i prezime shqiptar / me i)

Data e aprovimit / Datum usvajanja :



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kuvendi Komunal – Skupština Opštine – Municipal Rahovec



Duke u bazuar në nenin 12 nenin 17 nenin 24 dhe nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenin 9 paragrafi 1 pika 1, neni 40 paragrafi 2 pika 2.9 dhe neni 94, të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, propozimit të Kryetarit të Komunës me nr. protokollit 02/1267/19 të dt. 08.11.2019, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.12.2020 merr këtë :

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës me nr. protokollit 02/1572/20 i dt. 08.12.2020.
2. I lejohet Kryetarit të Komunës, që në interes të qytetarëve, në emër të mbulimit të shpenzimeve të varrimit për vitin **2021**, të lidh marrëveshje me të gjitha bashkësitë fetare që veprojnë në territorin e Komunës së Rahovecit, konform planit buxhetor afatmesëm (mbështetje në mbulimin e shërbimeve të varrimit).
3. Pakoja e shërbimeve primare do të definohet në marrëveshje të re dhe ajo nuk mund të ketë koston më të lartë se **200.00 € (dyqind euro)** për një rast, ndërsa për shërbime të tjera të cilat nuk janë pjesë e marrëveshjes, qytetarët do t'i sigurojnë ato personalisht.
4. Qytetarët të cilët do të marrin shërbim nëpërmjet bashkësive fetare, do të pajisen me një fletushkë me të cilën do të informohen për shërbimet të cilat janë pjesë e marrëveshjes.
5. Shërbimet të cilat do të jenë pjesë e marrëveshjes, në asnjë rast nuk mund të kushtëzohen me pagesat e anëtarësive fetare apo të tjera.
6. Obligohet DSHPS-ja që në kuadër të implementimit të marrëveshjes t'i respektoj afatet kohore, si dhe të kërkoj prej bashkësisë fetare (palëve nënshkruese të marrëveshjes) që t'i përmbahet të gjitha pikave të marrëveshjes si dhe obligimeve në kompletimin e dokumentacionit konform saj.
7. Mjetet të sigurohen nga kodi **Mallra dhe Shërbime**.
8. Bartës për implementimin e këtij vendimi do të jetë Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale e Komunës së Rahovecit.
9. Pas miratimit nga Kuvendi Komunal i Rahovecit, ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në Web – faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01 Nr. ___/2020
Rahovec, 29.12.2020

Kryesues i Kuvendit

Afrim Dina



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Predsednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVCIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1572 Nr. i faq./Br.str./No.pg 158
Data/Datum/Date 08 / 12 / 2020
RAHOVEC / ORAHOVAC

Duke u bazuar në nenin 11, nenin 13 dhe nenin 58, shikronja (i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 9, nenit 40, nenit 74 dhe nenit 92, të Statutit të Komunës Nr. 1005, i datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës, i:

PROPOZON

1. Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratimin e vendimit me të cilin i lejohet Kryetarit të Komunës, që në interes të qytetarëve, në emër të mbulimit të shpenzimeve të varrimit të lidh marrëveshje me të gjitha bashkësitë fetare që veprojnë në territorin e komunës së Rahovecit, konform planit buxhetor afatmesëm (mbështetje në mbulimin e shërbimeve të varrimit).
2. Pakoja e shërbimeve primare të definohet në marrëveshje të re dhe ajo nuk mund të ketë koston më të lartë se 200 euro për një rast, ndërsa për shërbime të tjera të cilat nuk janë pjesë e marrëveshjes, qytetarët do t'i sigurojnë ato personalisht.
3. Qytetarët të cilët do të marrin shërbim nëpërmjet bashkësive fetare, do të pajisen me një fletushkë me të cilën do të informohen për shërbimet të cilat janë pjesë e marrëveshjes.
4. Shërbimet të cilat do të jenë pjesë e marrëveshjes, në asnjë rast nuk mund të kushtëzohen me pagesat e anëtarësive fetare apo të tjera.
5. Obligohet DSHPS-ja që në kuadër të implementimit të marrëveshjes t'i respektoj afatet kohore, si dhe të kërkoj prej bashkësisë fetare (palëve nënshkruese të marrëveshjes) që t'i përmbahet të gjitha pikave të marrëveshjes si dhe obligimeve në kompletimin e dokumentacionit konform saj.
6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale e Komunës së Rahovecit.

Me propozim të njoftohen:

- Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës



NR.REND	LLOJI I SHËRBIMIT	SHUMA
1	TRANSPORTI I KUFOMËS BREnda TERRITORIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT (bartja e kufomës nga shtëpia deri në xhami (vendfalje) dhe përcjellja në varreza.	30
2	HAPJA DHE MBYLLJA E VARRIT (sipas parimeve fetare islame). Transporti i punëtorëve dhe mjeteve të punës në varreza.	45
3	DËRRASAT- (pa arkivol)- dërrasat me të cilat mbulohet i vdekuri pas lëshimit në varr me dimens. 2.10 x 1.10 x 0.4) . Transporti i dërrasave deri te vendi i varrimit.	50
4	QEFINI - mbështjellës i veçantë për kufomën sipas parimeve islame dhe mjetet higjienike, (përfshihen dorëzat higjienike si dhe pambuku, shamponi dhe sapuni).	25
5	PIRAMIDA (dërrasë me mbishkrimin e të dhënave të të vdekurit)	20
6	KUJDESTARIA 24 orë duke përfshirë edhe ditët e vikendeve. Regjistrimi i të dhënave të personit të vdekur në librin amëz i të vdeurve.	15
7	DEZINFETIMI I VETURËS	5
8	AFISHET (FLETËLAJMRIMET) 20 COPA	10
	TOTALI	200 €



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 pika (d), nenit 17 pika (o) dhe nenit 40 paragrafi 40.2 pika (i) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, dispozitave të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 14/2019 për Caktimin e Emërimit dhe Numërimit të Adresave për Zona të Qarkullimit Publik, Ndërtesa, Shtëpi, Objekte dhe Parcela kadastrale të lira, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.8 dhe 57 paragrafi 1 pika 1.15 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017 dhe rekomandimit të Komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Rahovecit me Nr. Prot. 01/144/20 të datës 11.12.2020, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë:29.12.2020 merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e listës për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Rahovecit

1. **Miratohet** lista për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Rahovecit.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista me emërtimin e rrugëve të reja në Komunën e Rahovecit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **MAPL-së dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. 12/20
Me datë: 29.12.2020

Afrim Dina


Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec



DATË/A:	11.12.2020
PËR/ZA/TO:	KUVENDIN KOMUNAL RAHOVEC
NGA/OD/FROM:	KOMISIONI PËR EMËRTIMET E REJA TË RRUGËVE, SHESHEVE, PARQEVE DHE OBJEKTEVE KOMUNALE NË KOMUNËN E RAHOVECIT
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	LISTA ME PROPOZIME PËR EMËRTIMET E REJA TË RRUGËVE, SHESHEVE, PARQEVE DHE OBJEKTEVE KOMUNALE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

Të nderuar,

Me vendim të Kuvendit Komunal Rahovec, është formuar Komisioni për emërtimet e reja të rrugëve, shesheve, parqeve dhe objekteve komunale në këtë përbërje:

1. Besmire Bytyçi- (përfaqësuese nga legjislativi) - Kryesuese e Komisionit
2. Afërdita Thaçi- anëtare (përfaqësuese nga legjislativi)
3. Vahid Krasniqi- anëtar (përfaqësues nga legjislativi)
4. Rumir Zhuniqi- anëtar (përfaqësues nga ekzekutivi)
5. Bjondina Kleqka- anëtare (përfaqësuese nga ekzekutivi).

Komisioni në këtë përbërje ka filluar punimet në terren më datë: 14 tetor 2020, dhe ka përfunduar ato më datë: 21 tetor 2020.

Paraprakisht, Kryesuesja e këtij komisioni në dakordim edhe me anëtarët e tjerë kanë caktuar datat e mbajtjes së takimeve me kryetarë të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane në qytetin e Rahovecit, ndërkaq caktimi i lokacionit për mbajtjen e takimeve është bërë në koordinim me përfaqësuesin e fshatit nikoqir. Bazuar në gjendjen e cila ka kapluar vendin tonë, për shkak të pandemisë COVID-19, ky komision është dakorduar që takimet të mbahen me përfaqësues të disa fshatrave ose lagjeve në një lokacion të përbashkët, me nga një përfaqësues të secilit lokalitet ose edhe anëtarë të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane në qytetin e Rahovecit.

Përfaqësuesit e fshatrave, janë njoftuar se kërkesat e tyre mund t'i dorëzojnë çdo ditë pune nga ora 08:00- 16:00, në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit ose pranë zyrës së Kuvendit Komunal Rahovec, deri më datë 31 tetor 2020.

Pas përfundimit të afatit për dorëzimin e kërkesave për emërtime të reja Komisioni për emërtimet e reja të rrugëve, shesheve, parqeve dhe objekteve komunale ka zhvilluar edhe tre takime tjera për shqyrtimin e këtyre propozimeve.

Gjatë zhvillimit të punimeve komisioni ka hasur edhe në kërkesa që i plotësojnë kriteret për emërtim dhe gjithsej janë: 34. Ndërkaq, vlen të theksohet se komisioni për emërtimet e reja të rrugëve, shesheve, parqeve dhe objekteve komunale ka parë të arsyeshme që të bëjë edhe propozime tjera lidhur me emërtimin e rrugëve në komunën e Rahovecit.

Në vijim gjeni edhe listën me emrat e rrugëve të cilat sipas komisionit përmbushin kriteret e nevojshme për emërtim, gjithmonë duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ për emërtimet e rrugëve.

Vërejtje: Në mbledhjen e radhës të Kuvendit Komunal Rahovec, për propozimet që përfshijnë emërtimet e reja të rrugëve do të paraqiten edhe hartat për secilën rrugë veç e veç.

LISTA ME EMRA TË RINJ TË PROPOZUAR PËR EMËRTIMIN E RRUGËVE TË REJA, SHESHEVE, PARQEVE DHE OBJEKTEVE KOMUNALE

Nr.	EMRI I PROPOZUAR PËR EMËRTIM	VENDI	PËRSHKRIMI
1.	"VETERANËT E UÇK-SË DRENOCIT"	DRENOC	Propozim i ardhur për emërtim në kujtim të atyre që kontribuan në çlirimin e vendit.
2.	"DAN MEMETI"	DRENOC	Me pëlqimin e qytetarëve të fshatit Drenoc, është propozuar që të emërtohet rruga me emrin "DAN MEMETI", kjo në nderim të, ish kryetarit të fshatit Drenoc, njëherit kontribues në ndërtimin e shkollës së fshatit Drenoc.
3.	"ARSIM BERISHA"	DRENOC	Me pëlqimin e qytetarëve të fshatit Drenoc, është propozuar që rruga e cila fillon nga rr. "Mensur Zyberaj" dhe vazhdon deri tek rr. "Dan Memeti", të emërtohet me emrin "ARSIM BERISHA" e ish- ushtarit të UÇK-së, -Zona Operative e Pashtrikut, Brigada 124 GANI PAQARIZI.
4.	"RRUGA E MRIZIT"	DRENOC	Me pëlqimin e qytetarëve të fshatit Drenoc, është propozuar që rruga nga Pompa e Hemit të emërtohet me emrin "RRUGA E MRIZIT", sepse si e tillë është njohur gjithmonë.
5.	"DESTAN GASHI"	DRENOC	Me pëlqimin e qytetarëve të fshatit Drenoc, është propozuar që rruga e cila fillon nga rr. "Mensur Zyberaj" dhe vazhdon deri tek rr. "Bedrush Gashi", të emërtohet me emrin e ish- ushtarit të UÇK-së, -Zona Operative e Pashtrikut, Brigada 124 GANI PAQARIZI, në Drenoc, pra me emrin e Destan Gashit.
6.	"BURGOSURIT POLITIK"	DRENOC	Me pëlqimin e qytetarëve të fshatit Drenoc , është propozuar që të emërtohet rruga me emrin "BURGOSURIT POLITIK", kjo në nderim të atyre që kanë qenë të persekutuar nga ish regjimi serb.
7.	"SHIQIRI MAKSHANA"	DRENOC	I lindur në fshatin Drenoc, ushtar i batalionit të tretë të Brigadës nga Fekeni, përkrahës i luftës së UÇK-SË, në veçanti me mjete financiare si në " FONDI I 3%" dhe" VENDLINDJA THËRRET". Për vlerat e tij familja Makshana ka themeluar edhe fondacionin "SHIQIRI MAKSHANA", për përkrahjen ndaj familjeve në nevojë veçanërisht familjeve të dëshmorëve. Vdes tragjikisht më 24 qershor 2014.
8.	"MULLINI VJETËR"	DRENOC	Me pëlqimin e qytetarëve të fshatit Drenoc, përkatësisht lagjes Berisha, është propozuar që rruga e cila fillon nga rr. "Mensur Zyberaj", e vazhdon deri tek Mulliri të emëtohet "MULLINI VJETËR" për shkak se po në këtë rrugë dikur ishte një Mulli aty.

9.	"LISI PAJATËS"	DRENOC	Me pëlqimin e qytetarëve të fshatit Drenoc, përkatësisht lagjes Berisha dhe Kastrati, rruga e cila fillon nga rr. "Hamdi Kastrati", të emërtohet "LISI PAJATËS", sepse po në këtë rrugë është një lis i vjetër të cilin banorët e quajnë kështu.
10.	"DAN REXHEPI"	DRENOC	Me pëlqimin e qytetarëve të fshatit Drenoc, është propozuar që rruga nga Kroni i Gjorëve, deri në fund të rrugës të emërtohet me emrin "DAN REXHEPI", dëshmor i rënë në betejën e Kërçovës.
11.	"DELI JAKUPI"	DRENOC	Me pëlqimin e qytetarëve të fshatit Drenoc, përkatësisht lagjes Berisha, është propozuar që rruga e paemëruar në të cilën jetojnë familja Berisha e njohur dikur si rrugë e Deli Jakupve, të emërtohet me emrin "DELI JAKUPI".
12.	Parku te Shitorja e Jupës të emërtohet "KULLA E MAKSHANVE"	DRENOC	Kryesia e fshatit Drenoc, ka propozuar që Parku te Shitorja e Jupës të emërtohet "KULLA E MAKSHANVE", kjo për shkak të vlerave historike dhe kombëtare që përfaqëson "KULLA", e cila ishte një ndër konaqet më të vjetra të Anadrinisë e ndërtuar në vitet 1800-1805.
13.	Parku tek Lagja e Berishëve të emërtohet: "MËRGIMTARËT E BERISHËS"	DRENOC	Kryesia e fshatit Drenoc, ka propozuar që Parku tek Lagja e Berishëve të emërtohet: "MËRGIMTARËT E BERISHËS", kjo në nderim të kontributit që mërgimtarët nga kjo familje kanë dhënë për fshatin Drenoc.
14.	Parku i fshatit Mrasor të emërtohet: "PARKU I LIRISË"	MRASOR	Kryesia e fshatit Mrasor, ka propozuar që Parku i fshatit Mrasor të emërtohet: "PARKU I LIRISË".
15.	Oda e fshatit Mrasor të emërtohet: "SHTABI I UÇK-së"	MRASOR	Kryesia e fshatit Mrasor, ka propozuar që Oda e fshatit Mrasor të emërtohet: "SHTABI I UÇK-së"
16.	Shtëpia e fshatit Senoc të emërtohet: "ODA E FSHATIT".	SENOG	Kryesia e fshatit Senoc, ka propozuar që Shtëpia e fshatit Senoc të emërtohet: "ODA E FSHATIT".
17.	"Hysni Fetoshi"	FORTESË	Kryesia e fshatit Fortesë, ka propozuar që rruga në lagjen e Fetoshëve, të emërtohet me emrin e "Hysni Fetoshi", kontribues i çështjes kombëtare, i vrarë nga okupatori serb në vitin 1999.
18.	"Murat Dula"	DEJNË	Kryesia e fshatit Dejnë, ka propozuar që rruga, në lagjen e Bytyqve, të emërtohet me emrin e Murat Dulës, i vrarë nga forcat komuniste në trevën e Plavës, dhe Gucisë, në vitin 1944.
19.	"Rruga e Jupajve"	DEJNË	Kryesia e fshatit Dejnë, ka propozuar që rruga e Jupajve, e banuar nga qytetarë të ardhur nga fshati Kaznik, e njohur si Jupë Kazniku, të emërtohet "Rruga e Jupajve".

**LISTA ME EMRA TË RINJ TË PROPOZUAR PËR EMËRTIMIN E RRUGËVE TË REJA, SHESHEVE, PARQEVE
DHE OBJEKTEVE KOMUNALE**

5

20.	"Elmaze Bytyqi"	DEJNË	Kryesia e fshatit Dejnë, ka propozuar që rruga në lagjen e Bytyqve, të emërtohet me emrin "Elmaze Bytyqi", e vrarë në luftën e fundit më 4 shtator 1998, në fshatin Dejnë.
21.	"Mikadese Bytyqi"	DEJNË	Kryesia e fshatit Dejnë, ka propozuar që një rrugë në fshatin Dejnë të emërtohet me emrin "Mikadese Bytyqi", e vrarë nga forcat serbe më 04 shtator 1998.
22.	"Mehmet Tahiri"	DEJNË	Kryesia e fshatit Dejnë, ka propozuar që rruga në dalje të fshatit Dejnë, të emërtohet me emrin "Mehmet Tahiri".
23.	" SHESHI I FLAMURIT"	FORTESE	Komisioni ka propozuar që hapësira afër Xhamisë së fshatit të emërtohet me emrin "SHESHI I FLAMURIT", kjo për shkak se në atë hapësirë, ndodhet një flamur kombëtar dhe mirëmbahet nga banorët e fshatit.
24.	" Bajram Nurshaba"	RAHOVEC	Kryesia e lagjes II, e qytetit të Rahovecit ka propozuar që rruga e re e cila po ndërtohet në gjatësi prej 700m, të emërtohet me emrin e atdhetarit të çështjes kombëtare, të ndjerit Bajram Nurshaba.
25.	Parku i fshatit të emërtohet " Parku i Gexhës "	GEXHË	Kryesia e fshatit Gexhë, ka propozuar që Parku i fshatit të emërtohet " Parku i Gexhës ".
26.	Sheshi i fshatit të emërtohet" BESNIK KASTRATI"	DOBIDOL	Kryesia e fshatit Dobidol, ka propozuar që Sheshi i fshatit të emërtohet" BESNIK KASTRATI", kjo në nderim të jetës dhe veprës së dëshmorit të kombit Besnik Kastrati.
27.	Lisi i Mujës të emërtohet " Lisi i Nagavcit"	NAGAC	Kryesia e fshatit Nagac, ka propozuar që Lisi i njohur si Lisi i Mujës të emërtohet " Lisi i Nagavcit"
28.	"14 Dhjetori"	PATAQAN I EPËRM	Kryesia e fshatit Pataqan i Epërm, ka propozuar që rruga e fshatit të emërtohet me emrin "14 Dhjetori", si dtaë me rëndësi të veçantë historike, dtaë kjo në të cilën ranë 42 dëshmorë, dhe u plagosën shumë të tjerë.
29.	" Xhemajl Hajrullaga"	RAHOVEC	Në adresë të komisionit ka ardhur edhe një propozim për emërtim për ndonjë nga rrugët e qytetit të Rahovecit, në nderim të profesorit tashmë të ndjerë, Xhemajl Hajrullaga, i njohur për kontributin e tij në çështjen kombëtare.
30.	" Hashim Popaj"	FORTESE	Kryesia e fshatit Fortesë, ka propozuar që rruga prej restaurant " Natyra" deri tek restaurant " Arlindi", të emërtohet me emrin e martirit Hashim Popaj, i vrarë nga okupatori serb.

Komisioni për emërtimet e reja të rrugëve, shesheve, parqeve dhe objekteve komunale ka dalur edhe me disa propozime konkrete edhe për emërtime të rrugëve me një rëndësi të veçantë dhe historike për komunën e Rahovecit.

Propozimet janë si në vijim:

- Rruga e Tranzitit, mbi Rahovec, të emërtohet: " TOKA E RRUSHIT "
- Rruga për tek " Maja e Shkodranit" të emërtohet:" DËSHMORËT E KORRIKUT"
- Rruga Fortesë- Hamoc të emërtohet : " VRESHTARI"
- Shtegu për te "Maja e Shkodranit" të emërtohet:" SHTEGU I LIRISË".

Lista propozuese i'u dërgohet:

- *Anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa*
- *Sekretarisë së Kuvendit*
- *Arkivit*

Rahovec,

11 nëntor 2020

Komisioni për emërtimet e reja të rrugëve, shesheve, parqeve dhe objekteve komunale



Në bazë të nenit 12 pika 1, nenit 17 shkronja (a) dhe nenit 40 pika 2 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.12.2020 miraton këtë :

V E N D I M

Për miratimin e planit të punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2021

1. Me këtë vendim **miratohet** agenda dhe plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2021.
2. Shtojcë e këtij vendimi është edhe plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2021.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Anëtarëve të KKSB-së,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01-Nr. ___/20
Datë: 29.12.2020

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit

**PLANI I VEPRIMIT PËR KËSHILLIN KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI
JANAR-DHJETOR 2021**

Nr. Re.	Muaji	Gëshjtjet që shqyrtohen	Përshkrimi i shkurtër i iniciativës/projektit	Përgatit	Shqyrton	Specifikat Buxhetore
1.	JANAR	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19; 3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit; - Analizë e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit për vitin paraprak, - Siguria në Trafik, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkollë dhe zbatimin e planit për siguri në shkollë, - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit,	Kryetari i komunës dhe Komandanti i policisë raporton para anëtarëve të KKSBS-së, rreth gjendjes së sigurisë për muajt raportues.	Kryetari, Policia dhe Koordinatori	Anëtarët e KKSBS-së	00.00 €
		4. Të Ndryshme.	-		Anëtarët e KKSBS-së	00.00 €

2.	MARS	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19; 3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, - Trotuaret, liri i tyre dhe shenjat sinjalizuese. - Qentë endacak. - Siguria në Trafik, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkollë dhe zbatimin e planit për siguri në shkollë, - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit,	Kryetari i Komunës dhe Komandanti i Policisë raporton para anëtarëve të KKSB-së, rreth gjendjes së sigurisë për muajt raportues.	Kryetari i Komunës Policia Dhe Koordinatori i KKSB-së	Anëtarët e KKSB-së	00.00 €
		4. Organizimi i Takimit Publik me qytetarët dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane,	Shqyrtimi i problemeve të sigurisë të cilat i preokupojnë banorët	Kryetari i Komunës, anëtarët e KKSB-së	Anëtarët e KKSB-së	100.00 €
		3. Të Ndryshme.			Anëtarët e KKSB-së	
3.	PRIII	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19; 3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, - Shqyrtimi i dukurive negative, me theks të veçantë trajtimi i objekteve jo të sigurta në Komunën e Rahovecit, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkollë dhe zbatimin e planit për siguri në shkollë, - Rreth veprimeve dhe masave për	Kryetari i komunës, Komandanti i Policisë, drejtori i DKA-së dhe drejtori i Emergjencave raportojnë para anëtarëve të KKSB-së, rreth gjendjes së sigurisë për muajt raportues	Kryetari i Komunës, Policia dhe Koordinatori i KKSB-së	Anëtarët e KKSB-së	00.00 €

		luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit, - Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për parandalimin nga zjarri gjatë sezonit veror,				
		4. Identifikimi i çështjeve problematike që ndikojnë në sigurinë publike ndëretnike,	Organizimi i takimeve publike me komunitetet pakicë në Rahovec	Kryetari, Policia, Koordinatori i KKS-së	Anëtarët e KKS-së	100,00 €
		5. Të Ndryshme.			Anëtarët e KKS-së	
4.	QERSHOR	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19; 3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, - Prishja e qetësisë publike nga lokalitetet natës dhe personat e pa përgjegjshëm, - Masat për parandalimin e lëmshës-kërkuesit, - Plani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave, - Siguria në Trafik, - Gjendja e sigurisë në shkollë, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkollë dhe zbatimin e planit për siguri në shkollë, - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit,	Kryetari i Komunës, Komandanti i policisë DASH-ja, DAP-ja dhe DKA-ja, para raportojnë të KKS-së	Kryetari i Komunës Policia, Koordinatori i KKS-së	Anëtarët e KKS-së	00.00 €

	4. Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë e promovimit të bashkëpunimit ndër-etnik, multi-kulturor dhe ndër – fetar.	Organizimi i ndonjë kampi ose ndonjë aktiviteti sportiv me të rinjtë e komuniteteve që banojnë në Komunën e Rahovecit	Kryetari i Komunës, Policia, anëtarët e KKSB-së dhe Koordinatori i KKSB-së,	Anëtarët e KKSB-së	1,000.00 €
	5. Të Ndryshme.			Anëtarët e KKSB-së	
5.	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19; 3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, - Prishja e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm - Trajtimi i mbrojtjes së pyjeve nga dëmtuesit ilegalë, - Vetëdijësimi nga minat dhe mjeteve tjera të pa shpërthyer nga lufta, - Gjendja e sigurisë në shkollë - Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkollë dhe zbatimin e planit për siguri në shkollë, - Siguria në trafik. - Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit, 4. Të Ndryshme.	Kryetari i Komunës, Komandanti i policisë DMSH-ja, DAP-ja dhe DKA-ja, para raportojnë të KKSB-së	Kryetari i Komunës, Policia	Anëtarët e KKSB-së	00.000 €
				Anëtarët e KKSB-së	

SHTATOR

6.	DHJETOR				
	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;	Shërbimi i Kuvendit- Zyra e Kryetarit Anëtarët e KKSBB-së Policia e Kosovës DKA-ja DSHP	Policia KKSBB-së	KKSBB-së	Kuvendin Komunës
	2. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19;				
	3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, - Vetëdijësimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkollë dhe zbatimin e planit për siguri në shkollë, - Mungesa e parkingjeve në qytet dhe ndriçimi publik				
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KKSBB-së për vitin 2021.	Bëhet përgatitja e Planit të Punës së KKSBB-së nga Kryetari i Komunës dhe Koordinatorin KKSBB-së	Kryetari i Komunës, anëtarët e KKSBB-së, Koordinatori	Anëtarët e KKSBB-së	00.00 €	
	3. Të Ndryshme.			Anëtarët e KKSBB-së	

01 Nr. ____/2020
Rahovec, 21.12.2020

Smajl Latifi

Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja s) dhe nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 2, nenit 7 paragrafi 3, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, 40 paragrafi 2 pika 2.7 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.12.2020 merr këtë:

V E N D I M

Për shpalljen "QYTETAR NDERI" i Komunës së Rahovecit

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 00/0000 i datës 00.00.2020 dhe merret vendimit për shpalljen "QYTETAR NDERI" i komunës së Rahovecit të Gjeneralit Ton van Loon, komandant i parë i KFOR-it holandez, për shkak të kontributit të tij të jashtëzakonshëm në ofrimin e rendit dhe sigurisë për të gjithë banorët e komunës së Rahovecit.
2. Me rastin e shpalljes, Kryetari i Komunës së Rahovecit do t'i dorëzoj Gjeneralit Ton van Loon titullin "QYTETAR NDERI" i komunës së Rahovecit dhe do të regjistrohet në regjistrin e bartësve të titullit "Qytetar Nderi" i komunës së Rahovecit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Rahovecit.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Kryetarit të Komunës,**
- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **MAPL-së dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/20
Me datë: 29.12.2020

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1581 Nr. i faq./Br.str./No.pg 159
Data/Datum/Date 10 / 12 / 2020
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13, ~~nenit 17 shkronja s) dhe nenit 58 shkronja (h)~~ të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008), nenit 74 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

PROPOZON

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratimin e vendimit për shpalljen e “QYTETAR NDERI” të komunës së Rahovecit Gjeneralit Ton van Loon, komandant i parë i KFOR-it holandez.
2. I lartpërmenduri sipas pikës 1 të këtij propozimi shpallet “QYTETAR NDERI” për shkak të kontributit të tij të jashtëzakonshëm në ofrimin e rendit dhe sigurisë për të gjithë banorët e komunës së Rahovecit.
3. Propozimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me propozim të njoftohen:

1. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,
2. Sekretaria e Kuvendit, dhe
3. Arkivi.

Smajl Latifi

Kryetari i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
EMBASSY IN THE HAGUE

Hagë, 1 dhjetor 2020

Nr. 025/20

Z. Smajl Latifi
Kryetar
Komuna e Rahovecit

I nderuar Kryetar,

Ju drejtohem me kërkesë për ta shqyrtuar shpalljen "Qytetar Nderi" i Rahovecit të Gjeneralit Ton van Loon, komandant i parë i KFOR-it holandez në vitin 1999 me rastin e hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë.

Gjenerali van Loon është dekoruar nga Presidenti Hashim Thaçi me medaljen "Urdhëri i Lirisë" për kontribut të lartë për lirinë e Kosovës.

Pak muaj para se dislokohej në Rahovec, Gjenerali van Loon komandonte njësitin e tij artilerik në mbrojtje të refugjatëve dhe trupave të KFOR-it të vendosur në Maqedoni. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës, Gjenerali van Loon, së bashku me njësitin e tij, kishin lëvizur drejt Rahovecit për t'u bërë pjesë e Zonës Gjermane të KFOR-it.

KFOR-i holandez, nën komandën e Gjeneralit van Loon, ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për ofrimin e sigurisë për të gjithë banorët e Rahovecit.

Sipas Gjeneralit van Loon, me të hyrë në Rahovec, ata kishin parë shkatërtime masive; kishin hasur në trupa të vrarë të civilëve shqiptarë; gropa me kafshë të vrara; plaçkitje të pronave private e publike. Ai dhe njësit i tij menjëherë kishin ndërmarrë masa për varrosjen e trupave të pajetë dhe sanimin e dëmeve. Ata kishin filluar gjithashtu të mblidhnin informacione për krimet serbe dhe ua kishin përcjellur ato Tribunalit të Hagës për ish Jugosllavinë.

Gjenerali van Loon dhe njësit i tij kishin parandaluar edhe hedhjen në ajër të verarisë së Rahovecit nga forcat serbe që po tërhiqeshin nga Rahoveci, duke i dërguar automjetet e tyre ushtarake aty si masë parandaluese. Me të kaluar rreziku, për t'i dalë në ndihmë sadopak verarisë, Gjenerali van Loon edhe

kishte blerë një sasi të konsiderueshme të verës që gjendej në bodrumin e saj, ndërsa një pjesë e kishte transportuar edhe në Holandë për nevoja të Akademisë Ushtarake të Artilerisë, ku bënte pjesë edhe vetë.


Të gjendur në një situatë delikate, ku banorët shqiptarë të Rahovecit nuk lejonin dislokimin e trupave ruse, Gjenerali van Loon kishte luajtur një rol konstruktiv gjatë konsultimeve me banorët dhe lidhshin lokal civil të asaj kohe si dhe njësitet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Jam i bindur se ju dhe qytetarët e Rahovecit do ta mbajnë në mend Gjeneralin van Loon si dhe do të jeni të njoftuar me kontributin e tij.

Gjenerali van Loon dhe veteranët e tjerë të KFOR-it holandez janë gjithnjë të lidhur me Kosovën. Ne si ambasadë e Republikës së Kosovës në Holandë mbajmë kontakte të rregullta me ta, duke i ftuar edhe në një pritje të veçantë më 12 qershor 2019 për 20 vjetorin e çlirimit të Kosovës dhe hyrjen e NATO-së në Kosovë, me ç'rast Gjenerali van Loon shpallosi kujtimet e tij të asaj kohe.

I nderuar Kryetar, duke ju falenderuar për interesimin dhe kujdesin tuaj për këtë çështje, ju kisha rekomanduar parazervë që ta shqyrtoni shpalljen e Gjeneralit Ton van Loon si "Qytetar Nderi" i Rahovecit. Kjo do t'i bënte nder të madh Gjeneralit van Loon, Rahovecit si dhe do t'i forconte edhe më shumë lidhjet miqësore dhe ndërshtetërore midis Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Holandës. Gjenerali van Loon si dhe veteranët e KFOR-it holandez kanë shprehur dëshirën që ta vizitojnë komunën e Rahovecit në një kohë të përshtatshme, prandaj, në rast të vendimit pozitiv për titullin "Qytetar Nderi", vizita e tyre do të ishte mundësi e mirë për t'ia dorëzuar atij personalisht titullin në një ceremoni solemne në Rahovec si dhe për t'i falenderuar edhe pjesëtarët veteranë të KFOR-it holandez.

Me respekt,



Lirim Greçevci

Ambasador i Republikës së Kosovës në Holandë

Biografi e Gjeneralit Ton van Loon, komandant i parë i KFOR-it holandez në Kosovë

Gjenerali van Loon pati një karrierë të gjatë dhe të suksesshme ushtarake. Në mars të vitit 1998 gjenerali van Loon u emërua Komandant i Batalionit të 11-të të Artilerisë. Me këtë batalion ai zbarkoi në Kosovë në vitin 1999 si pjesë e Brigadës Shumëkombëshe të KFOR-it. Për udhëheqjen e dëshmuar në këtë mision atij i'u nda titulli Kalorës i Urdhrit të Portokallitë Nassau (Knight of the Order of Orange Nassau).

Në vitet në vijim, Gjenerali van Loon shërbeu ndër të tjera si shef i operacioneve në Shtabin e Ushtrisë Mbretërore Holandeze në Hagë dhe ishte jashtëzakonisht i angazhuar në forcimin e bashkëpunimit me shtetin gjerman. Pas emërimit Komandant i brigadës tokësore shumëkombëshe të NATO-s në vitin 2004, ai u dekorua me medalen e NATO-s për shërbim meritor (NATO Meritorious Service Medal).

Gjenerali van Loon shërbeu po ashtu në Afganistan me çrast u dëshmuar për qasjen e tij konstruktive dhe gjithëpërfshirëse me fokus në mbrojtje, diplomaci dhe zhvillim të vendit.

Për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në forcim të bashkëpunimit në mes të Holandës dhe Gjermanisë në vitin 2010 atij i'u nda çmimi i artë gjerman "Ehrenkreuz der Bundeswehr". Po atë vit ai mori titullin Lejtnant Gjeneral dhe u emërua Komandant i trupave holandeze dhe gjermane në Munster të Gjermanisë. Bazuar në përvojën e tij në Ballkan dhe në Afganistan, nën komandën e tij trupat ushtarak zhvilluan mënyra inovative për të punuar në mënyrë efektive me akterët civilë në Gjermani, Holandë dhe në përgjithësi në OKB.

Në shtator të vitit 2013, pas një karriere gati 40 vjeçare, gjenerali van Loon u pensionua. Me këtë rast ai u gradua në oficer në rendin Orange Nassau dhe iu dha çmimi gjerman "Großes Verdienstkreuz mit Stern".

Gjeneral-lejtnant Ton van Loon është i ve dhe ka dy fëmijë.